



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI JURIDIK

STUDIME PASDIPLOMIKE- CIKLI I DYTË

TEZA

**“Zbulmi i veprave penale kundër natyrës dhe ambientit jetësor në Republikën
e Maqedonisë së Veriut: 2015-2020”**

KANDIDATI:

QEMRAN SHABANI

MENTORI:

PROF. DR. BLETA ARIFI

TETOVË 2022

Përmbajtja

| | |
|---|-----------|
| 1. Lënda e hulumtimit | 2 |
| 2. Qëllimet e hulumtimit | 3 |
| 3. Hipotezat | 4 |
| 4. Metodologjia e hulumtimit | 5 |
| 5. Rëndësia e punimit..... | 6 |
| 6. Strukturimi i punimit | 7 |
| 7. Kapitulli 1 | 7 |
| Historiku dhe kuptimi i kriminalitetit kundër natyrës dhe ambientit jetësor..... | 8 |
| 1.1. Historiku dhe kuptimi i kriminalitetit kundër natyrës dhe ambientit jetësor..... | 9 |
| 1.2. Trajtimi juridik i veprave penale kundër natyrës dhe ambientit jetësor..... | 10 |
| 1.2.1. Konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare lidhur me veprat penale kundër natyrës dhe ambientit jetësor..... | 11 |
| 1.2.2. Trajtimi kriminalistik i kriminalitetit ekologjik..... | 12 |
| Kapitulli 2..... | 13 |
| KARAKTERISTIKAT E VEPRAVE PENALE KUNDËR NATYRËS DHE AMBIENTIT JETËSOR..... | 14 |
| 1. Vështrime hyrëse për veprat penale kundër mjedisit..... | 15 |
| 2. Trajtimi I disa veprave penale kundër mjedisit jetësor dhe natyrës..... | 16 |
| 2.1. Ndotja e ambientit jetësor..... | 17 |
| 2.2. Ndotja e ujit të pijshëm..... | 18 |
| 2.3. Prerja e paligjshme e pyjeve..... | 19 |
| 2.4. Rrezikimi i mjedisit jetësor dhe natyrës me hedhurina..... | 20 |
| 2.5. Mbetjet radioactive..... | 21 |
| 2.6. Transportimi i materieve të rrezikshme në vend..... | 22 |
| 2.7. Uzurpimi i paluajtshmërive..... | 23 |
| 2.8. Eksploatimi joligjor i lëndëve të para minerale..... | 24 |
| 2.9. Gjuetia e paligjshme..... | 25 |
| 2.10. Peshkimi i paligjshëm..... | 26 |

| | |
|---|---------------|
| Kapitulli 3..... | 27 |
| ANALIZË DHE TË DHËNA STATISTIKORE PËR VEPRAT PENALE KUNDËR NATYRËS DHE AMBIENTIT JETËSOR..... | 27 |
| 1. Ecuria dhe vëllimi i veprave penale kundër mjedisit..... | 28 |
| 2. Kryerësit e veprave penale kundër mjedisit jetësor..... | 29 |
| 3. Investimet dhe kostot për mbrojtjen e mjedisit jetësor, 2015-2020..... | 30 |
| 4. Veprat penale kundër mjedisit jetësor, analizë sipas të dhënave nga Prokuroritë publike dhe gjykatat e RMV..... | 31 |
| 5. Analizë e përgjithshme për veprat penale kundër mjedisit jetësor, në rajonin e Kumanovës..... | 32 |
| Kapitulli 4..... | 33 |
| METODIKA E SQARIMIT DHE ZBULIMIT TË KRIMINALITETIT EKOLOGJIK..... | 33 |
| 1. Metodatat më efektive në parandalimin e krimit ekologjik..... | 34 |
| 2. Veprimet krimnalistike me karakter parandalues ndaj kriminalitetit ekologjik..... | 35 |
| 1. Roli i MPB-së dhe Policisë Pyjore në parandalimin e kriminalitetit ekologjik..... | 36 |
| 2. Veprimet krimnalistike me karakter represiv për zbulim të kriminalitetit ekologjik..... | 37 |
| 5. Specifika të kriminalitetit ekologjik..... | 39 |
| 5.1. Koha e kryerjes..... | 39 |
| 5.2. Modus operandi e kriminelëve të kësaj forme të kriminalitetit..... | 40 |
| 5.2.1. Mjetet që përdoren për kryerjen e këtyre krimeve..... | 41 |
| 5.2.2. Disa veçori të kryerësve të kriminalitetit ekologjik..... | 42 |
| 8. Përfundimi..... | 43 |
| 9. Bibliografia..... | 44 |

1. Lënda dhe qëllimet e hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi është paraqitja e kriminaliteti ekologjik që është një term, të cilin çdo ditë e më tepër po e dëgjojmë më shumë nëpër media, ndërkaq si fjalë është shumë e kuptueshme, mirëpo si problem për shumicën e njerëzve është i parëndësishëm dhe nuk krijon frikën që në këtë rast do të shkaktonin krimet tjera.

Në këtë punim do të përmbledhim të dhënat nga institucionet dhe politikat internacionale që kushtëzojnë legjislacionin tonë, mendimet e ekspertëve botërorë për këtë lloj kriminaliteti dhe zgjidhjet afatshkurte dhe afatgjate për parandalimin dhe rikuperimim e këtyre dëmeve.

Lëndë hulumtimi do të jenë veprat penale kundër mjedisit, gjykatat dhe organet tjera kompetent, kryerësit e këtyre veprave, dënimet e shqyrtuara si dhe masat për parandalimin e këtyre veprave. Do të hulumtohet mbi bashkëpunimin e institucioneve përkatëse vendore dhe atyre ndërkombëtare për parandalimin e kësaj problematike.

Në këtë punim shkencor do të hulumtohen veprat penale kundër mjedisit jetësor në territorin e Republikës së Maqedonisë, gjatë periudhës kohore 2015-2020 që paraqiten si vepra të rënda të kundërligjshme që çënojnë mbrojtjen e mjedisit, çënojnë një ndër të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, që është uji dhe ajri, të drejta të cilët na i ka falur Zoti, dhe pa të cilët nuk mund të jetojmë.

Do të hulumtohen ato vepra penale, për të cilat gjykata shqipton dënim me gjobë, dënim me burgim prej 1 deri në 5 vjet, si dhe në raste më të rënda dënim me burgim deri në 10 vjet.

Në theks të veçantë do të hulumtohen veprat penale që janë kryer përgjatë periudhës 2015-2020. Do të trajtohen veprat që kanë përfunduar si dhe ato që janë më aktuale dhe proceset gjyqësore akoma nuk kanë përfunduar.

2. Hipotezat

Hulumtimi do të ketë dhëna nga ligjet shtetërore dhe institucionet shtetërore përkatëse, të cilat janë kompetente për kryerësit e veprave penale kundër natyrës dhe ambientit jetësor.

Mendimin tim lidhur me këtë kriminalitet e paraqes në bazë të asaj se interesat vetjake të përkohëshme, që mbizotrojnë në kohën moderne janë aq të mëdha, sa që nuk lënë hapësirë për ambientalistët që ndikojnë tek organet kompetente shtetërore, sepse presioni më i madh te ta bie nga ky lloj individësh dhe kompanish gjigante që bëjnë çnatyrizimin e planetit Tokë me politikat e tyre materialiste, këtu mund të flitet edhe për krim të oraganizuar të njerëzve me pozita të larta udhëheqëse.

Tjetër mendim mund të themi se shtimi hapësirave të gjelbëruara dhe mbjellja e fidanëve duhet të jenë në planet e komunave përkatëse, si dhe një punë e palodhshme e inspektorëve të ekologjisë do të ndikonte.

Përmes këtij hulumtimi do të shihet se sa janë efektive sanksionet e parapara në Kodin Penal të RM-së kundër kryerësve të këtyre veprave penale, do të hulumtohet se në mesin e kryerësve cilët persona janë të përfshirë, mosha e tyre dhe a ekziston recidivizmi te këto lloje veprash penale.

Hipoteza primare e këtij punimi është ndikimi i këtyre veprave në shoqëri dhe cënimi i të drejtave elementare për jetë.

Hipoteza sekondare ka të bëjë me problematikën e organeve kompetente, respektivisht rolin e inspektoratit në shqyrtimin e dënimeve dhe parandalimin e këtyre veprave.

Gjithashtu a ekziston nevoja e themelimit të një organi, i cili do të kontribuonte në vetëdijësimin e qytetarëve dhe njoftimin me problematikën dhe pasojat që shkaktohen nga këto vepra.

Hipoteza terciare ka të bëjë me kapacitetin e organeve kompetente për shqyrtimin e dënimeve dhe sa rezulton bashkëpunimi ndërmjet institucioneve për zgjidhjen e problematikave të kësaj natyre.

Për mbledhjen e të dhënave dhe dhënien e një pasqyre sa më reale në lidhje me veprat penale kundër mjedisit jetësor në territorin e Republikës së Maqedonisë, do të shërbehemi me të dhënat statistikore nga enti përkatës për statistika, si dhe për trajtimin, studimin, analizën e kësaj materie, metodat që do të shfrytëzoj do të jenë:

- Metoda historike
- Metoda krahasuese
- Metoda e analizës
- Metoda e studimit të rasteve individuale
- Metoda e anketës dhe intervistës
- Metoda statistikore, etj.

Veprat penale kundër mjedisit jetësor janë në rritje të vazhdueshme, përderisa studimi i tyre i pamjaftueshëm e jo pak i rëndësishëm, prandaj rëndësia e këtij punimi qëndron në atë se gjatë analizës së shkaqeve të kryerjes dhe hulumtimit të këtyre veprave del në sipërfaqe se si rezultat i cilëve faktorë këto vepra janë në rritje të vazhdueshme, si intervenon shteti në kompensimin, dëmshpërblimin dhe mbrojtjen e viktimave, sa ndikojnë sanksionet e parapara kundër këtyre veprave penale në risocializimin e kryerësve dhe vetëdijësimin e qytetarëve në përgjithësi.

3. Metodologjia e hulumtimit

Në këtë punim do të mundohemi që në mënyrën më të mirë të mundshme të përdorim metodat më të reja dhe më efikase për studimin dhe zbërthimin e këtyre veprave penale, që janë kundër natyrës dhe ambientit jetësor, dhe metoda të cilat janë të verifikuara dhe pranuar nga shkencat moderne në luftën e parandalimit dhe luftimit të krimit.

Do të mundohemi që me metodën historike komparative të bëjmë dallimin në mes të asaj se si ka qenë gjendja dhe ligjet kundër ambientit në periudha të ndryshme kohore dhe si kanë ndryshuar, si dhe të bëjmë dallimin se sa aktgjykime kanë pasur në të kaluarën dhe sa ka tani, në kohën më moderne lidhur me krimin ekologjik në përgjithësi, kurse kujdes të veçantë do t'i japim rëndësisë që ka pasur ambienti jetësor në të kaluarën dhe si ka ndryshuar kjo me kalimin e kohës si dhe shtimin e popullsisë dhe nevojave personale.

Në këtë hulumtim do të sigurohen rezultate të nevojshme nga organet kompetente shtetërore nga të dhënat zyrtare, të cilat rezultojnë nga veprat penale kundër mjedisit jetësor dhe ambientit jetësor.

4. Rëndësia e punimit

Veprat penale kundër mjedisit jetësor dhe ambientit jetësor janë në rritje të vazhdueshme, përderisa studimi i tyre i pamjaftueshëm e jo pak i rëndësishëm, prandaj rëndësia e këtij punimi qëndron në atë se gjatë analizës së shkaqeve të kryerjes dhe hulumtimit të këtyre veprave, del në sipërfaqe se si rezultat i cilëve faktorë këto vepra janë në rritje të vazhdueshme, si intervenon shteti në kompensimin, dëmshpërblimin dhe mbrojtjen e viktimave, sa ndikojnë sanksionet e parapara kundër këtyre veprave penale në risocializimin e kryerësve dhe vetëdijësimin e qytetarëve në përgjithësi.

Shpresoj që ky punim do të kontribuojë në njohjen e rrezikshmërisë së këtyre veprave penale për të gjithë personat që jetojnë në Republikën e Maqedonisë, si dhe të kontribuojë për gjetjen e masave më efektive për parandalimin e kësaj dukurie të dëmshme për shoqërinë. mekanizmave ndërkombëtare të sigurimit, në mënyrë që si dukuri të pengohet dhe të luftohet. Ky punim para se gjithash ka rëndësinë e vet të veçantë pasi që do të ngërthejë në vete tematikë të ndryshme në të, mirëpo rol të veçantë do t'i kushtohet rolit të institucioneve, në parandalimin e këtij lloji krimi në shoqëri, si dhe garantimin e kësaj të drejte të mbrojtur me kushtetutë, që në mënyrë të barabartë qytetarët të shfrytëzojnë të mirat që u ka dhënë natyra.

Punimi do të nxjerrë rezultatet, përfundimet dhe rekomandimet e duhura, që do të shërbejnë për avancimin dhe trajtimin e saktë institucional të dukurive negative kriminale duke u munduar, që në të ardhmen gjithnjë e më tepër të zvogëlohet kriminaliteti ekologjik. Mirëpo për të arritur këtë rezultat kërkohet bashkëpunimi më i mirëfilltë i të gjitha organeve, strukturave mbrojtëse dhe shfrytëzimi i masave më adekuate për të luftuar këtë dukuri negative, ku rënia e këtij krimi do të sjellë më tepër harmoni dhe zhvillim të qëndrueshëm të qytetarët, që të mund të avancohet më tepër edhe siguria e tyre edhe pasardhësve të tyre.

KAPITULLI I

1.1. Historiku dhe kuptimi i kriminalitetit kundër natyrës dhe ambientit jetësor

Fenomeni i ndotjes së ambientit jetësor dhe natyrës në fund të shekullit XX ka marrë aso dimensionesh, që padyshim paraqet një nga rrezikshmëritë më të mëdha, me të cilat ballafaqohet njerëzimi. Nga relativisht dukuri marginale, e cila ka shqetësuar vetëm lëvizjet ekologjike, ky fenomen është shndërruar në dukuri të vështirë dhe me pasoja të rënda që preokupon të gjithë banorët e rruzullit tokësor.

Me ndotje nënkuptojmë ndyrshimin kualitativ dhe kuantitativ të veçurive fizike, kimike dhe biologjike të komponentëve kryesorë (ajrit, ujit, tokës, ushqimit etj.) të ambientit jetësor, i cili sjell drejt çrregullimin e ligjshmërive të ekosistemit, të bazuar në mekanizmat e vetëkontrollimit. Këto ndryshime veprojnë sot, por mundën edhe në të ardhmen të veprojnë në masa edhe më të mëdha në kuptim të keqësimit të kushteve shëndetësore ekonomike - prodhuese etj., të jetës në qoftë se nuk merren masat e kontrollit dhe të mbrojtjes. Ambienti jetësor është për çdo ditë më i rrezikuar, që vështirëson jetën dhe ekzistimin e mëtejme të qenieve të gjalla në tokë. Në fakt, njeriu me qëllim të kënaqjes së nevojave të tij është duke ndërruar natyrën. Duke e ndryshuar natyrën, njeriu njëherësh e deformon dhe e degradon atë, duke pasur kujdes ekskluzivisht për nevojat e veta qëllimet e synuara. Njeriu është subjekti themelor, i cili me shpikjet dhe punën e vet sjell zhvillimin e shoqërisë në shkallë të lartë standardi, por në anën tjetër lë pasdore ambientin jetësor, kështu që në kushtet e sotme shoqëria ballafaqohet me probleme të shumta e të ndërlikuara ekologjike. Zhvillimi i hovshëm teknologjik dhe teknik dhe përparimi i njerëzimit nuk duhet të paguhet me çmimin e ndotjes dhe të degradimit të ambientit jetësor. Me aktivitetin e vet njeriu ndot dhe degradon ambientin jetësor në mënyra dhe intensitete të ndryshme.

Kriminaliteti ekologjik është formë bashkëkohore e kriminalitetit dhe pavarësisht nga specifikat e tij, në përkufizimin e këtij nocioni duhet nisur nga të gjitha elementet që e bëjnë thelbin e kriminalitetit, me veçimin se ky i përket fushës së posaçme që ka të bëjë me mbrotjen e ambientit jetësor.

Nga të gjitha format e patologjisë sociale që rrezikojnë ambientin jetësor, format më të rënda të rrezikimit paraqiten si vepra penale të parashikuara në kodet penale ose në dispozitat e posaçme të ligjeve të veçanta, e në thelb ato paraqesin kriminalitet ekologjik

Përmbajtja e nocionit të kriminalitetit ekologjik përfshin të gjitha format e aktivitetit që janë të drejtuara në rrezikimin e ambientit jetësor dhe, si të tilla, të inkriminuara si vepra të caktuara penale në kodet penale dhe ligjet e posaçme. Me kriminalitet ekologjik kuptohet grupi i veprave penale me të cilat mbrohet ambient jetësor. Kriminaliteti ekologjik, si pjesë e kriminalitetit të gjithmbarshëm bashkëkohor siç janë: masiviteti, dinamika, shkalla adekuate, shkathtësia e përshtatjes së marrëdhënieve posa të krijuara shoqërore-politike e ekonomike.

Në raport me zhvillimin e hovshëm shoqëror, ambientit jetësor dhe veprimit të njeriut, janë të pranishme mendimet, sipas të cilave shkak ekskluziv i rrezikimit të ambientit jetësor dhe që paraqiten si shkaqe të kriminalitetit ekologjik. Disa nga këto shkaqe më të rëndësishëm janë: rregullimi parcial dhe jo i plotë juridik i dispozitave që mbrojnë nga ky kriminalitet; joprofesionaliteti i kuadrove për problematikën ekologjike; pajisja e pamjaftueshme teknike e organeve përkatëse që merren me punën ekologjike; aktiviteti i pamjaftueshëm preventiv dhe represiv i organeve kompetente si dhe ndikime të ndryshme të subjekteve politike e ekonomike pa baza juridike në këtë fushë. Tre themelorë kanë kontribuar në ndotjen më të shpejtë të ambientit jetësor.

- shkalla gjithnjë e më e madhe e përfshirjes së begative natyrore në prodhimtarinë industriale dhe prodhimi gjithnjë e më i madh i komponimeve të ndryshme kimike;
- rritja e shpejtë dhe e pakontrolluar e popullacionit të njeriut sidmos atij urban dhe
- përdorimi gjithnjë më i madh i materieve sintetike, të cilat nuk mund të zbërthehen nëpërmjet rrugëve biologjike dhe fizike, përdorimi i mjeteve mbrojtëse në prodhimtarinë industriale dhe teknologjinë e ushqimit (pesticidet dhe aditivitetet), si dhe prodhimi gjithnjë e më masiv i medikamenteve.

1.2. Trajtimi juridik i veprave penale kundër natyrës dhe ambientit jetësor

Trajtimi juridik i veprave penale kundër natyrës dhe ambientit jetësor në kodin penal bënë pjesë te kreu XII.

Si vepra penale kundër natyrës dhe ambientit jetësor sipas Kodit Penal të RMV-së janë:

Ndotja e mjedisit jetësor dhe natyrës, *Prodhimi, tregtia apo përdorimi i substancave të cilat e hollojnë shtresën e ozonit*, Ndotja e ujit të pijshëm, *Prodhimi i mjeteve të dëmshme për mjekimin e kafshëve apo shpendëve*, Dhënia e pandërgjegjshme e ndihmës veterinarë, *Bartja e sëmundjeve ngjitëse në botën shtazore dhe bimore*, Ndotja e ushqimit ose e ujit për kafshët, *Shkatërrimi i të mbjellave me përdorim të materies së dëmshme*, Uzurpimi i paluajtshmërive, *Eksploatimi joligjor i lëndëve të para minerale*, Shkretimi i pyllit, *Shkaktimi i zjarrit në pyll*, Gjuetia e paligjshme, Gjuetia e paautorizuar, ruajtja dhe tjetërsimi i kafshëve të egra dhe i zogjve, Peshkimi i paligjshëm, *Rrezikimi i mjedisit jetësor dhe natyrës me hedhurina*, Furnizimi dhe zotërimi i paautorizuar me materie nukleare, *Prodhimi, të vepruarit dhe qarkullimi i paautorizuar me materie të rrezikshme apo organizma të dëmshme*, Vrasja apo shkatërrimi i llojeve të mbrojtura të florës apo faunës së egër, *Futja e paautorizuar e specieve të egra në natyrë*, Tregtimi, importimi apo transportimi i paautorizuar i florës apo faunës së egër, Mundimi i *kafshëve*, Vepra të rënda kundër mjedisit jetësor dhe natyrës.

Ndotja e mjedisit jetësor dhe natyrës

Neni 218

(1) Ai i cili me mosrespektimin e dispozitave për mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit jetësor do ta ndotë ajrin, truallin, ujin, sipërfaqen ujore ose rrjedhën e ujit në vëllim më të madh ose në territor më të gjerë dhe me atë do të shkaktojë rrezik për jetën apo shëndetin e njerëzve apo zhdukjen e botës shtazore apo bimore në përmasa më të mëdha, apo të llojeve të bimëve ose gjallesave të rralla, do të dënohet me burgim prej katër deri në dhjet vjet.

(2) Personi zyrtar apo përgjegjës në personin juridik, i cili me mosrespektimin e dispozitave për mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit jetësor do të lëshojë të vendosë pajisjet për pastrim apo do të lejojë ndërtim, lëshim në veprim apo shfrytëzim të repartit, i cili e ndot mjedisin jetësor apo në mënyrë tjetër do të lejojë ndërmarrjen e masave për pengimin ose pamundësimin e ndotjes së ajrit, truallit, ujit, sipërfaqes ujore ose rrjedhës së ujit, i cili e kalon kufirin e lejuar ose për pengimin e ushtimës që në mënyrë të konsiderueshme e tejkalon kufirin e lejuar dhe me atë do të shkaktojë rrezik për jetën ose shëndetin e njerëzve apo zhdukjen e botës shtazore dhe bimore në përmasa më të mëdha, apo të llojeve të bimëve ose gjallesave të rralla, do të dënohet me së paku pesë vjet burgim.

Sipas mendimit tim kjo vepër penale duhet të dënohet sipas nenit 218 dhe ai i cili bën shkelje të kësaj vepre penale duhet të dënohet në mënyrë drakonike dhe aspak mos të ketë masa lehtësuese, sepse ndotja e ambientit jetësor dhe natyrës sjell dëme të mëdha në shoqëorinë dhe vendin ku jetojmë.

Nëse kjo vepër kryhet nga pakujdesia, sipas mendimit tim të lirë, si student i së drejtës penale dhe sigurisë duhet të dënohet, por të ketë masa alternative ose lehtësuse, jo vetëm dënim me gjobë ose dënim deri në 3 vjet sipas Kodit penal, dhe për personat juridik mendoj se duhet të ketë masa rigoroze ngase ata janë njohës të fushës të së drejtës, dhe nuk duhet të ketë tolerime lidhur me veprën në fjalë.

Prodhimi, tregtia apo përdorimi i substancave të cilat e hollojnë shtresën e ozonit

Neni 218-a

- (1) Ai që prodhon, importon, eksporton, plasos në treg apo përdor substanca të palejuara, të cilët e hollojnë shtresën e ozonit, do të dënohet me burgim prej tre muaj deri në gjashtë muaj ose me dënim me gjobë.
- (2) Nëse vepra është kryer nga pakujdesia, kryerësi do të dënohet me dënim me gjobë ose me burgim deri në një vjet.
- (3) Nëse veprën e kryen personi juridik, do të dënohet me dënim me gjobë.
- (4) Për veprën nga paragrafi (1) të këtij neni nuk do të dënohet ai që shfrytëzon pajisje shtëpiake të furnizuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

4) A.Osmani Kodi penal i RMV-së fq 185

Ndotja e ujit të pijshëm

Neni 219

- (1) Ai i cili me ndonjë materie të dëmshme do të bëjë të përdorshëm ujin e pijshëm të burimit, pusit, cisternës apo rezervarit apo ndonjë ujë tjetër të pijshëm, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.
- (2) Nëse për shkak të veprës nga paragrafi 1 ka ardhur deri te paraqitja e epidemisë së sëmundjes ngjitëse, kryerësi do të dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.
- (3) Nëse vepra nga paragrafi 1 është kryer nga pakujdesia, kryerësi do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.
- (4) Nëse veprën nga ky nen e kryen personi juridik, do të dënohet me gjobë.

Ndotja e ujit të pijshëm sipas mendimit tim personal lidhur me këtë vepër penale, ai i cili prish cilsinë dhe rrjedhimisht ndikon në jetesën e gjallesave që konsumojnë atë, duhet të dënohet.

Për këtë vepër penale me apo pa qëllim për të gjithë ata persona duhet të ketë dënime të larta, jo vetëm për faktin se ndot ujin e pijshëm, por rrezikohet edhe jeta e njeriut dhe krijesave të gjalla, lidhur me dënimet e parapara të lartpërmendura duhet të ketë, mendoj disa ndryshme në rritje veçanërisht te personat juridik, jo të ketë dënim vetem me gjobë, por dhe me burgim.

Prodhimi i mjeteve të dëmshme për mjekimin e kafshëve apo shpendëve

Neni 220

- (1) Ai i cili për shkak të shitjes do të prodhojë apo do të lëshojë në qarkullim mjete për mjekim apo pengim të infektimit të kafshëve apo shpendëve, të dëmshme për jetën dhe shëndetin e tyre, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.
- (2) Nëse për shkak të veprës nga paragrafi 1 do të ngordhin një numër i madh i kafshëve dhe shpendëve, kryerësi do të dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.
- (3) Nëse vepra nga paragrafi 1 është kryer nga pakujdesia, kryerësi do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.
- (4) Nëse veprën nga ky nen e kryen personi juridik, do të dënohet me gjobë.

Dhënia e pandërgjegjshme e ndihmës veterinare

Neni 221

- (1) Veterinari apo punëtori i autorizuar veterinar i cili gjatë dhënies së ndihmës veterinare pa dyshim cakton apo përdor ndonjë mjet të papërshtatshëm ose pa dyshim zbaton mënyrë të parregullt të mjekimit ose fare pandërgjegjshëm vepron gjatë mjekimit dhe me këtë shkakton ngordhje të bagëtisë apo të gjallesave me vlerë më të madhe, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.
- (2) Nëse vepra nga paragrafi 1 është kryer nga pakujdesia, kryerësi do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

Për këtë vepër penale duhet të ketë sanksion për veterinarin që nuk zbaton rregullat e profesionit të veterinarisë. Kjo vepër penale sipas mendimit tim është e vaçantë, këtë vepër penale mund ta kryejë vetëm veterinari ose ndimësveterinari.

Sa i përketë shkallës së dënimit lidhur me këtë vepër penale është relativisht e ulët, që mendoj të jetë më e lartë, si me qëllim, si nga pakujdesia apo ndryshe njohur si në afekt. Si student i fushës të së drejtës penale dhe sigurisë jap kritikë dhe mendoj se duhet të ketë ndryshime lidhur me ekzekutimin e dënimit të kësaj vepre penale.

Bartja e sëmundjeve ngjitëse në botën shtazore dhe bimore

Neni 222

(1) Ai i cili gjatë kohës së epidemisë së ndonjë sëmundjeje kafshe që mund ta rrezikojë blegtorinë nuk vepron sipas vendimit të organit kompetent, të miratuar në bazë të dispozitës me të cilën caktohen masat e shmangies ose të pengimit të sëmundjes, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

(2) Me dënimin nga paragrafi 1 do të dënohet ai i cili gjatë kohëzgjatjes së rrezikut të sëmundjes dhe të dëmtuarve të cilët mund ta rrezikojnë botën bimore nuk vepron sipas vendimit të organit kompetent të miratuar në bazë të dispozitës, me të cilën caktohen masat e shmangies apo të pengimit të sëmundjes apo të dëmtuarve.

(3) Nëse për shkak të veprës nga paragrafët 1 dhe 2 shkaktohet dëm i rëndësishëm, kryerësi do të dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.

Kjo veprë penale mund të kryhet duke mos kryer veprim që gjatë kohës së pandemisë. Objekt kryesor i kësaj vepre penale është bota bimore, kur kemi të bëjmë me pandemi ngjitëse të kafshët veterinarit duhet të bëjë çmos që të mos vijë deri në përhapjen e sëmundjes, duhet të përcaktohen masa dhe veprime tjera që të parandalohet kjo.

Sa i përket dënimit lidhur me këtë veprë penale jam shumë koshient, por nëse vepra në fjalë kryhet nga pakujdesia ose mosvënia e mendjes se flitet për pandemi të kafshët dhe i njëjti kryen atë veprim, duhet të ketë masa rënduese, mendoj unë sipas mendimit dhe bindjes sime të lirë.

Ndotja e ushqimit ose e ujit për kafshët

Neni 223

(1) Ai i cili me ndonjë materie të dëmshme do të ndotë ushqimin ose ujin e kafshëve në lumenj, përrenj, burime, puse, cisterna apo ndonjë ujë tjetër që shërben për të pirë ujë kafshët, shpendët apo shtazët e egra dhe me atë e sjell në rrezik jetën apo shëndetin e shtazëve, do të dënohet me dënim me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

(2) Me dënimin nga paragrafi 1 do të dënohet ai i cili me ndonjë materie të dëmshme do ta ndotë ujin në peshkore, liqe, lumenj dhe përrenj dhe me atë do të shkaktojë rrezik për ekzistimin e peshqve.

(3) Nëse për shkak të veprës nga paragrafët 1 dhe 2 është shkaktuar ngordhja e shtazëve ose e peshqve në vlerë më të madhe, kryerësi do të dënohet me burgim prej tre muaj deri në tre vjet.

Lidhur me këtë veprë penale është mjaft e rrezikshme për ushqimin dhe ujin e kafshëve, e cila mund të kryhet dhe në mënyra dhe forma të ndryshme.

Me ndotje në këtë rast nënkuptojmë rrezikun, jetën, dhe shëndetin e kafshëve, kjo veprë penale shkakton vërtet pasoja të mëdha dhe mjaft serioze.

Në raport me ekzekutimin e dënimit për këtë veprë penale mendoj se është relativisht mjaft mirë e dënueshme, nëse e njëjta veprë kryhet nga persona juridik, duhet dënimi të jetë me proptencë e jo vetëm gjobë siç parashihet në Kodin Penal.

Shkatërrimi i të mbjellave me përdorim të materies së dëmshme

Neni 224

Ai i cili me përdorim të ndonjë materies së dëmshme do të shkaktojë shkatërrimin e të mbjellave, pemëve apo fidanëve të tjera dhe me atë do të shkaktojë dëm me përmasa më të mëdha, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

Uzurpimi i paluajtshmërive

Neni 225

(1) Ai i cili me qëllim të zotërimit do të marrë paluajtshmëri të huaj, e cila me dispozitë është shpallur pronë në përdorim të përgjithshëm, e mirë nën mbrojtje të përkohshme apo trashëgimi kulturore, raritet natyror apo pasuri tjetër natyrore, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

(2) Nëse vepra është kryer me qëllim që toka të shfrytëzohet për ndërtim ose shfrytëzim me të cilin në mënyrë të pakthyeshme shkatërrohen cilësitë natyrore të paluajtshmërisë, do të dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.

(4) Nëse veprën nga ky nen e kryen personi juridik, do të dënohet me dënim me gjobë.

Çdo pronë e shpallur për përdorim të përgjithshëm, një e mirë nën mbrojtje të përkohshme apo trashëgimi kulturore, vend i rrallë në natyrë dhe me rëndësi të veçantë ose ndonjë pasuri tjetër natyrore, nënkupton të mirat e përgjithshme që na ka falur Zoti dhe janë në mbrojtje të organeve kompetente shtetërore përmes legjislacioneve të ndryshme.

Eksplotimi joligjor i lëndëve të para minerale

Neni 225-a

- (1) Ai që bën eksplotimin e lëndëve të para minerale të caktuara me ligj pa koncesion apo leje për të njëjtën, do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në tre vjet dhe me dënim me gjobë.
- (2) Nëse për shkak të veprës nga paragrafi (1) të këtij neni fitohet dobi apo paraqitet dëm me përmasa të mëdha, kryerësi do të dënohet me burgim prej tre deri në tetë vjet.
- (3) Nëse veprën nga ky nen e kryen personi juridik, do të dënohet me dënim me gjobë.
- (4) Sendet që janë bërë apo përdorur për kryerjen e veprës penale do të merren.

7) A.Osmani Kodi penal i RMV-së fq 189-190

8) D.Asani Hulumtimi Master fq 46

Shkretimi i pyllit

Neni 226

- (1) Ai i cili përkundër rregullave apo urdhrave të organeve apo organizatave kompetente bën ndryshimin e cakt, pret, apo pastron pyje apo thundërzon trungje apo në mënyrë tjetër shkatërron pyllin, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.
- (2) Nëse vepra nga paragrafi 1 është kryer në pyll të mbrojtur, park nacional apo në pyll tjetër me kushtim special, kryerësi do të dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.
- (3) Ai i cili veprën nga paragrafi 1 do ta kryejë në pyllin e vet, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vjet.
- (4) Mjetet e përdorura për kryerjen e veprës do të merren.
- (5) Nëse veprën nga ky nen e kryen personi juridik, do të dënohet me gjobë.

Shkatërimi i pyjeve dhe kullotave në male dhe shndërimi i tokës bujqësore në troje banesash po dëmton florën dhe faunën shqiptare dhe disa nga habitatet më të rralla në Europë, cilëson një studim i PNUD mbi ndikimin e faktorëve njerëzore dhe klimaterike në mjedis.

Shkaktimi i zjarrit në pyll

Neni 227

- (1) Ai i cili do të shkaktojë zjarr në pyll dhe për atë do të shkaktohet dëm me përmasa të mëdha, do të dënohet me së paku tetë vjet burgim.
- (2) Me dënimin nga paragrafi 1 do të dënohet edhe ai që do të shkaktojë zjarr në pyll të mbrojtur, park nacional apo në pyll tjetër me kushtim special.
- (3) Ai i cili do të shkaktojë dy apo më shumë zjarre në pyll, do të dënohet me së paku dhjet vjet burgim.
- (4) Nëse vepra nga paragrafët 1 dhe 2 është kryer nga pakujdesia, kryerësi do të dënohet me burgim prej tre deri në pesë vjet.

Gjuetia e paligjshme

Neni 228

- (1) Ai i cili gjuan egërsirë gjatë kohës kur gjuetia është e ndaluar, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vjet.
- (2) Ai i cili në mënyrë të paautorizuar gjuan në vend të ndaluar për gjueti, vret, plagos apo zë egërsirë të gjallë, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.
- (3) Nëse vepra nga paragrafi 2 është kryer ndaj egërsire të lartë, kryerësi do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.
- (4) Ai që gjuan egërsirë të rrallë apo do të rrallojë, gjuetia e së cilës është e ndaluar apo gjuan pa leje të posaçme egërsirë, për të cilën gjueti është e nevojshme leje e tillë apo gjuan në mënyrë apo me mjete, me të cilat egërsira masovikisht shtypet, do të dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.

Me vepër penale të gjuetisë së paligjshme nënkuptojmë çdo person, i cili do të dalë në gjah dhe do të gjuajë ndonjë kafshë/shpezë të egër, gjatë periudhës kohore kur gjuetia është e ndaluar.

Dënimet për këtë vepër penale janë relativisht të dënueshme, por duhet që personat që nuk kanë licensë në kohën kur gjuetia është e ndaluar, duhet të dënohen ende më shumë, jo sa është e paraparë në kodin penal.

Gjuetia e paautorizuar, ruajtja dhe tjetërsimi i kafshëve të egra dhe i zogjve

Neni 228-a

(1) Ai që gjuan në mënyrë të paautorizuar, transporton, bart, fsheh, ruan, rrit, blen, shet, apo në çfarëdo qoftë mënyre tjetër furnizon, tjetëron, apo gatit kafshë të egra dhe zogj në sasi të mëdha apo me vlerë më të madhe, do të dënohet me dënim me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

(2) Nëse kryerësi i veprës nga paragrafi (1) organizon rrjet për kryerjen e veprës apo nëse vepra është kryer në përbërje grupore apo në shoqatë tjetër apo për shkak të eksportimit të kafshëve të egra apo zogjve jashtë vendit, do të dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.

Kjo veprë penale përpos që paraqet një formë të rëndë të krimit ekologjik, paraqitet në forma të ndryshme. Kjo veprimtari kriminale do të jetë dhe më e rrezikshme, nëse e njëjta do të kryhet në mënyrë të organizuar, dhe personat që merren me këtë veprimtari kriminale kanë përfitime të mëdha financiare.

Sa i përket dënimit ose ekzekutimit për këtë veprë penale pos dënimit me gjobë dhe burgim mendoj se duhet të ketë dhe masa tjera si rreptësi, jotolerancë për ata persona dhe mos t'u jepet licensë për gjuetie të ligjshme kur gjuetia të jetë e lejuar.

Peshkimi i paligjshëm

Neni 229

(1) Ai që gjuan peshq me eksploziv, rrymë, helm, mjete për turbullim, mjete për peshkim nënujor, fuzhnjë, me duar, rrjetë apo mjete tjera, me të cilat është i ndaluar peshkimi, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vjet.

(2) Nëse për shkak të veprës nga paragrafi 1 shkaktohet dëm pasuror me përmasa më të mëdha apo është fituar dobi më e madhe pasurore, kryerësi do të dënohet me gjobë ose me burgim prej tre muaj deri në tre vjet.

(3) Nëse për shkak të veprës nga paragrafi 1 është shkaktuar ngordhje e peshqve në përmasa të mëdha, kryerësi do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.

(4) Nëse veprën nga ky nen e kryen personi juridik, do të dënohet me dënim me gjobë.

Me peshkim të paligjshëm nënkuptojmë, çdokush që gjuan peshq me rrymë, eksploziv, helm, mjete për turbullim, mjete që përdoren për peshkim nënujor, rrjetë apo mjete të tjera, me të cilat është i ndaluar peshkimi.

Lidhur me ekzekutimet e dënimit për peshkimin e paligjshëm duhet të ketë rritje, ngase vendi ynë nuk është shumë ujqor, dhe peshkimi i paligjshëm gjithmonë është në rritje të vazhdueshme, dhe si student i fushës së sigurisë mendoj të ndërmerren masa parandaluese, dhe dënimet të jenë më të larta në kohën kur gjuetia është e ndaluar.

Rrezikimi i mjedisit jetësor dhe natyrës me hedhurina¹

Neni 230

(1) Ai që me lënien, hedhjen, mbledhjen, me transportim joligjor të një apo më tepër dërgesave të lidhura, me përpunim apo mënjanim të mbeturinës, me krijimin e deponive në kundërshtim me rregullat për mbrojtjen e mjedisit jetësor, lëshim të kryerjes së mbikëqyrjes ndaj mbledhjes, me transportin dhe përpunimin, me menaxhimin joligjor të mbeturinës, apo në mënyrë tjetër do të shkaktojë apo mund të shkaktojë dëmtim të konsiderueshëm në kualitetin e tokës, ajrit ose ujit apo rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve apo shkatërrim të botës bimore ose shtazore në përmasa më të mëdha, ose llojeve të rralla të bimëve dhe kafshëve, do të dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.

(2) Nëse vepra nga paragrafi (1) është kryer me mbeturinë të rrezikshme që përmban substanca që kanë cilësinë e eksplozivitetit, reaktivitetit, ndezjes, ngacmimit, helmueshmërisë, infektivitetit, kancerogjenitetit, mutagjenitetit, teratogjenitetit, ekohelmueshmërisë, apo cilësi të të lëshuarit gazra helmuese përmes reaksionit kimik dhe zbërthimit biologjik, kryerësi do të dënohet me së paku katër vjet burgim.

(3) Ai që në mënyrë të paautorizuar tregon me mbeturina, do të dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.

(4) Nëse vepra është kryer nga grup i organizuar i përbërë prej tre apo më tepër personash, kryerësi do të dënohet për veprën nga paragrafët (1) dhe (3) të këtij neni me së paku katër vjet burgim, kurse për veprën nga paragrafi (2) të këtij neni, me së paku tetë vjet.

(5) Nëse veprën nga ky nen e kryen personi juridik, do të dënohet me gjobë.

Që në filllet e para të njerëzimit ekzistojnë mbeturinat. Në fillim këto llogariteshin si substanca me origjinë natyrore (lëkurë, kockë, dru) që dekompozohen dhe zbërthehen në natyrë dhe nuk kishte asnjë problem me mbeturinat e ngurta.

110)Me gjerësisht shih Ligjin për menaxhimin me mbeturina, Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 68/04; 71/04; 107/07; 102/08; 143/08; 124/10; 51/11; 123/12; 147/13; dhe 163/13.

11.)Shih Ligjin për peshkim dhe akuakulturë "Gazeta zyrtare e RM-së", nr. 7/08

Lidhur me dënimet për këtë vepër penale janë relativisht të dënushme mirë.

Furnizimi dhe zotërimi i paautorizuar me materie nukleare

Neni 231

(1) Ai i cili me forcë apo kërcënim, me kryerje të veprës penale apo në mënyrë tjetër pa autorizim do të furnizojë, posedojë apo i do t'i japë tjetrit materie nukleare dhe radioaktive, do të dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

(2) Me dënimin nga paragrafi (1) të këtij neni do të dënohet ai që në mënyrë të paautorizuar prodhon, përpunon, përdor, shfrytëzon, mban, ruan, transporton, importon, eksporton, ndërmjetëson në qarkullim apo mënjanon materiale nukleare apo materie tjera të rrezikshme radioaktive, me çka mund të shkaktojë dëmtim i konsiderueshëm të kualitetit të tokës, ajrit apo ujit apo kërcënim për jetën apo shëndetin e njerëzve apo shkatërrim të botës bimore apo shtazore në përmasa më të mëdha, apo të llojeve të rralla të bimëve apo shtazëve, do të dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.

(3) Personi zyrtar apo personi përgjegjës në personin juridik që do ta mundësojë kryerjen e veprës nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, do të dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

(4) Ai që me veprën nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni do të shkaktojë rrezik për jetën e njerëzve apo për pasurinë në vëllim më të madh, do të dënohet me së paku tre vjet burgim.

(5) Nëse për shkak të veprave nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni ndodh vdekja e një apo më tepër personave apo dëm pasuror në përmasa më të mëdha, kryerësi do të dënohet me së paku pesë vjet burgim.

(6) Nëse vepra nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni është kryer nga pakujdesia, kryerësi do të dënohet me burgim prej tre muaj derë në tre vjet.

Lidhur me këtë vepër penale lirisht mund të themi se është një nga veprat më të rrezikshme dhe më të frikshme, të këtij kapitulli që rrezikon jetën e njeriut dhe botën bimore dhe shtazore.

Në raport me ekzekutimin e këtij dënimi janë relativisht mirë të dënueshme, por vetëm vepra në fjalë nëse kryhet nga persona juridik, besoj duhet të ketë masa të tjera rigorozë e jo vetëm dënim me gjobë.

Prodhimi, të vepruarit dhe qarkullimi i paautorizuar me materie të rrezikshme apo organizma të dëmshme

Neni 232

(1) Ai që në kundërshtim me dispozitat prodhon, përpunon, manipulon, shfrytëzon, mban, ruan, paketon, ripaketon, përdor, transporton, importon, eksporton apo mënjanon materie helmuese apo materie tjera të rrezikshme apo mbeturina të tyre, apo organizma gjenetikë të modifikuara apo të dëmshme të rrezikshme për jetën apo shëndetin e njerëzve, apo për botën bimore ose shtazore, do të dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.

(2) Personi zyrtar apo personi përgjegjës në personin juridik që do të mundësojë kryerjen e veprës nga paragrafi (1) të këtij neni, do të dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

(3) Nëse me veprën nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni është shkaktuar rrezik për jetën e njerëzve apo për pasurinë në vëllim më të madh apo shkatërrim të botës bimore ose shtazore, kryerësi do të dënohet me së paku tre vjet burgim.

(4) Nëse për shkak të veprave nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni ndodh vdekja e një apo më tepër personave, kryerësi do të dënohet me së paku pesë vjet burgim.

(5) Nëse veprën nga paragrafi (1) të këtij neni e kryen personi juridik, do të dënohet me gjobë.

Vrasja apo shkatërrimi i llojeve të mbrojtura të florës apo faunës së egër

Neni 232-a

(1) Ai që vret, shkatërron, mban apo merr ekzemplar të llojeve të mbrojtura të florës apo faunës së egër në sasi që ka ndikim të konsiderueshëm në mbrojtjen e tyre, do të dënohet me burgim prej një deri në tre vjet ose me dënim me gjobë.

(2) Ai që me mospërmbajtje ndaj dispozitave të këtij ligji, ndërmer veprime me të cilat do të hedhë, presë, gërmojë, apo në mënyrë tjetër shkatërron ekzemplarë apo popullatë të species së egër autoktone dhe me të do të shkaktojë çrrënjosje të species së egër autoktone në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut do të dënohet për vepër penale çrrënjosje të species së egër autoktone me burgim prej një deri në tre vjet.

(3) Nëse me veprën nga paragrafi (2) të këtij neni kryerësi do të shkaktojë kërcënim nga çrrënjosja e species së egër autoktone në territorin e Republikës së Maqedonisë, do të dënohet me dënim me burgim prej gjashtë deri në një vjet.

(4) Ai që veprën nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni do ta kryejë nga pakujdesia, do të dënohet me burgim deri në një vjet ose me dënim me gjobë.

Objekt i llojeve të kësaj vepre penale janë flora - bota bimore, dhe fauna - bota shtazore, me këtë vepër penale mund të themi se nuk mbrohet vetëm interesi i mjedisit jetëor, por edhe jeta dhe integriteti i kafshëve.

Lidhur me dënimet për këtë vepër penale duhet të ketë rritje dhe nëse vepra penale kryhet nga pronari sipas Kodit Penal, ligjvënësi ka paraparë jopërgjegjësi penale dhe për personat juridik ku mendoj se duhet të ketë rrethana rënduese ose ndëshkuese.

Futja e paautorizuar e specieve të egra në natyrë

Neni 232-b

- (1) Ai që në kundërshtim me ligjin, pa leje bën futje të specieve të egra në natyrë në territorin e Republikës së Maqedonisë, do të dënohet me dënim me burgim prej gjashtë muaj deri në një vjet.
- (2) Nëse me veprën nga paragrafi (1) të këtij neni ka ardhur deri në çrregullim serioz të baraspeshës natyrore apo çrregullim në biodiversitetin në Republikën e Maqedonisë, kryerësi do të dënohet me burgim prej një deri në tre vjet.
- (3) Nëse vepra nga paragrafi (1) të këtij neni është kryer në atë mënyrë që kryerësi nuk u është përmbajtur masave për mbrojtje preventive gjatë aktiviteteve të caktuara, kryerësi do të dënohet me dënim me gjobë ose me dënim me burgim prej gjashtë muaj deri në një vjet.

Nëse ndokush fut këso lloj specie të egër në Territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, duhet të hetohet mirë dhe te jetë në hetim të mëtutjeshëm dhe të merren masa preventive nga organet kompetente.

Sipas ekzekutimit të dënimit, si student i kësaj fushe mendoj sipas bindjes sime personale të lirë se duhet të ketë rritje deri në 5 vjet e jo siç është paraparë në kodin penal deri në 3 vjet.

Tregtimi, importimi apo transportimi i paautorizuar i florës apo faunës së egër

Neni 232-c

(1) Ai që në mënyrë të paautorizuar tregon, importon, eksporton apo transporton njëshe të gjallë apo të vdekur të species së mbrojtur të florës apo faunës në sasi që kanë ndikim të konsiderueshëm ndaj mbrojtjes së tyre, apo pjesëve ose derivateve nga to, do të dënohet me burgim prej një deri në tre vjet ose me dënim me gjobë.

(2) Nëse vepra është kryer nga pakujdesia, do të dënohet me dënim me gjobë ose me dënim me burgim deri në një vjet.

Mundimi i kafshëve

Neni 233

(1) Ai që në mënyrë të vrazhdë keqpërdor kafshë apo e ekspozon në mundime të panevojshme apo i shkakton dhimbje të panevojshme ose për kënaqësi shpirtërore e ekspozon në vuajtje, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vjet.

(2) Ai që me mosushqim, mosdhënie të ujit apo në mënyrë tjetër e ekspozon kafshën në gjendje të vështirë një kohë të gjatë, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vjet.

Me këtë vepër penale bëhet mbrojtja e kafshëve që janë pjesë e mjedisit shëndetësor, nuk duhet t'i jepet keqtrajtim, vuajtje, ose dhimbje, por dhe forma tjera siç është mosdhënia e ushqimit, ujit ose forma të tjera.

Numri më i madh i keqtrajtimit fizik të kafshëve bëhet në mënyrë arrogante.

Sa i përket dënimit për mundimin, keqtrajtimin e kafshëve duhen të jenë më të larta se sa siç janë paraparë në Kodin Penal.

Për shembull: Mosdhënia e ushqimit, Luftimi mes qenve, Dëmtimet që u shkaktohen kafshëve dhe format tjera duhet të jenë më të dënueshme dhe më rigorozë në dispozitat dhe ligjet penale.

Vepra të rënda kundër mjedisit jetësor dhe natyrës

Neni 234

(1) Nëse për shkak të veprave nga nenet 218 paragrafët (1), (2), dhe (3), 219 paragrafi (1), 230 paragrafët (1) dhe (2) dhe 232 paragrafët (1) dhe (2) shkaktohet lëndim i rëndë trupor ose prishje e rëndë e shëndetit i më shumë personave, kryerësi do të dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

(2) Nëse për shkak të veprave nga nenet 218 paragrafi (3) dhe (4), 219 paragrafi (3) dhe 230 paragrafi (3) shkaktohet vdekja e një apo më shumë personave apo ndryshimet nga ndotja nuk munden gjatë kohë të mënjanohej, kryerësi do të dënohet me së paku katër vjet burgim.

(3) Nëse për shkak të veprave nga nenet 220 paragrafi (1), 221 paragrafi (1), 222 paragrafi (1) dhe 225-a paragrafët (1) dhe (2), 226 paragrafi (1) dhe 230 paragrafët (1) dhe (2) shkaktohet dëm pasuror në përmasa më të mëdha, kryerësi do të dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.

(4) Nëse për shkak të veprave nga nenet 220 paragrafi (3), 221 paragrafi (2), 222 paragrafi (4) dhe 230 paragrafi (3) do të shkaktohet dëm pasuror me përmasa më të mëdha, kryerësi do të dënohet me burgim prej një deri në tre vjet.

(5) Nëse për shkak të veprave nga ky kapitull është shfaqur keqësim i konsiderueshëm i kushteve jetësore në korniza të regjionit të mbrojtur i përcaktuar me ligj, kryerësi do të dënohet me së paku tre vjet burgim.

Të gjithë veprat penale kundër mjedisit jetësor dhe natyrës duhet të kenë disa ndryshime, sipas meje te disa vepra penale dënimet janë të buta ose të lehta dhe te disa janë më të dënueshme, por jam shumë skeptik se duhet të ketë ndryshime dhe reforma në sistemin juridik.

17) A.Osmani Kodi penal i RMV-së fq 194

1.2.1 .Konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare lidhur me veprat penale kundër natyrës dhe ambientit jetësor

Sipas informatave zyrtare në dispozicion në faqen e internetit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Maqedonia e Veriut ka qenë pjesë e 41 traktateve shumëpalëshe ndërkombëtare në lidhje me aspekte të ndryshme të mjedisit. Këtu do të përmendim disa.

Konventat ndërkombëtare, deklaratat, protokollet, kushtetuat, ligjet.

Konventa mbi ligatinat me rëndësi ndërkombëtare për mbrojtjen e zogjve ujorë (Ramsar).

Konventa e ndikimeve ndërkufitare mjedisore (Konventa Espoo)

Protokolli mbi vlerësimin strategjik të ndikimit në mjedis

Konventa mbi Diversitetin Biologjik (Konventa Rio, 1992)

Protokolli mbi biosigurinë (Cartagena Protocol)

Konventa mbi Qasjen në Informata, Pjesëmarrjen Publike në Vendimmarrje dhe Qasje në Drejtësi në çështjet që lidhen me mjedisin (Konventa ARHUNSKA)

Protokolli Regjistri i ndotjeve dhe transferimit të ndotësve (PRTRs Protocol)

Konventa për Ruajtjen e llojeve migratore të kafshëve të egra (Konventa e Bonit)

Konventa për Ruajtjen e Jetës së Egër dhe Habiteteve Natyrore Evropiane (Konventa e Bernës)

Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Botërore Kulturore dhe Natyrore

Konventa për mbrojtjen e ozonit Cover (Konventa e Vjenës)

Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara të Florës dhe Faunës

Konventa për ndotjen e ajrit në distancë të largët Ndërkufitare (Konventa e Gjenevës)

Konventa mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm (Konventa e Stokholmit)

Ministria e ambientit jetësor dhe planifikimit hapësinor është institucion zyrtar dhe kyçës në Republikën e Maqedonisë për zhvillimin dhe miratimin e projekteve dhe ligjeve në lidhje me mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Ajo është e ndarë në disa sektorë:

- Sektori për çështje evropiane, sektori për zhvillim të qëndrueshëm,
- Departamentit të Planifikimit Hapësinor,
- Departamenti i legjislacionit dhe i standardizimit,
- Qendra Informative për Mjedisin,
- Sektori i administrimit Mjedisor,
- Sektori i GIS,
- Inspektorati shtetëror për mjedisin jetësor,
- Drejtoria për marrëdhënie me publikun

Administrata e mjedisit kryen veprimtari profesionale dhe mbikëqyrjen teknike mbi zonat e

mbrojtura të natyrës, burimet e ndotjes së tokës, ujit dhe ajrit, propozime për zgjidhje profesionale, teknike dhe teknologjike për zvogëlimin ose parandalimin e ndotjes dhe shkatërrimin e mjedisit, duke studiuar dokumentacionin teknik mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës

dhe përmirësimin, masat zbatuese dhe monitorimin e ndryshimeve të mjedisit, d.m.th. ndryshimet në natyrë. Ligji për mjedisin ka për qëllim mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë dhe gjendjes së mjedisit, tokës, ujit, ajrit, biodiversitetin dhe burimet e tjera natyrore, si dhe mbrojtjen e shtresës së ozonit dhe parandalimin e ndikimeve negative të njeriut në sistemin e klimës.

1.2.2 Trajtimi kriminalistik i kriminalitetit ekologjik

Pas pranimit të kallëzimit penal ose njoftimit të marrë për veprë penale të kryer, e cila ndiqet me detyrë zyrtare, policia është e obliguar t'i ndërmarrë masat e nevojshme për gjetjen e kryerësit të veprës penale, të parandalojë kryerësin ose bashkëpunëtorin që mos të fshihet ose ikë, që të zbulohen dhe sigurohen gjurmët e veprës penale dhe dëshmive që mund të shërbejnë si argument, si dhe t'i mbledhë të gjitha njoftimet, që do të mund të jenë në dobi të udhëheqjes së sukseshme të procedurës penale.

-Për kryerjen me sukses të detyrave të mësipërme organet e autorizuara mund të ndërmarrin veprime operative dhe procesuale kriminalistike në sqarimin e veprës penale ekologjike. Veprimet operative që merren nga ana e organeve, që merren me zbardhjen e veprave penale ekologjike që i kanë si autorizime në punën e përditshme janë: thirrja e qytetarëve për dhënien e informatave, vërtetimin e alibisë, kontrolli në dokumentacionin e personit juridik, përdorimin e poligrafit, shfrytëzimi i evidencave kriminalistike, organizimin e pritave, racisë, përdorimin e qenit policor, veprimtarinë patrulluese, legjetimimin, kontrollimin, dhënien e urdhrave, përdorimin e mjetit për përdorim etj.

1. Thirrja e qytetarëve për mbledhjen e informatave

Mbledhja e informatave nga kategori të ndryshme të qytetarëve është kërkim joformal (joprocesual) me vetëiniciativë të personave të autorizuar për mbledhjen e informatave/ njohurive që do të ishin në interes të udhëheqjes me suksese të procedurës paraprake dhe asaj penale. Gjatë mbledhjes së informatave më së shumti bëhet fjalë për mbledhje të dëshmive të supozuara verbale (thënie nga i dyshuari i mundshëm ose dëshmitari i mundshëm meqë secili prej këtyre mund të ndryshojë deklaratën e dhënë në procedurën e mëtutjeshme). Biseda informative në esencë është “marrja e parë në pyetje”, ajo është shumë e përshtatshme për të drejtuar dhe përcaktuar të gjitha provat e ardhshme të vlefshme për procesin.

Për ta kryer bisedën, kriminalisti duhet të jetë i informuar sa më shumë për veprën penale ekologjike, se është i informuar për të gjitha elementet e veprës penale.

Biseda bëhet me kategori të ndryshme të qytetarëve që të mblidhen informata për veprime ose sende që janë jo të ligjshme.

Duhet të bëhet bashkëpunim dhe kriminalisti të ketë dhe të tregojë përvojë të madhe lidhur me psikologjinë ose rrethin social nga vjen bashkëbiseduesi, duhet të njohë mirë rregullat ligjore që janë në konform me ligjin dhe të mos prekë identitetin ose diçka që mund të lëndojë viktimën.

Kriminalisti duhet të lërë vizitkartën në rast kur mund të ndryshojë mendje bashkëbiseduesi ose që gjen diçka që ka të bëjë me veprën penale ekologjike.

20).N.ETEMI KRIMINALISTIKA EKOLOGJIKE FQ 141-142

2. Vërtetimi i identitetit të personave

Për kryerjen e detyrave nëpunësi i autorizuar (policia e pyjeve, pjesëtarët e shërbimit të rojës- të territorit të mbajtur) përpos shumë veprimeve tjera (ndalimin, kontrollimin etj.) ka të drejtë të ndërmarrë veprimin operativo-taktik, të legjitimojë njerëz në çdo vend, nëse ekziston dyshim i bazuar se te ata do të gjenden gjurmë të veprës penale ose sende që mund të shërbejnë si argument, ose janë kryerës të një vepre penale ose kundërvajtje ekologjike.

Komunikimi me qytetarët në rrethana të ndryshme është një aspekt jetik për një nëpunës i autorizuar që kryen detyrat e tij në mbrojtjen e ekosistemit. Nënpunësi i autorizuar ka qindra e mijëra ndërveprime me njerëzit çdo ditë. Vlera e komunikimit ndërmjet nëpunësit të autorizuar dhe publikut është një komponent integral i sigurisë ekologjike.

Këtë veprim operativo-taktik mund ta kryejnë vetëm persona zyrtarë të MPB-së dhe Policisë Pyjore, ky veprim ndërmerr dhe aktivitetet tjera siç janë: Racia, Prita, Arrestimi, Vëzhgimi etj. Verifikimi, apo ndryshe njohur si legjitimimi, bëhet në mënyrë direkte nga pjesëtarët e e lartpërmendur, verifikimi kryhet me dokumente udhëtimi, leje për vozitje, letërnjoftim, pasaportë, dhe dokumente të tjera në të cilën tregohet me fotografi të personit.

Legjitimimi i personave bëhet në hapësira të ndryshme nëse dyshohet ose bëhet fjalë për veprën penale, në këtë rast për veprën penale ekologjike, ky aktivitet ndërmerret në rrugë, male, sipërfaqe

ujore etj, ky lloj aktiviteti operativ nuk ndërmerret vetëm se mund të bëjë për një krim të caktuar, kemi raste në praktikë kur kemi dyshim për diçka mund të ndërmerret ky lloj aktiviteti operativ.

3. Dhënia e urdhrave dhe paralajmërimeve

Nëpunësi policor do ta paralajmërojë personin, i cili me sjelljen e vet, me veprimin ose moszbatimin e veprimeve të caktuara mund të sjellë në rrezik sigurinë e vet, sigurinë e personave të tjerë ose sigurinë e pronës, ta prishë rendin dhe qetësinë publike, ose ta rrezikojë sigurinë e komunikacionit rrugor ose kur pritet me arsye se ai person mund të kryejë ose të nxitë personat e tjerë të bëjnë vepër penale ose kundërvajtje.

Nëpunësi policor në kryerjen e punëve policore mund të japë urdhër gojor në rastet kur kjo është e nevojshme:

- që të mbrohet jeta dhe siguria personale e personave dhe pronës;
- që të parandalohet kryerja e veprës penale, për të cilën ndiqet me detyrë zyrtare ose kundërvajtje, që të sigurohen gjurmë të veprës penale ose sendeve që mund të shërbejnë si dëshmi në procedurën penale ose për kundërvajtje;
- të mbahet rendi ose të pengohet prishja e rendit dhe e qetësisë publike, si dhe për rivendosjen e rendit dhe qetësisë së prishur publike;
- për mbrojtjen e sigurisë së objekteve dhe personave të cilët sigurohen;
- për kontrollin, rregullimin dhe sigurinë në komunikacionin rrugor;
- për sigurimin e kufirit shtetëror dhe kontrollin e kalimit të kufirit shtetëror; dhe
- për shpëtimin e njerëzve dhe mënjanimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësive të tjera.

Paralajmërimi dhe urdhërimi bëhen në mënyrë të qartë, të padyshimtë dhe të kuptueshme.

4.Ndalimi dhe kontrollimi i personave, mjeteve transportuese dhe bagazhit

Për realizimin e detyrave të komplikuar dhe deliktet për zbardhjen dhe parandalimin e veprave penale ekologjike organet komponente (Policia, Drejtoria Dogaore, Policia Pyjore, Shërbimi i rojës) janë të autorizuar që të mund të ndalojnë dhe kontrollojnë persona, mjete transportuese dhe bagazhin e tyre. Ndalimi dhe kontrollimi i personave, mjeteve transportuese dhe bagazhin e tyre është mjaft i rëndësishëm për veprimin preventiv dhe represiv të organeve kompetente të luftimit të kriminalitetit ekologjik.

Me kontroll të mjeteve transportuese dhe bagazhit janë gjithë kontrollet e jashtme, teshave dhe sendeve tjera. Kontrolli kryhet me udhër të gjykatës kompetente të atij territori që mund të ketë prova për vepër penale ekologjike.

Kontrolli I personit, mjeteve transportuese, bagazhit kryhet në vende të dukshme dhe duhet të respektohet neni 63 pika 3 LP, kontrolli ndaj personave duhet të kryhet nga gjina e njëjtë, dhe kontrolli duhet të zgjatë më së shumti 6 orë.

Çdo nëpunës që vendos të ndalojë një automjet duhet të jetë i vetëdijshëm se mbart me vete një rrezik të caktuar (p.sh. transportuesit e paligjshëm të drunjëve). Vështirë është të bëhet zbulimi dhe identifikimi i mjeteve transportuese në kohë me shi, mot të keq, mjegulla, borë etj.

Nëpunësi duhet të jetë gjithmonë me uniformë, doreza, dhe llampa të veçanta. Kur ndalohet automjeti duhet të monitorohet sjellja e personave në makinë, dhe patjetër të zbatohen disa procedura për ndalimin e tij.

Kontrolli i personit shikohet dhe kontrollohen teshat e mbajtura, duhet të bëhet kontrolli a ka ndonjë armë, eksploziv dhe sende të tjera, gjatë kontrollit duhet të shihen karakteristikat e personit, mosha, gjinia, amësia, fejam orientimi seksual.

Kontrolli i personit bëhet sipas renditjes duke filluar nga lart - poshtë deri te koka dhe këmbet,

patjetër në detaje dhe duhet të zbatohen disa teknika tjera për këtë kontroll, që është në ligjin mbi policinë.

Kontrolli i mjetit transportues - një nëpunës mund të ndalojë një automjet me udhëtarë që gjendet në të, nëse dyshohet se mund të ketë diçka joligjore në të p.sh.: për vepra penale ekologjike, në këtë rast armë për gjuajtjen e kafshëve, të ndryshme, prona të vjedhura etj, në praktikë kemi shumë raste në pikat kufitare doganore që ndodhin shpesh vepra të ndryshme penale.

Mjetet transportuese sidomos në periudhën e natës kemi raste për mall ose tregti me njerëz, ku janë zbuluar dhe konfiskuar vepra të ndryshme të tilla sidomos në vendin tonë.

Me kryerjen e kontrollit transportues përdoren mjete teknike, pasqyra, detektor, qeni policor etj. Çdo kontroll i mjetit transportues kryhet në mënyrë sistematike.

Për çdo lloj të kontrollit transportues dhe bagazhit formulohet procesverbal, të cilin e nënshkruajnë nëpunësit policorë.

5. Kontrolli i përkohshëm i lëvizjes në një zonë të caktuar

Kufizimi i përkohshëm i lëvizjes në një zonë të caktuar mund të jetë në funksion të sigurimit të vendit të ngjarjes ose në funksion të mbrojtjes së vlerave të caktuara të natyrës. Kufizimi i lëvizjes mund të jetë i lidhur me zhvillimin e ngjarjeve të caktuara në zonën e parkut me qëllim mbrojtjen e vlerave të parkut të natyrës. Kufizimi i lëvizjes mund të jetë gjithashtu në funksion të mbrojtjes së qytetarëve nga burime të ndryshme rreziku siç janë: rrëshqitjet e tokës, ortekët, rënia e linjave të energjisë, pemët, dhe të ngjashme.

Nëpunësi policor gjatë sigurimit të vendit të ngjarjes ku është kryer vepra penale, kundërvajtje ose ndonjë ndodhi, përveç masave tjera do të ndërmarrë edhe masën e mbajtjes së dëshmitarit nëse do të gjendet/haset në vendin e ngjarjes ose nëse është kapur nga persona tjerë.

Policia ka të drejtë që personat e gjendur në vendin e kryerjes së veprës penale t'i dërgojë te prokurori publik ose t'i mbajë deri në ardhjen e tij, nëse ata persona do të mund të japin të dhëna të rëndësishme për procedurën penale dhe nëse është e sigurtë se marrja e tyre në pyetje më vonë nuk do të mund të realizohet ose do të jetë e lidhur me zvarritjen e rëndësishme ose vështirësi tjera.

Për arsyet e mbajtjes njoftohet personi i mbajtur. Mbajtja e këtyre personave në vendin e kryerjes

së veprës penale nuk mund të zgjatë më shumë se gjashtë orë (Neni 281 LPP dhe neni 50-b LP)

23.Q.Avziu Hyrje ne kriminalistik fq 254-255

24.N.ETEMI KRIMINALISTIKA EKOLOGIKI FQ 157

6.Veprimtaria patrulluese dhe policimi në komunitet

Angazhimi i komunitetit përmes partneritetit me policinë i lejon asaj të shpreh pikëpamjet e saj për sa i përket problemeve mjedisore dhe të zbulojë ato më të rrezikuarat, të cilat mund të rezultojnë në përfshirjen e tyre në veprimin dhe praktikën proritare të policisë.

Prania e vazhdueshme e policisë në një zonë të caktuar për një periudhë më të gjatë mundëson që ata të njohin qytetarë që jetojnë dhe punojnë në atë komunitet, si dhe të vërejnë rrethanat që mund të çojnë në kriminalitet ekologjik dhe në degradimin e mjedisit. Dukshmëria dhe disponueshmëria e policisë dhe kontaktet e drejtëpërdrejta ditore me qytetarët kontribuojnë në përmirësimin dhe krijimin e kanaleve të rregullta, të dyanshme të komunikimit. Në këtë mënyrë inkurajohet bashkëpunim dhe krijohet besim i ndërsjellë midis policisë dhe komunitetit. Në kontakt të drejtëpërdrejtë me qytetarët, policia duhet të punojë për të rritur ndërgjegjësimin e tyre për rëndësinë e ruatjes së mjedisit dhe natyrës.

Organizimi i patrullave speciale për të vizituar zonat ku manifestohen indikacione të shumta të ndotjes së mjedisit ose krimit ekologjik, do të siguronin një pasqyrë të drejtëpërdrejtë të një problemi specifik, si dhe vëzhgimin e vendeve dhe mundësive që rrezikojnë mjedisin (p.sh. laboratorë të ndryshëm, punëtorim depo, ruajtjen e lëndëve plasëse, toksike dhe të tjera të rrezikshme, ndotjen e lumenjve dhe liqenve, shkatërimi i pyjeve et.), dhe mbledhja më mirë e informatave, që do të interpretohen, dokumentohen dhe përcillen te autoritetet kompetente.

Sipas mendimit tim qytetarët duhet të bashkëpunojnë me policinë, që se bashku të zgjidhin problemet lidhur me mjedisin jetësor. Në librin e Kriminalistikës Ekologjike të Prof. Naser

Etemit theksohet se duhet të funksionojnë “kanale dykahëshe komunikimi midis policisë dhe qytetarëve”, ku mendoj se duhet të funksionojë dhe ekzistojë te të gjithë veprat penale.

7. Përdorimi i qenit policor

Në shumë aksione operative të policisë, shfrytëzohen edhe qenët e dresuar. Dihet se shqisat e qenve janë shumë të zhvilluara, kështu shqisa e dëgjimit, nuhatjes, të pamurit etj., ndikojnë që në ndërmarrjen e veprimtarisë gjurmuese dhe masave tjera operative të kenë sukses të madh.

Varësisht nga nevojat e policisë, ekzistojnë disa lloje qenësh special: kështu ekzistojnë qen për kërkim, për mbrojtje, për roje etj. Qeni për kërkim apo qeni gjurmues, shqisën e të nuhatrit e ka të zhvilluar një milion herë më shumë se njeriu, prandaj ata mund të shërbejnë në zbulimin e shumë veprave penale të ndryshme, por dhe atyre ekologjike.

Në praktikë kemi shumë raste ku kryerësi ka ikur, gjatë ikjes i ka rënë ndonjë send nga trupi, është zbuluar nga qeni i policisë. Qenet përdoren në shumë aksione, ku në disa shtete pos qenve përdoren edhe derrat e egër.

8. Kurthi

Kurthi është veprim sekret policor që përdoret në raste të veçanta të zbardhjes së veprave penale ekologjike, të cilat kryhen në vazhdimësi dhe që nuk mund të arrestohen kryerësit e tyre në mënyrë tjetër. Bëhet fjalë për kryerës që kryjnë vepra penale në mënyrë të njëjtë apo në rrethana të ngjajshme. Si vepra penale ekologjike që kryhen në mënyra të këtilla që paraqesin vështirësi për organet e zbardhjes së krimeve janë: vjedhja dhe prerja e drunjve, vënia e zjarreve, ndotja e mjedisit jetësor dhe natyrës, ndotja e ujit për pije, gjuetia e paligjshme, peshkimi i jashtëligjshëm etj.

Në kuptim më të gjerë, kurthi policor nënkupton një operacion të fshehtë, me të cilin policia ose shërbimi i sigurisë përmes teknikave të ndryshme të mashtrimit- si rregulla për identitetin apo synimet e vërteta të anëtarëve të tij ose pjesëmarrësve të saj- kërkon mbledhjen e të dhënave, të gjejnë prova, ose të sjellin autor të veprave të paligjshme. Kurthet policore kryhen zakonisht nga nëpunësit policor që janë posaçërisht të trajnuar për këto lloje të veprimeve, por këto aksione mund të ndërmerren së bashku edhe me qytetarë dhe persona tjerë.

26.Q.Avziu Hyrje ne kriminalistik fq 223

27.N.ETEMI KRIMINALISTIKA EKOLOGIKI FQ 167

9.Përdorimi dhe llojet e mjeteve të detyrimit

Aktet juridike të RMV-së përcaktojnë se vetëm organet shtetërore kanë të drejtën të zbatojnë mjetet e detyrimit, ndërsa në situata të veçanta kjo mund të bëhet nga qytetarët në situata të përcaktuara ma ligj. Në të dy rastet, mjetet e detyrimit do të zbatohen kur të gjitha mjetet e tjera janë shterur ligjërisht. Forca duhet të jetë e përmbajtur, proporcionale dhe me një paralajmërim paraprakisht që do të përdoret forca.

Mjetet e detyrimit më së shumti i përdorin nëpunësit policorë, por ato i përdorin edhe nëpunësit tjerë siç janë personat e autorizuar të Drejtorisë Doganore, Policisë Pyjore etj. Gjatë kryerjes së punëve të përditshme të nëpunësve të autorizuar kur vijnë në kontakt me qytetarët.

Mjetet e detyrimit mund të përdoren si mjet i fundit nëse qëllimi i veprimit të nëpunësve të autorizuar nuk mund të kryhet në mënyrë tjetër, mjetet e detyrimit duhet të përdoren nga masa më e lehtë deri te ajo më e rëndë.

Nëse një person reziston, atëherë vjen deri te mjetet e përdorimit, si forca fizike ose sende tjera dhe në fund nëse ka rrezik vjen deri tek arma e zjarrit.

Si mjete të detyrimit sipas LP janë: forca fizike, shkopi i gomës, mjetet për prangosje të personave, mjete për ndalim të detyrueshem të automjetit, qeni zyrtar, mjetet kimike, arma e zjarrit, dhe mjetet shpërthyes.

10. Ndjekja dhe vëzhgimi sekret

Format e shumta dhe të rënda të krimeve ekologjike, vështirë ose aspak nuk japin të dhëna për ekzistimin e tyre, apo për dyshimin e ekzistimit të tyre, prandaj shpesh përdoret vëzhgimi dhe ndjekja e fshehtë për të siguruar të dhëna të mjaftueshme, për të vazhduar me veprimet e mëtutjeshme hetuese. Ndjekja dhe vëzhgimi është një mjet i shkëlqyeshëm për mbledhjen e informacionit, sepse mund të zbulojë veprime të paligjshme dhe personat e përfshirë në ta. Zbardhja e një vepre penale është një proces në të cilin njohuritë, përvoja dhe tenikat hetimore janë të kombinuara për të gjurmuar dhe vërtetuar të dhënat e ndryshme që mblidhen. Qëllimi i çdo hetimi ekologjik është qartësimi i pretendimeve, rrethanave të dyshimta dhe situatës, në të cilën është kryer krimi ekologjik. Këto të dhëna janë kryesisht të fshehura dhe do të gjenden dhe përdoren vetëm me anë të një qëndrimi pozitiv dhe qasjes entuziaste nga kriminalisti. Vëzhgimi dhe ndjekja sigurojnë informacione të çmuara që ndriçon natyrën sekrete të veprimeve kriminale ekologjike, veçanërisht të formave të krimeve të rënda ekologjike.

Ndjekja dhe vëzhgimi sekret mund të bëhet me ndjekje fizike dhe ndjekje elektronike. Gjatë ndjekjes dhe vëzhgimit fizik përdorim tenika të ndryshme: vëzhgimi statik (me anë të mjeteve elektronike dhe vëzhgimi fizik), dhe ndjekja mobile (lëvizhme). Ndjekja mobile bëhet në këmbë, dhe e lëvizshme (me mjete motorike). Vëzhgimi fizik mund të kryhet në mënyrë të pavarur nga vëzhgimi elektronik. Të dy komponentët punojnë ndaras njëra prej tjetrës, por njëra mund të plotësojë tjetrën.

Ndjekja dhe vëzhgimi sekret nuk kryhet vetëm te veprat penale kundër mjedisit dhe natyrës, por dhe te të gjithë format tjera, ndjekja ose vëzhgimi sekret kryhet dhe ne ex-fico (detyrë zyrtare)

ndaj personave që kanë pozitë të lartë shtetërore dhe që të njëjtat i keqpërdorin për çështje personale të tyre.

11. Veprimtaria e kërkimit

Ka një numër të pafund vendesh që mund të fshehen kriminelët pas kryerjes së një vepre penale ekologjike, duke e bërë jashtëzakonisht të vështirë për policinë që t'i gjejë, pasi ata janë larguar nga vendi i ngjarjes. Njësitë organizativ policor ka burime të kufizuara që mund të caktohen për të kërkuar kriminelët që janë në ikje.

Veprimtaria e kërkimit është sistem kriminalistiko-taktik i ndërmarrjes së veprimeve nga ana e organeve të punëve të brendshme me urdhër të organeve tjera ose me vetëiniciativë, me qëllim të gjetjes së kryerësit të veprës penale, personave tjerë të rëndësishëm për ndonjë procedurë gjyqësore, sende që kanë lidhshmëri me veprën penale dhe trupa ose pjesë trupash të pajetë.

Veprimet e kërkimit i nxjerrin dhe i ndërmarrin organet e punëve të brendshme sipas vendit të organit që sjell urdhrin për nxjerrjen e tij. Organi që sjell urdhrin mund të jetë gjyqi, organi për ekzekutimin e sanksioneve, institucionet korrektuese, Ministria e Punëve të Brendshme.

Veprimet kërkimore janë: fletarresti, shpallja, dhe qarkorja për kërkim.

Kryerësit zakonisht nuk veprojnë në një vend. Ata pas kryerjes së krimit ndodh që sipas rrethanave të ndodhjes së rastit që një kohë të qëndrojnë në një vend (afër vendit të krimit) ose të lëvizë në vende të ndryshme. Ata mund të fshihen në vende të ndryshme, në rajon më të gjerë, ndërsa disa prej tyre kalojnë edhe kufirin e shtetit. Si rezultat i lëvizjeve të këtilla bëhet edhe ndarja e kërkimeve sipas karakterit territorial dhe organizativ policor. Sipas regjionit të kërkimit dallohen këto forma të kërkimit: kërkimi lokal, kërkimi qendror, dhe kërkimi ndërkombëtar.

12.Evidencat kriminalistike

Evidencat kriminalistike paraqesin mbledhje të planifikuar dhe të organizuar, shënim të të dhënave dhe të veprave penale të përgatitura dhe të kryera, të kryerësve, të objekteve dhe të gjurmëve të veprave penale, si dhe të verpimeve kriminalistike dhe të aktiviteteve të cilat janë të rëndësishme për zbulimin dhe ndriçimin e veprave penale, të kryerësve të tyre, identifikimin e tyre dhe në përgjithësi për ndërmarrjen e masave preventive kriminalistike për evitimin e kryerjes së veprave penale nga kryerësit e evidentuar.

Evidencat kriminalistike i takojnë sferës së informatikës kriminalistike. Informatika kriminalistike e ndihmuar nga teknologjia e informatikës është një veprimtari informatike në sferën e luftimit të kriminalitetit. Ndër të tjera në suazat e saj kryhen edhe procese të caktuara informatike të evidentimit, pranimit, arkivimit, dhe përpunimit të të dhënave, thjesht selektimi dhe përpunimi analitik, si dhe bartja dhe pasqyrimi i informatave.

Evidencat kriminalistike kanë karakter të dyfishtë:

- (A) karakter procedural juridik – sepse në bazë të tyre konstatohen disa fakte relevante juridike;
- (B) karakter kriminalistik - operativ – sepse ndihmojnë zbulimin e kryerësve të panjohur të veprave penale, caktimin e veprës së kryer penale dhe furnizimin me prova për veprën dhe për kryerësin e saj.

Sipas detyrave të tyre themelore, evidencat kriminalistike mund të ndahen në tri grupe të mëdha:

- (1) evidencat penale – në të cilat futen të dhënat për të dënuarit dhe personat e paraqitur;
- (2) evidencat e posaçme operative – në të cilat futen të dhënat të cilat mund të shërbejnë për zbulimin dhe argumentimin e veprës penale dhe kryerësit të saj;
- (3) evidencat të cilat shërbejnë për vërtetimin e identitetit, p.sh., kartela e identifikimit me fotografi dhe evidence daktiloskopike e 10 gishtërinjve.

13. Vërtetimi i alibisë

Nocioni alibi rrjedh nga latinishtja alibus- që d.m.th. diku tjetër. Ky term shumë shpesh përdoret në jetën e përditshme dhe si zakonisht nënkupton diçka që ka të bëjë me fajin e kryerësit, pasi ngatërrohet me indicien e pranisë në vendin e ngjarjes.

Shpesh ndodh që personi të paraqitet me alibi pasi që ka kryer krimin ekologjik (p.sh. vënia e zjarrit në hapësirat malore, derdhja e substancave kimike të dëmshme etj). Praktika kriminalistike kërkon që shpeshherë të vërtetojë alibinë, të cilën e japin persona të kategorive të ndryshme në fazat e ndryshme të procedurës penale. Alibia është dëshmi që e përjashton mundësinë e kryerjes së krimit dhe se ndaj tij përjashtohet mundësia e ndërmarrjes së veprimeve hetimore si i dyshuar kryesor. Por kjo nuk do të thotë se organet hetimore të mos ndërmarrin veprime për të realizuar alibinë të veprimet e kundërligjshme ekologjike.

Në praktikë ka pasur shumë raste kur kryerësi në mënyrë dinake ka qënduar me miq e shokë ose ka shkuar në punë ose në ligjërrata, ku është evidentuar dhe pastaj pa mos u vërejtur ka dalur e ka kryer një vepër penale dhe përsëri është kthyer aty, që të mos dyshohet më pas si i akuzuar.

14.Prita

Pusia është veprim i organizuar kriminalistik taktik, gjegjësisht vëzhgim dhe mbikëqyrje e fshehtë e hapësirës dhe objektit me qëllim të zbulimit dhe arrestimit të kryerësit të veprës penale.

Për suksesin e pritës është me rëndësi që kriminalistët t'i përmbahen parimit kriminalistik të shpejtësisë apo urgjencës, të befasisë dhe konspiracionit "fshehtësisë". Duke pasur parasysh qëllimin dhe detyrën, pusia mund të ketë njëkohësisht karakter represiv dhe preventiv, ashtu që befasia dhe konspiracioni ta përbëjnë esencën e pusisë.

Konspiracioni është i rëndësishëm gjatë përgatitjes së pritës, kurse përbëhet para së gjithash nga vëzhgimi i fshehtë dhe vrojtimi i vendeve ku vendoset pusia, verifikimi i fshehtë i personave interesant, dhe gjithsesi puna e fshehtë e çdo polici veç e veç.

Prita si masë dhe veprim taktik-operativ ka ngjashmëri të madhe me vëzhgimin e përkohëshëm, por dallohet për nga detyra e saj, e cila është në të gjitha rastet e papritur dhe intervenimi energjik i policisë i drejtuar kundër një personi të caktuar i cili ka lidhshmëri me veprën penale ose me ngjarjen penale.

Arrestimi i kryerësit të veprës penale duhet të jetë i shpejtë dhe i befasishtëm në mënyrë që ai të mos mund të ofrojë rezistencë, të ikë, dhe t'i hedhë apo asgjësojë objektet e veprës penale.

Prita mund të jetë e fshehur dhe e maskuar. E fshehur – në rastet kur punëtorët e policisë janë të shpërndarë në vende të fshehura dhe aspak nuk duken.

E maskuar – kur pjesëtarët e policisë janë të dukshëm, por ata janë të maskuar dhe nuk lënë përshtypje se janë policë.

15.Përdorimi i Poligrafit

Poligrafi ose detektori i gënjeshtres është një instrument i vjetër që për herë të parë e përdori Qezare Lombrozo dhe të tjerë. Ky instrument kishte për qëllim që të zbulojë njeriun kur ai gënjente.

Është e logjikshme, mandej edhe ligji i mundëson të dyshuarit që ai të heshtë gjatë zhvillimit të procedurës policore, por ka të drejtë të flasë dhe të mos e thotë të vërtetën, pra të mashtrojë, kurse organi nuk mund ta detyrojë të dyshuarin që ta flasë të vërtetën.

Testimi me poligraf zhvillohet mbi baza vullnetare, të dyshuarit i thuhet se është mirë t'i nënshtrohet testit nëse ndihet i pafajshëm. Sot thuaj se çdo polic e ka detektorin e gënjeshtres, i cili është i vendosur në një dhomë ku mbretëron një atmosferë e qetë si të thuash një ambient shtëpiak, ku nuk duhet të ketë asnjë lëvizje brenda me këpucë që godasin patosin, zhurma e veturave si dhe pengimi insekteve.

Intervista që zhvillohet nëpërmjet poligrafit nuk mund të zgjasë më shumë se tri orë, kurse për një ditë mund të testohen jo më shumë se dy persona. Poligrafi punon në atë mënyrë që është në gjendje të regjistrojë punën e disa organeve të cilat nuk janë nën kontrollin e sistemit qendror nervor që e kontrollon njeriu.

Ky instrument mat punën e zemrës duke regjistruar ritmin e punës së saj, djersitjen, shtypjen e gjakut dhe frymëmarrjen. Pra, këto katër komponenta janë të pranishme gjatë testimit me

poligrafín. I dyshuari ulet në një karrige e cila është mjaft e rehatshme dhe pastaj në trupin e personit vihen dy kablllo, njëra rreth stomakut dhe tjetra në dërrasën kraharorit.

Në dorën e majtë vihet një kablllo e njëjtë sikur që është ajo e matjes së shtypjes së gjakut, ndërkaq në gishtat e dorës së majtë vendosen matësit, ndërsa te gishti i mesëm i dorës së djathtë vendoset një kapëse. Të dyshuarit i thuhet që të shikojë drejt në mur i cili është i pastër, në të nuk ka foto, piktura dhe asgjë tjetër që mund ta tërheq vëmendjen e personit. Pasi që rregullohet aparatura, fillohet me pyetjet.

KAPITULLI II

KARAKTERISTIKAT E VEPRAVE PENALE KUNDËR NATYRËS DHE AMBIENTIT JETËSOR

1. Vështrime hyrëse për veprat penale kundër mjedisit

Për rëndësinë e madhe që ka ruajtja e mjedisit jetësor është e siguar edhe me kushtetutë dhe sanksionohet me ligj.

Kodi penal i Republikës së Maqedonisë Veriut në nenin 218 ka paraparë si vepër penale ndotjen e ambientit jetësor, në nenin 219 ndotjen e ujit të pijshëm si dhe në nenin 226 prerjen e paligjshme të pyjeve, rrezikimin e mjedisit jetësor dhe natyrës me hedhurina e parasheh në nenin 230, ndërsa transportimin e materialeve të rrezikshme në vend e rregullon me nenin 232 të Kodit penal të RMV-së.

Në vitin 2005 Republika e Maqedonisë së Veriut ka nxjerrë edhe Ligjin për mjedisin jetësor, me anë të të cilit rregullohen të drejtat dhe obligimet e RMV-së, të komunave si dhe të drejtat dhe obligimet e personave fizik dhe juridik në sigurimin e kushteve për mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit jetësor, për të drejtën e shtetasve për mjedis të shëndetshëm jetësor.

2.Trajtimi i disa veprave penale kundër mjedisit jetësor dhe natyrës

Sipas Legjislacionit të Republikës së Maqedonisë Veriut vepra penale kundër mjedisit jetësor llogariten veprat si në vijim:

- Ndotja e ambientit jetësor
- Ndotja e ujit të pijshëm
- Prerja e paligjshme e pyjeve
- Rrezikimi i mjedisit jetësor me hedhurina
- Mbetjet radioaktive
- Transportimi i materieve të rrezikshme në vend
- Uzurpimi i paluajtshmërive
- Eksploatimi joligjor i lëndëve të para minerale
- Gjuetia e paligjshme
- Peshkimi i paligjshëm

35.Kodi Penal i RMV-së, (tekst i përpunuar) Afrim Osmani, 2010

2.2.1 Ndotja e ambientit jetësor

Mjedisi jetësor nënkupton hapësirën, ambientin, të gjitha të mirat natyrore dhe me organizma të gjalla që jetojnë në të, vlera natyrore të trashëguara dhe të krijuara, hapësirën e përgjithshme, në të cilën jeton njeriu dhe në të cilën janë të vendosura vendbanimet, të mirat në shfrytëzim të përgjithshëm, të gjitha objektet industriale dhe të tjera, duke përfshirë edhe lumejntë dhe rajonet tjera të mjedisit jetësor (neni 5 i Ligjit për mjedisin jetësor).

Kjo veprë penale kryhet në kundërshtim me rregulloret për mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësor me çka ndotet ajri, toka, uji në një masë më të madhe ose në një zonë më të gjerë.

Kjo kryhet duke thyer rregullat për mbrojtje, ruajtje dhe avancim të mjedisit jetësor. Paraqet një ndotje që në një masë më të madhe tejkalon përqendrimin e tolerancës ose që, edhe pse brenda kufijve të lejueshëm, mbulon në një zonë më të madhe.

Pasojat e veprës penale janë rreziku për jetën dhe shëndetin e njeriut, për botën shtazore ose bimore, e cila vlerësohet në secilin rast në veçanti. Kryerësi i një vepre penale mund të jetë çdo person, veprimi i të cilit në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë shkakton ndotjen e mjedisit jetësor.

Vepra penale mund të kryhet në mënyra të ndryshme të tilla, si: shkarkimi i ujërave të ndotura, djegia e substancave të rrezikshme që ndotin ajrin, derdhja në ujë rrjedhat ujore ose liqenet ose në tokë, substance kimike toksike ose substanca të tjera që i bëjnë ato të rrezikshme për jetën ose shëndetin e njeriut, d.m.th. për kafshët dhe bimët, duke mos marrë masat e nevojshme mbrojtëse kundër ndotjes ose instalimi i paisjeve të përshtatshme pastrimi etj.

Në punën operative të policies do të ishte e nevojshme që policia të ketë të dhëna për ndotësit e mundshëm të rrezikshëm të mjedisit, dhe të ketë informacion të vazhdueshëm për veprimet e mundshme të ndotjes që përbëjnë inkriminimin. Në lidhje me mbledhjen e informacionit për këtë veprë penale policia është e detyruar që të bashkëpunojë me autoritetet tjera kompetente (shërbimet e inspektimit).

Te kjo veprë penale kërkohet dalja e shpejtë në vendin e ngjarjes, dhe kërkimi të bëhet nga ekspertët të problematikës përkatëse. Duhet të përcaktohet koha, mënyra e kryerjes, mjetet e përdorura, numri i personave, pasojat e shkaktuara, pozita juridike e personave të involvuar (për përcaktim të përgjegjësisë si person zyrtar, përgjegjës etj.). Mjaft me rëndësi është përcaktimi i dëmeve të shkaktuara mjedisit, ambientit, që paraqet pasojën konkrete të veprës penale.

2.2.2. Ndotja e ujit të pijshëm

Mungesa e burimeve të ujit të pijshëm, të pastër po bëhet një nga problemet thelbësore të shekullit XXI. Njerëzimi varet nga uji, sepse ne jo vetëm që e shfrytëzojmë për pije dhe është i nevojshëm për mbijetesën tonë, por ai përdoret edhe për prodhimin e energjisë, prodhimet në industri si dhe në bujqësi.

Në ditët e sotme përkundër faktit se po jetojmë në një “planet të kaltërt”, sasi të ujit të pijshëm po zvogëlohen, prandaj ruajtja e tij është shumë e rëndësishme. Çdo formë e ndotjes ose vjedhjes ose ndonjë aktiviteti të paligjshëm kundër burimeve ujore është një formë e rëndë e krimit.

Ndotja e ujit të pijshëm paraqet çdo veprim të përkohshëm ose të përhershëm, i përcaktuar si veprim devijant nga legjislacioni penal, i cili shkakton çdo formë të dëmtimit (një ndryshim artificial, përkeqësim, degjenerim ose shkatërrim) në ujë për pije (një nga tetë elementet që përbëjnë natyror) ose ndërpresin ndryshimet natyrore në ujë. Konsiderohet se uji është i ndotur, kur përshkak të veprimtarisë njerëzore ndodhin ndryshime të rëndësishme në përbërjen e tij

biologjike fiziko-kimike.

Nuk është e rëndësishme që të vlerësojmë se a ka ndodhur një pasojë ose jo. Mjafton që akti i kryerjes së kësaj vepre penale të konsistojë në ndërrmarjen e një veprimi që rezulton në ndotjen e ujit, e cila ndotje do ta bëjë të papërdorshëm për njeriun.

Nuk është e nevojshme që ndotja të shkaktohet në mënyrë direkte. Kjo mund të jetë për shembull shkarkimi i ujërave të zeza të dëmshme, derdhja e tyre në ujë, në rrjedhat ujore ose burim ose në tokë (derdhja e sasisë së madhe të benzinës që arrin deri tek uji), substanca kimike ose toksike ose substanca të tjera që bëjnë ato të rrezikshme për jetën ose shëndetin e njeriut.

36.N.ETEMI KRIMINALISTIKA EKOLOGJIKE FQ 57-58

37.N.ETEMI KRIMINALISTIKA EKOLOGJIKE FQ. 61

Objekt i veprimit është uji për pije, pasoja është një rrezik abstrakt dhe nuk kërkohet ndonjë rrezik konkret për jetën ose shëndetin e njeriut. Vepra penale mund të kryhet me qëllim ose nga pakujdesia.

Kryerës mund të jetë çdokush, si personat fizik ashtu edhe personat juridik (korporatat, ndërmarrjet, grupet, individët etj.). Parashihet përgjegjësi edhe për personat juridik, të cilët nuk do të marrin masat e nevojshme për mbrojtjen kundër ujit për pije.

Si viktimë te kjo vepër penale na paraqiten vetëm njerëzit. Pasojat e ujit të pijshëm janë zakonisht shkatërruese për njerëzit. Në këtë vepër penale nuk përfshihen ndotjet e ujit që përdoren për qëllime të tjera, p.sh. për vaditje, për ujitje për kafshë ose për qëllime të përdorimit tjetër.

Dalja në vendin e ngjarjes duhet të bëhet sa më parë të jetë e mundur, dhe menjëherë të merren mostrat e ujit për pije (të kryhet ekspertizë situacionale) duke respektuar të gjitha procedurat e parapara për marrjen e mostrave të ujit. Në zbardhjen e kësaj vepre penale duhet të ketë bashkëpunim me organet tjera e veçanërisht Inspektoratin sanitar-shëndetësor dhe Inspektoratin shtetëror për ushqim dhe veterinar.

Mbrojtja e ujërave në përgjithësi, burimeve të ujit dhe ujit të pijshëm në veçanti në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga ndotja është objekt i një kuadri ligjor më të gjerë për

ujërat në përgjithësi, i cili përfshin edhe ligjin bazë “Ligjin për ujërat”.

Sipas të dhënave nga ISHP, qasja në ujë të pijshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut është 90%, dhe kategorizon shtetin në grupin e vendeve të botës me qasje të dukshme, gjë kjo që nuk e zvogëlon angazhimin e vendit për përmirësimin e mëtutjeshëm të qasjes në ujë të pijshëm deri në 97% deri në fund të vitit 2020.

2.2.3. Prerja e paligjshme e pyjeve

Prerja e paligjshme e pyjeve nënkupton prerjen, përpunimin, transportimin, blerjen ose shitjen e drunjëve në kundërshtim me ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare. Ajo ka një ndikim shkatërrues në disa nga pyjet e mbetura dhe shumë të vlefshme në botë, si dhe mbi njerëzit që jetojnë në to dhe mbështeten në burimet që sigurojnë pyjet.

Prerjet e paligjshme të pyjeve minojnë legjitimitetin e sektorit të pyjeve dhe pengojnë përpjekjet e qeverive për të zbatuar një menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve.

Kodi Penal i RM-së veprat penale të prerjes së paligjshme të pyjeve i përfshin në pjesën e veprave më të rrezikshme dhe shumë të rëndësishme për mbrojtjen e mjedisit, këto vepra kanë rritje të madhe në numër vitet e fundit.

Vepra penale e prerjes së pyjeve ka objekt të mbrojtjes sigurimin, mbrojtjen e pyjeve në aspektin social dhe atë ekonomik.

Subjekt i veprave penale të prerjes së paligjshme të pyjeve mund të jetë çdo person i moshës madhore me përgjegjësi penale dhe që është i përgjegjshëm, i cili ndërmerr veprim dhe pret pyjet apo dëmton ato pa leje.

Te ky krim është i lartë numri i errët, kemi rritje të kësaj vepre lidhshmëri me vepra penale të kriminalitetit të jakave të bardha. Karakteristikë është se te kjo vepër penale krijohet përshtypja se nuk kemi viktime, por në fakt të gjithë jemi viktimë.

Në Republikën e Maqedonisë prerja e paligjshme e pyjeve është një problem në rritje të dukshme.

2.2.4. Rrezikimi i mjedisit jetësor dhe natyrës me hedhurina

Që në filllet e para të njerëzimit ekzistojnë mbeturinat. Në fillim këto llogariteshin si substanca me origjinë natyrore (lëkurë, kockë, dru) që dekompozohen dhe zbërthehen në natyrë dhe nuk kishte asnjë problem me mbeturinat e ngurta.

Në jetën e përditshmem njerëzit bëjnë dhe shfrytëzojnë objekte të ndryshme, përdorin produkte ushqimore dhe në këtë formë mbeturinat krijohen në mënyrë të pashmangshme. Shumica e mbeturinave që njeriu krijon në mjedisin ku jeton kanë origjinë biologjike që nënkupton se ato përmbajnë lëndë organike. Sasia dhe lloji i mbeturinave të krijuara rritet si rezultat i standardit më të lartë të jetesës dhe industrisë që ka marrë hov të madh.

Hudhja e mbeturinave në vende, në të cilat banojnë dhe jetojnë njerëzit, veçanërisht pranë burimeve të ujit të pijshëm, mund të shkaktojë paraqitjen e ndonjë sëmundjeje dhe në rastin me të keq paraqitjen e ndonjë epidemie. Me këto veprime rrezikohen burimet e pastërta të ujit të pijshëm apo rrezikimi i ushqimeve dhe prodhimtarive ushqimore. Grumbullimi i mbeturinave, mbetjeve nga hedhurinat është faktor kryesor kontribues për problemet kryesore që përballemi tani, prej kësaj edhe vetëdija për përfitimet prej uljeve

apo të rishfrytëzimit dhe reklimit të mbetjeve. Kjo na rikujton disa paralajmërime që janë bërë për këtë pjesë në Kuranin famëlartë: “mos e teproni shumë, pse Ai (All-llahu) nuk i do shkapërderdhësit” (Kurani 6: 141, përkthim Sherif Ahmeti).

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut ekzistojnë disa deponi komunale, të cilat në numër janë 54 depo, mirëpo 80% e këtyre deponive nuk plotësojnë standardet e nevojshme ekologjike dhe shpesh përbëjnë më shumë dëm në shëndetin e qytetarëve dhe dëmtojnë mjedisin. Deponia e vetme në vend që plotëson standardet është deponia “Drislla”, mirëpo kjo deponi nuk është zgjidhje për të gjithë qytetet e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ajo mbulon vetëm pjesën e qytetit të Shkupit.

2.2.5. Mbetjet radioaktive

Mbetjet radioaktive përcaktohen si materiale që përmbajnë ose janë të kontaminuara me radionuklide në përqëndrime ose aktivitete më të mëdha se nivelet e pastrimit, siç përcaktohen nga autoritetet rregullatore të vendit dhe për të cilat nuk është paraparë përdorimi.

2.2.6. Transportimi i materieve të rrezikshme në vend

Bëhet fjalë për veprë penale blanko, e nevojshme është që veprimi i kryerësit të jetë në kundërshtim me anë të rregullave tjera. Rreziku shoqëror dhe aktualiteti i këtij krimi është mjaft i madh në ditët e sotme, sepse shumë shpesh substanca të ndryshme, të cilat kanë një përmbajtje të dyshimtë, si materie të rrezikshme ose organizma të dëmshëm ose materiale mbjellëse, prodhohen, menaxhohen ose qarkullohen. Vepra penale kryhet në mënyra specifike dhe nënkupton kryerjen e një krimi me pasoja të rrezikshme. Forma e parë e kësaj vepre penale kryhet në mënyra të ndryshme në kundërshtim me rregullat dhe prodhon, përpunon, menaxhon, shfrytëzon, posedon, ruan, paketon, ripaketon, përdor, transporton, importon, eksporton materie të rrezikshme ose organizma të dëmshëm ose materiale mbjellëse. Me anë të kësaj vepre bëhet

thyerja e rregullave të parapara për këto materiale.

Njohuritë për ekzistimin e kësaj vepre penale janë të shumta nga manifestimet e jashtme në terren, zbulimin e formave të ndryshme të prodhimit, përpunimit, menaxhimit, shfrytëzimit, posedimit, ruajtjes, paketimit, ripaketimit, përdorimit, transportimit, importimit, eksportimit, deri në pasoja konkrete, të cilat i paraqesin qytetarët, persona të dëmtuar, organet e inspektoratit, mjetet e informimit publik etj.

Forma më e rëndë e kësaj vepre penale kryhet nëse personi zyrtar ose personi përgjegjës te personi juridik do të mundësojë kryerjen e kësaj vepre. Vepra mund të kryhet me veprim dhe mosveprim. Mundësia e kryerjes së veprimit duhet të jetë në kundërshtim me rregullat, por mund të kryhet edhe me moskryerjen e veprimeve nga personi zyrtar, i cili nuk i ka ndërmarrë veprimet e parapara me ligj ose aktet nënligjore, p.sh. të mundësojë importin, eksportin, paketimin etj. Kryerësi i kësaj vepre është personi zyrtar.

2.2.7. Uzurpimi i paluajtshmërive

Me anë të kësaj vepre penale sanksionohet personi që përvetëson patundshmëri të huaj, e cila është pronë për përdorim të përgjithshëm, e mirë nën mbrojtjen e përkoshme ose trashëgëmi kulturore, diçka që është natyrore, e rrallë ose pasuri tjetër natyrore ose tokë bujqësore.

Forma më e rëndë e kësaj vepre paraqitet, nëse toka e uzurpuar do të përdoret për ndërtimin e ndonjë objekti për qëllime të pacaktuara, i cili ndërtim ose shfrytëzim do të ndryshojë karakteristikat e tokës deri në atë shkallë sa që nuk mund të kthehet në gjendjen e mëparshme. Vepra penale nuk përcakton qëllimin e uzurpimit të kryerësit. Mjafton që patundshmëria të uzurpohet dhe të jetë në posedimin e tij.

Me këtë veper penale, si dhe te veprat tjera penale nga ky kapitull, objekti i të cilit është mbrojtja e mjedisit jetësor, parandalohet uzurpimi i tokës së huaj dhe ndërtimi illegal. Rastet e uzurpimit të paligjshëm të pronave nuk janë komplekse nga aspekti juridik, meqë ato përgjithësisht përfshijnë një të pandehur, sasia e dëshmive është jo mbi mesataren, shkalla e kompleksitetit të çështjeve juridike të përfshira është e ulët, si dhe nuk ka kontekste të pazgjdhura pronësore.

Organet e policisë gjatë zbardhjes së kësaj vepre penale kërkojnë ndimë nga Agjencia për Kadastër të patundshmërisë dhe Inspektorati Shtetëror për Ndërtim dhe Planifikim Urban.

2.2.8. Eksploatimi joligjor i lëndëve të para minerale

Me këtë vepër penale sanksionohet eksploatimi i rërës, zhavorrit ose çfarëdo lëndë tjetër që bëhet pa koncesion ose leje. Me eksploatim të lëndëve të para minerale nënkuptojmë aktivitetin e marrjes, gjegjësisht liritimit të lëndëve të para minerale nga gjendja e tyre natyrore, duke përfshirë edhe aktivitetet përgatitore shoqëruese dhe pasuese, të lidhura me marrjen e lëndëve të para minerale. Lëndë të para minerale janë të gjitha materiet minerale, organike dhe joorganike që gjenden në gjendje të ngurtë, të lëngët apo të gaztë. Vlera e lëndëve të para të eksploatuara duhet të jetë e vlerës më të madhe që nënkupton vlerën ose dëm që i përgjigjet shumës së 5 rrogave mestare në Republikë në kohën e kryerjes së veprës. Nëse vlera e lëndëve të para është më e vogël se kjo vlerë, atëherë kemi kundërvajtje e jo vepër penale.

Koncesioni nënkupton leje që autoritetet publike ia japin personave juridik (nga shteti i huaj) me qëllim të kryerjes së ndonjë veprimtarie me kushte të parapara dhe njohura paraprakisht. Qëllimi kryesor i koncesionit është shfrytëzimi i ndonjë të mire (pasuritë natyrore, tokësore ose nëntokësore të një vendi) për arritjen e rezultateve pozitive financiare, por duke u përmbajtur rregullave rigoroze në marrëveshje.

Me eksploatim të lëndëve të para minerale dhe kryerje të punëve minerale mund të fillohet pasi koncesioneri të marrë leje për eksploatim të lëndëve të para minerale. Me leje nënkuptojmë miratimin ose drejtë që i jepet dikujt për të bërë diçka, për të kryer një punë a veprimtari të caktuar, për të përdorur a për të marrë diçka etj., shkresa që miraton këtë miratim a të drejtë. Forma më e rëndë e kësaj vepre penale parqitet atëherë kur kryerësi i veprës arrin në përfitim ose shkaktohet dëm i përmasave të mëdha. Me interes, vlerë ose dëm të përmasave të mëdha nënkuptojmë vlerë ose dëm që i përgjigjet shumës së 250 rrogave mestare në Republikë në kohën e kryerjes së veprës. Parashihet përgjegjësi penale, nëse kjo vepër do të kryhet nga personi juridik.

Te kjo vepër penale është paraparë që të merren sendet që janë krijuar ose përdorur për kryerjen e veprës penale. Kjo nënkupton marrjen e lëndëve të para minerale si dhe të gjitha mjetet e shfrytëzuara për nxerrjen dhe marrjen e këtyre lëndëve.

2.2.9. Gjuetia e paligjshme

Me anë të kësaj vepre penale kryesisht mbrohen egërsirat. Paraqet një ndër veprat penale që ka më së shumti ndikim në botën shtazore. Me vepër penale të gjuetisë së paligjshme nënkuptojmë, çdo person, i cili do të dalë në gjah dhe do të gjuajë ndonjë kafshë/shpezë të egër gjatë periudhës kohore kur gjuetia është e ndaluar.

Bartja e armës për gjueti gjatë kohës dhe në vendin e ndaluar për gjueti nuk paraqet veprim-kryerje të kësaj vepre, por vepra do të ekzistojë, nëse kërkohet egërsi për gjueti. Me rëndësi është që gjuetia të kryhet gjatë kohës që ligji e parasheh se nuk mund të kryhet gjuetia.

Formën e tjetër të kësaj vepre penale e kryen ai i cili gjuan në vende të ndaluara për gjueti, lëndon ose kap për së gjalli. Forma më e rëndë në raste kur kryerësi pa leje gjuan egërsira të mëdha. Për kryerjen e kësaj forme me rëndësi është që kryerësi të mos disponojë leje për gjueti. Forma e kualifikuar e kësaj vepre penale ekziston kur personi gjuan egërsira të rralla, ku gjuetia është e ndaluar ose gjuan pa leje të veçantë, për të cilën gjueti duhet leje e tillë ose gjuan në mënyrë ose mjete ku kafshët në masë të madhe zhduken.

Me gjuajtjen e egërsirave nënkuptohen kërkimi, pritja, vëzhgimi, përcjellja, gjuajtja, dhe kapja e egërsirave të gjalla si dhe grumbullimi i vezëve të egërsirave me pandla, egërsirave të

ngordhura dhe pjesëve të tyre, brirëve të rënë, lëkurave gëzofëve të rënë. Me egërsira sipas Ligjit nënkuptohen llojet e kafshëve dhe shpezëve: gjitarë (të mëdhenj dhe të imët) dhe shpezë (të mëdha dhe të imëta). Egërsirat mund të jenë të mbrojtura (dreri, ariu, lepuri, ketri, pula e pyejeve, fazani dhe patat e egër etj.) dhe të pambrojtura (ujku, miu i bizamit, dhelpëra, qelbësi, çafka, laraska etj.) Për egërsirat e mbrojtura përcaktohet koha e mosgjuaftjes, ndalimi i përkohshëm ose i përhershëm i gjuetisë. Gjatë kohës së mosgjuaftjes, ndalimit të përkohshëm ose të përhershëm të gjuetisë, egërsirat e mbrojtura nuk guxon të gjuhen, ndiqen ose shqetësohen, nëse me këtë ligji për gjueti nuk është përcaktuar ndryshe. Kjo vepër penale është e lidhur ngushtë me veprën penale vrasje dhe shkatërrim i florës dhe faunës, si dhe vepra penale keqtrajtim i kafshëve.

Për parandalimin e këtij krimi, një rëndësi të veçantë ka rritja e numrit të personave të angazhuar në mbikëqyrjen, rritjen e arsimimit të gjuetarëve dhe shoqatave të gjuetisë, por edhe të gjithë personave të tjerë mbi pasojat e dëmshme të gjuetisë së paligjshme të gjahut dhe njerëzve, forcimin e rolit të psikologëve dhe mjekëve kur japin çertifikata mjekësore të nevojshme për të marrë një licencë për të poseduar armë gjahu, dhe për të siguruar më shumë hapësirën mediatike për këtë formë të krimit.

Gjatë zbardhjes së kësaj vepre penale insistohet që të gjenden gjurmët siç janë p.sh. qime, gjak, gjurmë baroti te personat e dyshuar për këtë vepër penale.

2.2.10. Peshkimi i paligjshëm

Objekt i mbrotjes është mjedisi, para së gjithash rezervat e peshkut si pjesë e mjedisit dhe pastaj peshkimi si një aktivitet i rëndësishëm ekonomik. Ashtu si krimet tjera kudër mjedisit, peshkimi i paligjshëm është e një natyre blanko, pra për të shpjeguar terma të caktuara nga natyra e tij, është e nevojshme të njihen rregulloret në fushën e peshkimit.

Forma e parë e veprës penale të peshkimit të paligjshëm konsiston në kapjen e peshkut ose shtazëve tjera ujore në një mënyrë të paligjshme ose duke përdorur mjete të paligjshme-eksplozivë, energji elektrike, helm, me mjete për shastisje ose në ndonjë mënyrë tjetër që është e dëmshme për riporodhimin e peshqve. Sipas ligjit për peshkatari dhe akuakulturë është e ndaluar zënia e peshqve gjatë kohës së pllenimit të peshqve ose gjatë kohës së mbyllur të gjuetisë, në ujërat e peshkimit të cilët janë përkohësisht ose përhershëm të ndaluara për peshkim, me lloje të

ndryshme të rrjeteve, me armë zjarri, me eksplozivë ose me mjete kimike me të cilat lëndohen, vriten, helmohen ose hutohen peshqit, peshkimi elektrik, me osti, me pushkë nënujore, drejtpërdrejt me duar, me çengelë, me kallam rrjeti etj

Kryesi i veprës penale të peshkimit të paligjshëm mund të jetë çdo person. Por gjithashtu kryerësi mund të jetë edhe personi juridik. Peshkimi i paligjshëm mund të kryhet vetëm me dashje si formë e fajit. Qëllimi i kryerësit duhet të përfshijë vetëdijen për mjetet dhe mënyrën e kapjes së peshkut.

44.N.ETEMI KRIMINALISTIKA EKOLOGJIKE FQ. 86

45. PO ATY FQ 93

Kapitulli III

ANALIZË DHE TË DHËNA STATISTIKORE PËR VEPRAT PENALE KUNDËR NATYRËS DHE AMBIENTIT JETËSOR

1. Ecuria dhe vëllimi i veprave penale kundër mjedisit

Krimi mjedisor si një fenomen shumë aktual në shoqëri, individual si dhe shkaqet e tij gjithmonë kanë qenë objekt interesimi që në periudhat më të hershme të zhvillimit të shoqërisë dhe gjithmonë kanë shkaktuar frikë dhe pasiguri te qytetarët.

Me krimin mjedisor shpesh herë viktimizimi është serioz, jo vetëm se çdo viktimitë individualisht është prekur seriozisht, por sepse viktima të shumta preken nga krimi. Viktimat individuale mund të humbasin shumë pak, mirëpo efekti akumulues për komunitetin dhe mjedisin jetësor mund të jetë i konsiderueshëm.

Studime të shumta raportojnë një ulje të krimeve mjedisore pas shqiptimit të gjobave ose gjobave potenciale, për shkak të efekteve parandaluese të përgjithshme dhe specifike. Këtu ne

hulumtojmë, nëse ato efekte parandaluese duken të besueshme duke vlerësuar mundësinë e një çështjeje penale që ndodh çdo vit ndërmjet 1983 deri në vitin 2020.

Analizat tona tregojnë se ekziston një probabilitet jashtëzakonisht i ulët që një rast i krimit mjedisor të ndiqet penalisht, duke hedhur dyshimin se këto raste penale janë mjaft të përhapura për të gjeneruar një efekt parandalues.

3.2. Kryerësit e veprave penale kundër mjedisit jetësor

Kryerës të veprave penale kundër mjedisit jetësor shpesh paraqiten persona juridik dhe persona fizik, të cilët kryejnë veprën penale me dashje, po në disa raste edhe nga pakujdesia. Duke iu referuar të dhënave statistikore prej Entit Shtetëror të Statistikave të Republikës së Maqedonisë, në vijim do të ju paraqesim të dhënat për veprat penale kundër mjedisit jetësor të realizuara në periudhën kohore 2015-2020.

Do të ju paraqesim personat, kryerësit e këtyre veprave, llojit të vendimit të shqiptuar, gjininë e kryerësve, moshën e tyre, shkollimin, profesionin dhe përkatësinë etnike.

Do të ju paraqesim të dhënat për kallëzimet penale të ngritura për këto persona, persona të akuzuar, sa prej tyre janë dënuar si dhe llojin dhe kohëzgjatjen e dënimeve të shqiptuara.

Në tabelën në vijim do të shihni të dhënat për persona të rritur të paraqitur, sipas llojit të veprës penale.

2015

| Veprat Penale kundër mjedisit dhe natyrës | Gjithsej | Kryerës të njohur | | | | | | Gjithsej kryerës të panjohur |
|--|------------|----------------------------|----------|--------------------------|----------------------|----------------------|----------------------|------------------------------|
| | | Gjithsej kryerësitë njohur | Femra | Lloji i vendimit | | | | |
| | | | | Ankesa të hedhura poshtë | Hetime të pezulluara | Hetime të pezulluara | Aktakuza të ngritura | |
| Gjithsej | 164 | 132 | 8 | 64 | - | 2 | 66 | 32 |
| Ndotja e mjedisit dhe e natyrës | 7 | 7 | 2 | 5 | - | - | 2 | - |
| Shfrytëzimi i paligjshëm i burimeve minerale | 4 | 4 | - | 2 | - | 1 | 1 | - |
| Uzurpimi i pasurive të paluajtshme | 48 | 48 | 6 | 22 | - | 1 | 25 | - |
| Shkatërrimi i pyjeve | 33 | 21 | - | 15 | - | - | 6 | 12 |

| | | | | | | | | |
|---|----|----|---|----|---|---|----|---|
| Gjuetia, mbajtja dhe tjetërsimi i paautorizuar i kafshëve dhe shpendëve të egër | 3 | 3 | - | - | - | - | 3 | - |
| Gjuetia e paligjshme | 32 | 29 | - | 12 | - | - | 17 | 3 |
| Peshkimi i paligjshëm | 17 | 10 | - | 4 | - | - | 6 | 7 |
| Mundimi i kafshëve | 16 | 9 | - | 4 | - | - | 5 | 7 |
| Të tjera | 4 | 1 | - | - | - | - | 1 | 3 |

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave i RMV-së

Të dhënat e paraqitura në tabelën më lartë tregojnë se gjithsej kemi të paraqitura 164 raste, ku 8 raste janë femra, për 132 kryerësit e veprave janë të njohur, 64 ankesa janë hedhur poshtë, 3 hetime janë ndërprerë dhe janë ngritur 66 aktakuza, 32 persona shfaqen si kryerës të panjohur të këtyre veprave penale.

2016

| Veprat Penale kundër mjedisit dhe natyrës | Gjithsej | Kryerës të njohur | | | | | | Gjithsej kryerës të panjohur |
|--|----------|------------------------------|-------|--------------------------|----------------------|----------------------|----------------------|------------------------------|
| | | Gjithsej kryerës i te njohur | Femra | Lloji i vendimit | | | | |
| | | | | Ankesa të hedhura poshtë | Hetime të pezulluara | Hetime të pezulluara | Aktakuza të ngritura | |
| Gjithsej | 236 | 157 | 13 | 67 | - | 2 | 88 | 79 |
| Ndotja e mjedisit dhe e natyrës | 3 | 2 | - | 1 | - | - | 1 | 1 |
| Shfrytëzimi i paligjshëm i burimeve minerale | 3 | 3 | - | 1 | - | - | 2 | - |

| | | | | | | | | |
|---|----|----|----|----|---|---|----|----|
| Uzarpimi i pasurive të paluajtshme | 80 | 80 | 11 | 33 | - | - | 47 | - |
| Shkatërrimi i pyjeve | 69 | 18 | - | 6 | - | 1 | 11 | 51 |
| Gjuetia, mbajtja dhe tjetërsimi i paautorizuar i kafshëve dhe shpendëve të egër | 4 | 4 | 1 | - | - | - | 4 | - |
| Gjuetia e paligjshme | 10 | 8 | - | 8 | - | - | - | 2 |
| Peshkimi i paligjshëm | 32 | 21 | 1 | 8 | - | - | 13 | 11 |
| Mundimi i kafshëve | 14 | 10 | - | 4 | - | 1 | 5 | 4 |
| Të tjera | 21 | 11 | - | 6 | - | - | 5 | 10 |

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave i RMV-së

Të dhënat e paraqitura në tabelën më lart tregojnë se gjithsej kemi të paraqitura 236 raste, ku 13 raste janë femra, për 157 kryerësit e veprave janë të njohur, 67 ankesa janë hedhur poshtë, 2 hetime janë ndërprerë dhe janë ngritur 88 aktakuza, 79 persona shfaqen si kryerës të panjohur të këtyre veprave penale

2017

| | Gjithsej | Kryerës të njohur | | | Gjithsej kryerës të panjohur |
|--|----------|------------------------------|-------|------------------|------------------------------|
| | | Gjithsej kryerës i te njohur | Femra | Lloji i vendimit | |
| | | | | | |

| Veprat Penale kundër mjedisit dhe natyrës | | | | Ankesa të hedhura poshtë | Hetime të pezulluara | Hetime të pezulluara | Aktakuzat të ngritura | |
|---|------------|------------|----------|--------------------------|----------------------|----------------------|-----------------------|-----------|
| Gjithsej | 151 | 128 | 3 | 46 | - | 11 | 71 | 23 |
| Uzurpimi i pasurive të paluajtshme | 72 | 72 | 3 | 31 | - | 8 | 33 | - |
| Shkatërrimi i pyjeve | 7 | 4 | - | 2 | - | - | 2 | 3 |
| Gjuetia e paligjshme | 13 | 9 | - | 1 | - | 2 | 6 | 4 |
| Peshkimi i paligjshëm | 28 | 18 | - | 2 | - | - | 16 | 10 |
| Mundimi i kafshëve | 25 | 21 | - | 8 | - | 1 | 12 | 4 |
| Të tjera | 6 | 4 | - | 2 | - | - | 2 | 2 |

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave i RMV-së

Të dhënat e paraqitura në tabelën më lart tregojnë se gjithsej kemi të paraqitura 151 raste, ku 3 raste janë femra, për 128 kryerësit e veprave janë të njohur, 46 ankesa janë hedhur poshtë, 11 hetime janë ndërprerë dhe janë ngritur 71 aktakuza, 23 persona shfaqen si kryerës të panjohur të këtyre veprave penale.

2015

| Investimet dhe kostot sipas qëllimit | Investimet e përgjithshme dhe shpenzimet | | |
|---|--|---|-------------|
| | | Investimet për mbrojtjen e mjedisit jetësor | Në % |
| Gjithsej | 4 454 830 | 1 689 899 | 37.9 |
| prej tyre për: | | | |
| Menaxhim me ujërat e zeza | 380 353 | 316 030 | 83.1 |
| Sistemi qarkullues për furnizim me ujë | 531 872 | 256 462 | 48.2 |
| Mbrojtja e ajrit | 613 131 | 553 553 | 90.3 |
| Mbrojtjen e tokës, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore | 48 228 | 17 673 | 36.6 |
| Mbrojtjen e pyjeve | 12 197 | 47 | 0.4 |
| Mbrojtja e biodiversitetit dhe natyrës | 283 490 | 219 263 | 77.3 |
| Gjuetia dhe peshkimi | - | - | - |
| Menaxhimi me mbeturina | 2 351 900 | 234 038 | 10.0 |
| Mbrojtja nga zhurma | 75 581 | 28 786 | 38.1 |
| Aktivitete për hulumtim dhe zhvillim | 58 424 | 53 810 | 92.1 |
| Aktivitete arsimore, edukative dhe të ngjashme | 3 458 | - | - |
| Aktivitete administrative | 54 221 | - | - |
| Pajisje për mbikëqyrje dhe kontroll, analizë dhe shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjes | 34 578 | 10 236 | 29.6 |
| Vlerësimi i ndikimit të mjedisit jetësor dhe vlerësimi i konsistencës | 7 399 | - | - |

2016

| Investimet dhe kostot sipas qëllimit | Investimet e përgjithshme dhe shpenzimet | Investimet për mbrojtjen e mjedisit jetësor | Në % | Shpenzimet për mirëmbajtjen e mjeteve për mjedisin jetësor | Në % |
|---|--|---|-------------|--|-------------|
| Gjithsej | 9 778 945 | 5 353 086 | 54.7 | 4 425 859 | 45.3 |
| prej tyre për: | | | | | |
| Menaxhim me ujërat e zeza | 3 308 513 | 3 122 629 | 94.4 | 185 885 | 5.6 |
| Sistemi qarkullues për furnizim me ujë | 846 682 | 324 305 | 38.3 | 522 377 | 61.7 |
| Mbrojtja e ajrit | 605 216 | 530 404 | 87.6 | 74 812 | 12.4 |
| Mbrojtjen e tokës, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore | 152 411 | 77 659 | 51.0 | 74 753 | 49.0 |
| Mbrojtjen e pyjeve | 4 222 | 124 | 2.9 | 4 098 | 97.1 |
| Mbrojtja e biodiversitetit dhe natyrës | 291 145 | 206 803 | 71.0 | 84 342 | 29.0 |
| Gjuetia dhe peshkimi | - | - | - | - | - |
| Menaxhimi me mbeturina | 4 059 653 | 873 593 | 21.5 | 3 186 059 | 78.5 |
| Mbrojtja nga zhurma | 15 008 | 9 480 | 63.2 | 5 529 | 36.8 |
| Aktivite për hulumtim dhe zhvillim | 212 107 | 196 398 | 92.6 | 15 708 | 7.4 |
| Aktivite arsimore, edukative dhe të ngjashme | 5 401 | - | - | 5 401 | 100.0 |
| Aktivite administrative | 54 282 | - | - | 54 282 | 100.0 |
| Pajisje për mbikëqyrje dhe kontroll, analizë dhe shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjes | 113 382 | 11 691 | 10.3 | 101 691 | 89.7 |
| Vlerësimi i ndikimit të mjedisit jetësor dhe vlerësimi i konsistencës | 110 923 | - | - | 110 923 | 100.0 |

2017

| Investimet dhe kostot sipas qëllimit | Investimet e përgjithshme dhe shpenzimet | Investimet për mbrojtjen e mjedisit jetësor | Në % | Shpenzimet për mirëmbajtjen e mjeteve për mjedisin jetësor | Në % |
|---|---|--|-------------|---|-------------|
| Gjithsej | 10 038 200 | 6 979 128 | 69.5 | 3 059 073 | 30.5 |
| prej tyre për: | | | | | |
| Menaxhim me ujërat e zeza | 777 719 | 618 735 | 79.6 | 158 984 | 20.4 |
| Sistemi qarkullues për furnizim me ujë | 788 431 | 202 253 | 25.7 | 586 178 | 74.3 |
| Mbrojtja e ajrit | 200 995 | 112 777 | 56.1 | 88 217 | 43.9 |
| Mbrojtjen e tokës, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore | 29 318 | 11 232 | 38.3 | 18 086 | 61.7 |
| Mbrojtjen e pyjeve | 2 264 | 681 | 30.1 | 1 583 | 69.9 |
| Mbrojtja e biodiversitetit dhe natyrës | 215 843 | 118 180 | 54.8 | 97 663 | 45.2 |
| Gjuetia dhe peshkimi | 456 | 416 | 91.2 | 40 | 8.8 |
| Menaxhimi me mbeturina | 7 784 139 | 5 745 362 | 73.8 | 2 038 778 | 26.2 |
| Mbrojtja nga zhurma | 15 780 | 14 745 | 93.4 | 1 034 | 6.6 |
| Aktivite për hulumtim dhe zhvillim | 148 079 | 145 755 | 98.4 | 2 323 | 1.6 |
| Aktivite arsimore, edukative dhe të ngjajshme | 3 058 | - | - | 3 058 | 100.0 |
| Aktivite administrative | 33 567 | - | - | 33 567 | 100.0 |
| Pajisje për mbikëqyrje dhe kontroll, analizë dhe shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjes | 32 557 | 8 991 | 27.6 | 23 566 | 72.4 |
| Vlerësimi i ndikimit të mjedisit jetësor dhe vlerësimi i konsistencës | 5 995 | - | - | 5 995 | 100.0 |

2018

| Investimet dhe kostot sipas qëllimit | Investimet e përgjithshme dhe shpenzimet | Investimet për mbrojtjen e mjedisit jetësor | Në % | Shpenzimet për mirëmbajtjen e mjeteve për mjedisin jetësor | Në % |
|--|--|---|-------------|--|-------------|
| Gjithsej | 11 232 421 | 8 394 466 | 74.7 | 2 837 955 | 25.3 |
| prej tyre për: | | | | | |
| Menaxhim me ujërat e zeza | 1 055 862 | 826 189 | 78.2 | 229 672 | 21.8 |
| Sistemi qarkullues për furnizim me ujë | 693 604 | 246 110 | 35.5 | 447 494 | 64.5 |
| Mbrojtja e ajrit | 240 191 | 123 430 | 51.4 | 116 760 | 48.6 |
| Mbrojtjen e tokës, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore | 537 292 | 508 356 | 94.6 | 28 937 | 5.4 |
| Mbrojtjen e pyjeve | 10 833 | - | 0.0 | 10 833 | 100.0 |
| Mbrojtja e biodiversitetit dhe natyrës | 151 194 | 134 222 | 88.8 | 16 972 | 11.2 |
| Gjuetia dhe peshkimi | - | - | - | - | - |
| Menaxhimi me mbeturina | 7 212 539 | 6 439 948 | 89.3 | 772 590 | 10.7 |
| Mbrojtja nga zhurma | 13 796 | 12 484 | 90.5 | 1 312 | 9.5 |
| Aktivite për hulumtim dhe zhvillim | 58 924 | 24 846 | 42.2 | 34 077 | 57.8 |
| Aktivite arsimore, edukative dhe të ngjashme | 1 094 398 | - | - | 1 094 398 | 100.0 |
| Aktivite administrative | 34 995 | - | - | 34 995 | 100.0 |
| Pajisje për mbikëqyrje dhe kontroll, analizë dhe shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjes | 120 710 | 78 879 | 65.3 | 41 831 | 34.7 |
| Vlerësimi i ndikimit të mjedisit jetësor dhe vlerësimi i konsistencës | 8 083 | - | - | 8 083 | 100.0 |

2019

| Investimet dhe kostot sipas qëllimit | Investimet e përgjithshme dhe shpenzimet | Investimet për mbrojtjen e mjedisit jetësor | Në % | Shpenzimet për mirëmbajtjen e mjeteve për mjedisin jetësor | Në % |
|---|--|---|-------------|--|-------------|
| Gjithsej | 7 579 784 | 4 401 807 | 58.1 | 3 177 978 | 41.9 |
| prej tyre për: | | | | | |
| Menaxhim me ujërat e zeza | 2 386 379 | 2 132 227 | 89.3 | 254 152 | 10.7 |
| Sistemi qarkullues për furnizim me ujë | 1 743 625 | 1 189 311 | 68.2 | 554 314 | 31.8 |
| Mbrojtja e ajrit | 197 183 | 141 843 | 71.9 | 55 340 | 28.1 |
| Mbrojtjen e tokës, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore | 70 248 | 37 315 | 53.1 | 32 933 | 46.9 |
| Mbrojtjen e pyjeve | - | - | 0.0 | - | #VALUE! |
| Mbrojtja e biodiversitetit dhe natyrës | 153 822 | 56 007 | 36.4 | 97 815 | 63.6 |
| Gjuetia dhe peshkimi | - | - | - | - | - |
| Menaxhimi me mbeturina | 1 899 310 | 665 301 | 35.0 | 1 234 009 | 65.0 |
| Mbrojtja nga zhurma | 4 713 | 4 167 | 88.4 | 547 | 11.6 |
| Aktivitete për hulumtim dhe zhvillim | 19 625 | 15 859 | 80.8 | 3 765 | 19.2 |
| Aktivitete arsimore, edukative dhe të ngjashme | 10 305 | - | - | 10 305 | 100.0 |
| Aktivitete administrative | 905 305 | - | - | 905 305 | 100.0 |
| Pajisje për mbikqyrje dhe kontroll, analizë dhe shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjes | 183 055 | 159 776 | 87.3 | 23 279 | 12.7 |
| Vlerësimi i ndikimit të mjedisit jetësor dhe vlerësimi i konsistencës | 6 213 | - | - | 6 213 | 100.0 |

2020

| Investimet dhe kostot sipas qëllimit | Investimet e përgjithshme dhe shpenzimet | Investimet për mbrojtjen e mjedisit jetësor | Në % | Shpenzimet për mirëmbajtjen e mjeteve për mjedisin jetësor | Në % |
|--|--|---|--------------|--|--------------|
| Gjithsej | 5 975 305 | 3 911 333 | 65.46 | 2 063 972 | 34.54 |
| Prej tyre për: | | | | | |
| Menaxhim me ujërat e zeza | 2 335 281 | 1 920 367 | 82.23 | 414 914 | 17.77 |
| Sistemi qarkullues për furnizim me ujë | 1 139 317 | 644 734 | 56.59 | 494 584 | 43.41 |
| Mbrojtja e ajrit | 496 937 | 447 761 | 90.10 | 49 176 | 9.90 |
| Mbrojtja e tokës, ujrat sipërfaqësore dhe nëntokësore | 148 181 | 49 349 | 33.30 | 98 833 | 66.70 |
| Mbrojtjen e pyjeve | - | - | - | - | - |
| Mbrojtja e biodiversitetit dhe natyrës | 171 283 | 103 980 | 60.71 | 67 303 | 39.29 |
| Gjuetia dhe peshkimi | - | - | - | - | - |
| Menaxhimi me mbeturina | 1 594 094 | 720 711 | 45.21 | 873 383 | 54.79 |
| Mbrojtja nga zhurma | 8 996 | 6 486 | 72.10 | 2 510 | 27.90 |
| Aktivite për hulumtim dhe zhvillim | 14 986 | 14 112 | - | 874 | 5.83 |
| Aktivite arsimore, edukative dhe të ngjajshme | 1 290 | - | - | 1 290 | 100.00 |
| Aktivite administrative | 14 766 | - | - | 14 766 | 100.00 |
| Pajisje për mbikëqyrje dhe kontroll, analizë dhe shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjes | 42 709 | 3 834 | 8.98 | 38 875 | 91.02 |
| Vlerësimi i ndikimit të mjedisit jetësor dhe vlerësimi i konsistencës | 7 465 | - | - | 7 465 | 100.00 |

Veprat penale kundër mjedisit jetësor, analizë sipas të dhënave nga Prokuroritë Publike dhe gjykatat e RM-së

Në bazë të të dhënave nga Prokuroritë Publike të Republikës së Maqedonisë, për veprat penale kundër mjedisit jetësor dhe ambientit në vitet 2015 -2020

Në vazhdim do t'u paraqesem disa aktgjykime që kemi marrë nga Prokuroria Themelore dhe gjykata në Kumanovë dhe Tetovë për disa lloje të veprave penale kundër natyrës dhe mjedisit jetësor.

NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

GJYKATA THEMELORE KUMANOVË - si Gjykatë Penale e shkallës së parë përmes gjykatësit L. GJ. si gjykatës individual me procesverbalisten V. A. në lëndën penale kundër të akuzuarit M. GJ. nga fsh. Kojnare e Epërme, i akuzuar me aktakuzë të PTHP Kumanovë, Ko. nr. 610/17 nga 10.11.2017 për vepër penale PESHKIM I PALEJUAR, neni 229 paragrafi 1 në lidhje me nenin 22 të KP, pas mbajtjes së seancës verbale, publike dhe kryesore në prezencë të PP T. S. dhe të akuzuarit M. GJ. më 04.04.2018 e miratoi dhe shpalli publikisht këtë

AKTGJYKIM

I AKUZUARI M.GJ. nga babai V. GJ. dhe nëna Z. GJ. lindur më 28.08.1997 në Kumanovë, jeton në fsh. Kojnare e Epërme i punësuar në “Kvalitet Prom”, i pamartuar, shkollën fillore të mbaruar dobët, i pasur, i padënuar, nuk ka procedurë penale për vepër tjetër penale, maqedonas, shtetas i RMV-së me numër amëz 260089497420050

ËSHTE FAJTOR:

PËR SHKAK SE

Më 21.07.2017 rreth orës 17:35 në zonën e fsh. Dovezenc, vendi i quajtur “Zdravkin Kamen” në Kriva Reka në zonën e peshkimit Kriva Reka 2, ka gjuajtur peshq me mjete që janë të ndaluara për peshkim, në mënyrë që derisa ka qëndruar në ujë duke gjujatur peshq para rrjetës, e cila ka qenë e vendosur, është kapur nga dëshmitari i cili ka qenë rojtari i peshqve Z. S., i cili në vendin e ngjarjes ia ka marrë rrjetën dhe peshqit që i ka gjuajtur.

Me veprimet e sipërme i akuzuari M. GJ. nga Kojnarja e Epërme e ka kryer veprën penale Peshkim i ndaluar nga neni 229, paragrafi 1 në lidhje me nenin 22 të KP dhe me zbatimin e këtij neni dhe zbatimin e nenit 32 dhe 39 nga KP, gjykata i shqipton dënim me burg prej 3 muajsh, dhe zbatimin e neneve 49 dhe 50 nga KP të akuzuarit i shqipton masë alternative

DËNIM ME KUSHT

Dënimi me burg prej 3 muajve nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në afat prej 2 vjetësh pas plotëfuqishmërisë së dënimit nuk do të kryen veprë tjetër penale.

Të paguajë paushall ndaj gjyqit prej 2.000,00 den në afat prej 15 ditëve pas plotëfuqishmërisë së akgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm

ARSYETIMI

Prokuroria themelore publike - Kumanovë me aktakuzën Ko. nr. 610/17 nga 10.11.2017 e ka akuzuar M. GJ. nga fsh. Kojnare, se ka kryer veprë penale Peshkim të Ndaluar nga neni 229 paragrafi 1, në lidhje me nenin 22 të KP.

Në fjalën e saj pëfundimtare, PP T. S. mbajti qëndrimin e aktakuzës, me çka potencoi se gjendja faktike është konstatuar me pranimin e fajit nga i akuzuari dhe propozoi që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, dhe gjykata t'i ketë parasysht të gjitha rrethanat nga neni 39 të KP si rrethana lehtësuese gjithashtu edhe ato rënduese dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënimi, me të cilin do të plotësohen qëllimet e dënimit nga neni 32 të KP.

Në fjalën e tij përmbyllëse i akuzuari M. GJ. nuk ndryshoi nga qëndrimi i tij pranimit të fajit, shprehu pendim për veprën e kryer dhe luti gjyqin që t'i vlerësojë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe të dënohet me dënim më të butë.

Në seancën kryesore i akuzuari M. GJ. pranoi fajin për veprën që akuzohet, që e ka kryer në mënyrë, kohë dhe vend sikur që është përshkruar në aktakuzë, ku u dhanë dëshmi në raport me

vendimin për sanksion penal dhe u bë këqyrja në evidencë penale të Gjykatës Themelore Kumanovë LP 6060\17 nga 06.09.2017 dhe në bazë të pranimit të fajit gjykata konstatoi situatën faktike vijuese.

46) Burim zyrtar nga PTPH-KUMANOVË

NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISE SË VERIUT

GJYKATA THEMELORE KUMANOVË - si gjykatë penale e shkallës së parë përmes gjykatësit L. GJ. - gjykatës individual, me procesverbalisten S. N. në veprën penale kundër të akuzuarit S. A. nga fsh. Maglanc, komuna Staro Nagoriçan, duke vepruar mbi propozimin e parashtruar për dhënie të urdhrit ndëshkimor nga PTHP-Kumanovë, Ko. nr. 640/18 nga 14.11.2018 për vepër penale Shkatërrim i pyjeve nga neni 226 paragrafi 1 në lidhje me pikën 1 të KP më 20.11.2018 në pajtim me nenin 499 të LPP e miratoi këtë:

AKTGJYKIM

JEPET URDHËRI NDËSHKIMOR

I AKUZUARI S. A. nga babai R. A. dhe nëna R. A., i lindur më 27.12.1857 në fsh. Maglanc, komuna Staro Nagoriçan ku dhe jeton, maqedonas, shtetas i RMV-së, di shkrim dhe lexim, i papunë, i padënuar me nr. amzë 2712957420009

ËSHTË FAJTOR

PËR SHKAK SE:

Gjatë viteve 2016-2017 në data të pacaktuara, saktë në fsh. Maglanc, komuna Staro Nagoriçan, në kundërshtim me rregullat ka prerë pyllin e vet dhe në këtë mënyrë ka prerë dru në sasi prej 17.50 m³ nga parcela kadastrale nr. 961 të fshatit Maglanc, e regjistruar në fletëpronësi nr.148 dhe sasi prej 80.60 m³ nga parcela kadastrale nr. 1007 Maglenc, e regjistruar në fletëpronësi nr. 54, gjegjësisht ka kryer prerje të ndaluar të drunjëve në sasi prej 102.1 m³ të gjitha të pastampuara, nga pylli në pronësi të babait të vet, i vdekur R. A. nga fsh. Maglanc, komuna Staro Nagoriçan në kundërshtim me ligjin për pyje nga nenet 62 dhe 69 nga Ligji për pyje dhe Vendimi nr. 09./400 i 30.04.2916 i dhënë nga NP” PYJET E RMV-së “ sektori Kumanovë, me të cilën refuzohet kërkesa për leje për prerje të drunjve nga parcela 961 në Maglence.

Me veprimet e mësipërme i akuzuari S. A. nga fsh. Maglanc, komuna Staro Nagoriçan ka kryer veprën penale Shkatërrim i pyjeve nga neni 226 paragrafi 3 në lidhje me pikën 1 të KP në pajtim me këtë nen dhe nenet 32 dhe 39 KP gjykata e dënon

ME DËNIM ME TË HOLLA në shumë prej 30 mëditjeve me vlerë nga 10 euro një mëditje, në kundërvlerë prej 615,00 denar ose gjithsej 300 euro në kundërvlerë të denarit prej 18.450,00 denarë, të cilën duhet ta pagujë në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, dhe nëse nuk paguhet në afatin e caktuar, gjykata do të urdhërojë përmbarimin e dhunshëm dhe nëse edhe kjo mbetet pa suksese, gjykata do ta ekzekutojë në mënyrë që për çdo mëditje do të shqiptojë 1 ditë burg.

T'i pagujë paushall gjykatësit prej 2.000,00 den në afat prej 15 ditëve pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit nën frikën e përmbarimit të detyrueshëm

ARSYETIMI

Prokuroria themelore publike - Kumanovë, deri te kjo gjykatë ka parashtruar propozim për dhënie të urdhrin ndëshkimor, Ko. nr 640/18 nga 14.11.2018 kundër të akuzuarit S. A nga fsh. Maglanc, komuna Staro Nagoriçan për veprë penale Shkatërrim i pyejeve nga neni 226, paragrafi 3 në lidhje me paragrafin 1 nga KP, me të cilin u propozua që gjykata të akuzuarit t'i shqiptojë dënim me të holla.

Gjyqi duke vepruar në bazë të propozimit, ka kryer këqyrjen në pretendimet e propozimit dhe faktet e bashkangjitura dhe atë, Kërkesën për leje për prerjen e drunjëve në pyllin privat në KP nr. 961 në fsh. Meglanc, nën nr. 400 nga 14.04.2016, vendimi për refuzimin e kërkesës për Leje për prerjen e drunjëve në pyll privat me nr. 09-400 nga 30.04.2016, Raporti zyrtar nga Agjensioni i kadastrës për patundshmëri, Sektori për kadastrë të patundshmërive - Kumanovë nga 02.05.2018 ka certifikatë nga plani kadastral 1109-1669/2018 nga 02.05.2018, këqyrje detale e të dhënave nga parcela kadastrale nr. 961 Maglance, raport i jashtëzakonshëm nga inspektimi i mbikqyrjës nr. 08-135 nga 24.04.2018, dy certifikata për kontrollimin historik të ndryshimeve në parcelën kadastrale nr. 1007 Maglance me nr. 1107-1-54/2017 dhe 1007-1053/2017 nga 28.11.2017, fotodokumentacioni nr. 0479/ 2018 i përgatitur nga MPB, SPB tenika kriminalistike, raport nga evidenca penale KP-6149/ 2018 Procesverbal nga dëgjimi i S. M. - përfaqesues e "NP PYJET E RMV-së" Kumanovë, Ko. nr. 640-18 dhe dëshmitaren L. J., Ko. nr.640/18, nga të cilat konsistoi se propozimi i PTHP Kumanovë, është parashtruar për veprë penale nga kompetenca e

gjykatësit individual, propozimit iu kanë bashkëangjitur dëshmi të mjaftushme dhe propozimin për sjelljen e aktgjyimit për shqiptim të dënimit me të holla në shumë prej 30 gjobave ditore në vlerë prej 10 eurove për gjobë ditore, në kundërvlerë të denarit prej 615,00 ose gjithsej 300 euro në kundërvlerë të denarit prej 18.450,00 denarë në pajtim me nenin 497 të LPP.

47)Burim Zyrtare nga PTHP-Kumanove

NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISE SË VERIUT

GJYKATA THEMELORE KUMANOVË - si gjykatë penale e shkallës së parë, përmes gjykatësit L. GJ. si gjykatës i vetëm, me procesverbalisten S. N. në lëndën penale kundër të akuzuarit C. S., i akuzuar me propozim akuzë të PTHP Kumanovë Ko. nr. 966/17 nga 19.03.2018 për vepër penale Gjueti e ndaluar nga neni 228, paragrafi 1 nga KP, pas mbajtjes së senacës kryesore dhe publike në prezencë të PP I. S., ndihmëse e të dëmtuarit I. C., avokate nga Kumanova, i akuzuari C. S. dhe mbrojtësi i tij M. I. nga Kumanova, më 08.04.2019 e miratoi dhe e shpalli publikisht këtë në vijim

AKTGJYKIM

I AKUZIARI: C. A. nga babai N. S. dhe nëna G. S., i lindur më 03.08.1960 në fsh. Mllado Nagoricane, komuna e Staro Nagoricanit, jeton në Kumanovë në rr. “Budimir Dimikovski” nr. 16, maqedonas, shtetas i RMV-së, i punësuar, i martuar, baba i dy fëmijëve të rritur, ka kryer shkollën e mesme, mestarisht i pasur, i dënuar me aktgjykim K-154/15 të Gjykatës Themelore Kumanovë, për vepër penale nga neni 361, paragrafi 1 nga KP me dënim me kusht, nuk udhëhiqet procedurë penale për vepër tjetër penale, me nr. amzë 0308960420017

ËSHTË FAJTOR

PËR SHKAK SE:

Më 25.08.2017 rreth orës 00:30 në rrethin e fsh. Skaçkovc, në vendin e ashtuquajatur “Bella Voda”, terren i gjuetisë nr. 13, Orashac, ka gjuajtur kafshë të egra në periudhën e ndaluar të gjuetisë, në mënyrë që deri sa ka qenë përreth arës së mbjellur me misër në afërsi të rrugës së asfaltuar për Sveti Nikollë, së bashku me personin N. N., ka vepruar në kundërshtim me nenin 12, paragrafi 1, pika dhe neni 54, paragrafet 1, 2 dhe 3 nga Ligji për gjueti (Gazeta Zyrtare e RMV-së me nr. 26/09), me atë që ka gjuajtur derra të egër me armë gjuetie mark “IZH 27”,

kalibri 12 mm, me numër prodhimi 9465096 dhe batari për gjuajtje të derrave në terrenin e gjuetisë nr.13 Orashac, e cila i është dhënë me koncesion Shoqatës së gjuetarëve “Sokol” Kumanovë, me çka është kapur nga roja për gjuetinë e paligjshme, në përbërje të së cilës kanë qenë dëshmitarët P. S. dhe R. S., të cilët në vendngjarje me vërtetim për marrje ia kanë marrë pushkën e gjuetisë.

Me veprimet e mësipërme, i akuzuari C. S., ka kryer veprën penale Gjueti e ndaluar nga neni 228, paragrafi 1 nga KP me zbatimin e këtij neni dhe neve 32 dhe 39 nga KP, gjykata i përcakton dënim me burg në kohëzgjatje prej 4 muajve dhe me aplikimin e nenit 49 dhe 50 nga KP të akuzuarit i shqipton masë alternative.

DËNIM ME KUSHT

Dënimi i përcaktuar me burg prej 4 muajve nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari 2 vjet pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, nuk kryen vepër të re penale.

Të pagujë paushall prej 3.000,00 dhe harxhime penale të demturës së Shoqatës së gjuetarëve “SOKOL” Kumanovë në shumë prej 54.600.00 denarë, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

ARSYETIMI

PTHP-Kumanovë me propozimakuze Ko. nr.966/27 nga 19.03.2018, e akuzuar C. A. nga Kumanova, se ka kryer veprën penale Gjuetia e ndaluar nga neni 228 paragrafi 1 të KP. Në fjalën përfundimtare PP I. S. bëri precizimin e shprehjes nga propozimakuza, dhe qëndroi në propozimakuzën e precizuar dhe në fjalën përfundimtare e dhënë në procesverbal në seancën kryesore të datës 19.09.2018, me çka theksoi se gjendja faktike është konstatuar me shpalosjen e dëshmive dhe atë me deklarimin e përfaqësuesit të SHGJ “Sokol” D. D. dhe deklaratat e dëshmitarëve P. S. dhe R. S. dhe gjykata propozoi që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, Gjukata t’i ketë parasysh të gjitha rrethanat nga neni 39 KP, si dhe rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese, dhe të akuzuarit t’i shqiptojë dënim, me të cilin do të plotësohen qëllimet e dënimit sipas nenit 32 të KP.

Në fjalën përfundimtare e autorizuar e të dëmtuarit I. C., avokate nga Kumanova, mbajti qëndrimin e njëjtë me atë të deklaruar më parë dhe u pajtua me fjalën përfundimtare të prokurorit

publik dhe theksoi që harxhimet për përfaqësim të të dëmtuarit, dhe i dëmtuari për kërkesat pronësore juridike të drejtohet në procedurë të rregullt civile.

Në fjalën përfundimtare, mbrojtësi i të akuzuarit, M. I. avokat nga Kumanova, theksoi se prokuroria nuk ka vepruar në bazë të rekomandimeve të dheëna nga ana e Gjykatës së Apelit, Shkup, dhe se prokuroria thirret në dispozitat e Ligjit për gjueti të një gjendjeje faktike të papërcaktuar, këshilltari teknik ka cekur se vendi, ku gjoja ka ndodhur ngjarja, nuk përfaqson territor gjuajtje dhe në atë kuptim, nuk ekziston gjueti në atë territor dhe në rastin konkret bëhet fjalë për procedurë penale të inskenuar për motive tjera, dhe dukshëm nga këqyrja e kryer në të dy lëndët të PTHP Kumanovë nga ana e SHGJ “Sokol” është kërkuar mito nga i akuzuari, e cila është paraqitur në MPB dhe pas inicimit të asaj procedure nga ana e SHGJ “Sokol” është parashtruar kallëzim penal kundër të akuzuarit dhe propozoi që i akuzuari të lirohet nga akuza.

Në fjalën e tij përfundimtare i akuzuari C. S. qëndroi në mbrojtjen e vet dhe në tërësi u pajtua me fjalën përfundimtare dhe mbrojtjen e dhënë nga avokati i tij dhe propozoi që të lirohet nga aktakuza.

NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISE SË VERIUT

GJYKATA THEMELORE KUMANOVË - si gjykatë penale e shkallës së parë, përmes gjykatësit L. GJ. si gjykatës i vetëm, me procesverbalisten S. N., në lëndën penale kundër të akuzuarit Ç. K. nga fsh. Dobraça, komuna Staro Nagoriçan, duke vepruar në bazë të propozimit për dhënien e urdhërit ndëshkimor të PP Kumanovë, Ko. nr.737/21 nga 27.10.2020 për vepër penale Uzuprimi i patundshmërive nga neni 225, paragrafi 1 prej KP më 29.10.2020 në përputhje me nenin 49 të KP, miratoi:

AKTGJYKIM

I AKUZUARI: Ç. K. nga babai T. K. dhe nëna Z. A., i lindur më 27.10.1959 në fsh. Dobraça, komuna Staro Nagoriçan, ku dhe jeton, maqedonas, shtetas i RMV-së, i martuar, i padënuar, me nr. amzë 071959420030

ËSHTË FAJTOR PËR SHKAK SE

Me datë të padefinuar saktë, gjatë viti 2020 në fsh. Dragomancë, komuna Staro Nagoriçan, me qëllim të posedimit, ka marrë patundshmëri të huaj tokë bujqësore, në pronësi të huaj me qëllim që të ndërtojë fermë dhe të ruaj bagëti në fsh. Dragomancë, pa pëlqimin e të dëmtuarit R. M. ka marrë dhe ka shfrytëzuar patundshmëri gjithsej 289 m² tokë bujqësore.

Me veprimet e mësipërme i akuzuari C. K. nga fsh. Dobraça, komuna Staro Nagoriçan, ka kryer vepër penale Uzuprimi i patundshmërive nga neni 225, paragrafi 1 nga KP, dhe me zbatimin e këtij neni dhe me zbatimin e neneve 32 dhe 39 nga PK gjykata e:

DËNON:

DËNIM ME TË HOLLA në vlerë prej 10 mëditjeve, në vlerë prej 20 euro për një mëditje, në

kundërvlerë të denarit prej 1.230,00 den ose gjithsej 200 euro në kundërvlerë të denarit prej 12.300,00 den, të cilën duhet ta paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse e njëjta nuk paguhet në afatin e caktuar, gjykata do të urdhërojë përmbarimin e dhunshëm, dhe nëse dhe përmbarimi i dhunshëm nuk ka suksese, gjykata do të caktojë për çdo mëditje nga 1 ditë burg.

T'i paguajë paushall gjykatës prej 3.000.00 den në afat prej 15 ditëve pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, nën frikën e përmbarimit të dhunshëm.

ARSYETIMI

Prokuroria themelore në Kumanovë, deri te kjo gjykatë ka dorëzuar për dhënien e Ko. nr. 737/21 nga 27.10.2020 kundër të akuzuarit Ç. A. nga fsh. Dobraça, komuna Staro Nagoriçan për veprë penale Uzurpimi i patundshmërive nga neni 225 alineja 1 nga KP, më të cilin propozoi që gjykata të akuzuarit t'i shqiptojë dënim me para.

Gjykata duke vepruar në bazë të propozimit, bëri këqyrjen e dëshmimeve të dorzuara, në bazë të të cilave përcaktoi se propozimi i PPTH-Kumanovë është parashtruar për veprë penale nga kompetenca e gjykatës individual, propozimit i janë bashkangjitur dëshmi të mjaftushme për dhënien, dhe atë AKTI nr. 1104-405/2 nga 25.09.2020 nga Agjencioni i kadastrës së patundshmërive, Sektori i kadastrës së patundshmërive Kumanovë - origjinal, Skica nr. 110r/405 1 nga 07.08.2020 kontroll detal i të dhënave të Kadastrës komunale - Dragomacë, akti nga Sektori për inspektim mbikqyrës, në komunën e Kumanovës - Inspektoriati i ndërtimit, raport nga Sektori për inspektim mbikqyrës, lajmërim nga D. S. deri te inspektorati i ndërtimit nga 05.08.2020 fotodokumentimin nr. 05333/2020 e përgatitur nga MPB, SPN Kumanovë dhe lista nga evidenca penale nga Gjykata themelore Kumanovë, VP 8049/2020 nga 20.10.2020 dhe në bazë të nenit 499 nga LPP vendosi si në shqiptimin e aktgjykimit

NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISE SË VERIUT

GJYKATA THEMELORE TETOVË - si gjykatë penale e shkallës së parë, përmes gjykatësit B. J. si gjykatës individual, me procesverbalisten V. S. - punëtore gjyqësore, duke vepruar në bazë të propozimit për dhënien e urdhrit ndëshkimor nga PTHP Tetovë, Ko. nr 524/15 nga 09.09.2016 kundër të akuzuarit R. Z. nga fsh. Çelopek, për vepër penale Shkatërrim i pyjeve, të nenit 226 paragrafi 1 nga KP në pajtim me nenin 229 të LP, më 27.09.2016 e miratoi këtë

AKTGJYKIM

Për dhënien e urdhrit ndëshkimor

I AKUZUARI: R. S. nga babai A. S. dhe nëna A. S., i lindur më 27.05.1962 në fsh. Çelopek, ku dhe jeton, me nr. amzë 270596247018, shqiptar, shtetas i RMV-së

ËSHTË FAJTOR

PËR SHKAK SE

Më datë 05.06.2015 në periudhën kohore prej 06:00 deri 18:00 në rethin e fsh. Leshnicë e poshtme, në vendin e quajtur “Mbi Çeshmën e Hoxhës (Gjur Çavzabel) në drejtim të fshatit Strimnicë – Çollopek, në pronësi të RMV-së, në kundërshtim me Ligjin për Pyje (Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 75/2010), më të cilin ndalohet prerja e paligjshme e pyjeve, i akuzuari ka prerë dru me motor të markës STIL me nr. 113079904 A dhe atë 1.4 m³ dru dushku duke dëmtuar NP “PYJET E MAQEDONISË”, filiali ShS LESHNICË në vlerë prej 4.906.00 den, me ç’rast drunjtë e dushkut nga ana e policisë të Stacionit policor Grupçin SPB Tetovë janë konfiskuar me vërtetim për konfiskim të përkohshëm të sendeve.

Me këto veprime i akuzuari ka kryer vepër penale SHKATËRRIM I PYJEVE nga neni 226, paragrafi 1 nga KP dhe dhe në pajtim me dispozitën ligjore të cituar dhe dispozitat nga neni 32,

33, 39, 48, 48-a, 49 dhe 50 KP dhe neni 102 dhe 105 nga LPP, gjykata i shqipton MASË ALTERNATIVE DËNIM ME KUSHT.

TË AKUZUARIT I PËRCAKTOHET DËNIM ME BURG PREJ 3 MUAJSH DHE NJËKOHËSISHT VENDOS QË E NJËJTA NUK DO TË EKZEKUTOHET, NËSE I AKUZUARI NË KOHE PREJ 1 VITI PAS PLOTËFUQIESHMËRISË SË AKTGJYKIMIT NUK KRYEN VËPËR TJETËR PENALE.

I akzuarit obligohet të pagujë pushall gjyqësor prej 1.500 den në afat prej 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Obligohet i akzuarit, që të dëmtuarës NP PYJET E MAQEDONISË. filialës SHS Leshnicë t'ia kompenzojë dëmin e shkaktuar në vlerë prej 4.906, 00 denarë në afat prej 30 ditëve nga plotfuqishmëria e aktgjykimit dhe për kërkesën eventuale më të lartë, drejtohen në kontest civil. Në pajtim me nenin 226 paragrafi 4 të KP motori i markës STIL me numër serik 113079904 si mjet i përdorur për kryjen e veprës penale konfiskohet në dobi të shtetit të RMV-së

ARYSETIMI

PTHP-Tetovë, parashtroi propozim për dhënien e urdhrin ndëshkimor KO. 542/15 nga 09.09.20016 kundër R. Z. nga fshati Çellopek, për veprën penale SHKATËRRIM I PYJEVE nga neni 226 paragrafi 1 në pajtim me nenin 497 të LPP

Prokurori publik me propozim për dhënin e urdhrin ndëshkimor konkret propozoi që gjykata të miratojë aktgjykimin për dhënien e urdhrin ndëshkimor, me të cilin i akzuarit do të shpallet fajtor dhe do t'i shqiptohet dënimi me kusht.

Gjykata duke vepruar në bazë të propozimit për dhënien e urdhrin ndëshkimor, në pajtim me nenin 499 të LPP u pajtua me propozimin dhe në rastin konkret vendosi të miratojë aktgjykim me dhënie të urdhrin ndëshkimor dhe duke pasur parasysh dëshmitë e prezentuara dhe atë: procesverbali nga kontrolli në vendin e ngjarjes nr. 971 nga 05.06.2016, procesverbali nga

dorëzimi i mjeteve të marra-konfiskuara nr. 9/1 nga 05.06.2016, vërtetimin për mjetin e konfiskuar përkohësisht nr. 9 nga 05.06.2015, fotodokumentacioni nr. 971/16 me fotografi të SPB Tetovë, vëretton këtë.

I akuzuari më datë 05.06.2015 në periudhën kohore prej 06:00 deri 18:00 në rethin e fsh. Leshnicë e poshtme, në vendin e quajtur “Mbi Çeshmën e Hoxhës (Gjur Çavzabel), në drejtim të fshatit Strimnicë - Çollopek në pronësi të RMV-së në kundërshtim me Ligjin për Pyje (Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr.75/2010) më të cilin ndalohet prerja joligjore e pyjeve, i akuzuari ka prerë dru me motor të markës STIL me nr. 113079904 A dhe atë 1.4 m³, dru dushku për ngrohje dhe në këtë mënyrë ka dëmtuar NP Pyjet e Maqedonisë, filialën SHS Leshnicë në vlerë prej 4906 den me çka drunjët e dushkut nga ana e zyrtarëve policor të SP Grupçin SPB Tetovë i janë konfiskuar me vërtetim për konfiskim të përkohshem të mjeteve.

Në bazë të gjendjes faktike të konstatuar gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit R. S. nga fsh. Çollopek ka elemente të veprës penale SHKATËRRIM I PYJEVE nga neni 226 paragrafi 1 nga KP e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me kusht.

Gjyqi pranoi propozimin e prokuroit publik për dhënien e urdhrit ndëshkimor me aktgjykimin, me të cilin do të shqiptohet dënimi alternative - dënim me kusht, në mënyrë që të akuzuarit do t'i shqiptohet dënim me burg prej 3 muajsh, i cili nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në kohë prej 1 vjet nuk kryhen vepër tjetër penale.

NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISE SË VERIUT

GJYKATA THEMELORE TETOVË - si gjykatë penale e shkallës së parë, përmes gjykatësit B. J. si gjykatës individual, me procesverbalisten L. T. - punëtore gjyqësore në lëndën penale kundër të akuzuarit H. S. nga Tetova, me propozimakupzë të PTHP Tetovë, Ko. nr. 541/17 nga data 19.07.2018 për vepër penale SHKATËRRIM I PYJEVE nga neni 22y , paragrafi 1 nnga KP, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik më datë 31.10.2018 dhe 23.11.2018 në prezencë të përfaqësuesit të akuzës, prokurorit publik L. K., i akuzuari dhe mbrojtësi i tij J. S., avokat nga Tetova, më 23.11.2018, e miratoi dhe shpalli publikisht këtë

AKTGJYKIM

I AKUZUARI: H. S., nga babai I. S. dhe nëna E. S., i lindur më 04.04.1956 në fsh.Veshallë, tani jeton në Tetovë në nr.133, nr.36 me nr.amzë 044956470009, i martuar baba i dy fëmijëve, inxhinier i agronomisë, i punësuar në NP për menaxhim me kullosa SHKUP, njësia rajonale “SHARRI” në Tetovë si udhëheqës me rrogë mujore prej 30.000 denar, i padënuar, shqiptar, shtetas i RMV-së

NË PAJTIM ME NENIN 403, PARGRAFI 1, PIKA 3 LIROHET NGA AKTAKUZA

SE:

Në gjysmën e dytë të muajit maj 2017 në kundërshtim me dispozitat e nenit 14, paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për Pyje në rrethinën e Tetovës në mënyrë tjetër ka shkatërruar pyllin në SHSE “Leshniçka shuma”, me të cilën menaxhon NP PYJET E MAQEDONISË, mbi lagjen e vikendit në rajonin e Kodrës së Diellit në vendin e quajtur “Carepashin”, në mënyrë që me Katerpilar me zhinxhirë me ngjyrë të verdhë, nga jashtë me symbol “CAT312B” dhe në pjesën e poshtme të ulësës në pllakë metalike me të dhëna vijuese, 525, R,KBA, Katerpilar 5HK93164, 6 SË00135, Model 312 B KË 66, KGR 500, si udhëheqës i njësisë Sharri - Tetovë, në NP për menaxhim me kullosat - Shkup, në vend të pastrimit, rekonstruimit të rrugëve, prej dheu deri te kullosat me

lajmërim nr. 05-345-22 nga data 12.01.2017 të NP për menaxhim me kullosat - Shkup, ka bërë hapjen e rrugëve të reja dhe atë: Në pjesën e 28, nënpjesa a në drejtim të Leshnices së Poshtme kah Leshnica e epërme në pyll është hapur rruga e re me gjatësi rreth 1 km me gjërësi rreth 4 m dhe kështu ka shkelur drunjë bredhi dhe ahu në vlerë 89,570,00 denar

Në pjesën e 33-të, nënpjesa b dhe c me shkuljen e drunjëve të bredhit dhe ahut në vlerë prej 37,052,00 denarë, Në pjesën 34, nënpjesa, me shkuljen e drunjëve të llojit bredh në vlerë prej 139.029 denarë ose gjithsej 1.074.651 denarë që paraqet dëm të NP Pyjet e Maqedonisë.

Me të cilin veprim i akuzuari do të kryente vepër penale SHKATËRRIM I PYJEVE nga neni 226 paragrafi 1 nga KP harxhimet e procedurës bien ne ngarkesë të buxhetiti të RMV-së.

E dëmtuara NP Pyjet e Maqedonisë, për realizimin evetual të kërkesave pronësore juridike, udhëzohet në kontekst civil.

ARSYETIMI

PTHP-Tetovë, parashtroi propozimin për dhënien e urdhrin ndëshkimor Ko. nr. 541/17 nga data 19.07.2018 kundër të akuzuarit H. S. nga Tetova për vepër penale Shkatërrim i pyllit nga neni 226 paragrafi 1 nga KP në pajtim me nenin 497 të LP.

Duke vepruar në bazë të propozimit për dhënie të urdhrin ndëshkimor, gjyqi miratoi aktgjykim me dhënien e urdhrin ndëshkimor Ko. nr. 365/18, me të cilin i akuzuari S. H. nga Tetova e shpalli fajtor për veprën penale Shkatërrim i pyjeve nga neni 226 paragrafi 1 nga KP dhe shqiptoi dënim alternativ, dënim me kusht.

Kundër aktgjykimit për dhënien e urdhrin ndëshkimor i akuzuari përmes avokatit të tij J. S. nga Tetova parashtroi ankësë në afatin e paraparë ligjor.

Duke vepruar në bazë për dhënien e propozimit të parashtruar gjykata caktoi dhe mbajti seancë kryesore më 31.10.2018 dhe 23.11.2018 në pajtim me nenin 500 paragrafi 5 dhe 6 të LPP në prezencë të përfaqësuesit të akuzës, prokurores L. K., të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij J. S., avokat nga Tetova.

Në fjalën përfundimtare të akuzës, prokurorja L. K. theksoi se me dëshmitë e paraqitura gjatë tërë procedurës, u dëshmuua se i akuzuari ka kryer veprën penale që i ngarkohet, dhe për atë arsye i propozon gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Në fjalën përfundimtare të të akuzuarit, avokati J. S., theksoi se i akuzuari H. S. aspak nuk e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe për këtë arsye i propozoi gjyqit që ta lirojë nga aktakuza, gjegjësisht të sjellë aktgjykim lirues.

3.4. Analizë e përgjithshme për veprat penale kundër mjedisit jetësor në rajonin e Kumanovës dhe Likovës

Në këtë kohë moderne në të cilën thirremi se jetojmë të gjithë, ku zhvillimet në teknologji kanë marrë hov të madh, dhe të njëjtat shfrytëzohen nga vendet e ndryshme në Evropë dhe më gjerë për të ndihmuar të gjitha proceset për zhvillim të shtetit dhe shoqërisë. Duke krahasuar këto zhvillime, Republika e Maqedonisë së Veriut përballet me regres të madh ose të paktën këto të mira që na ofron teknologjia nuk shfrytëzohen për qëllime të mira, siç është mungesa e një aplikacioni të thjeshtë (deri në vitin 2020) me të cilin qytetarët do të njoftoheshin për cilësinë e ajrit dhe nivelin e grimcave të dëmshme në ajër, që vijnë si rezultat i ndotjes enorme.

Qytetarët e Kumanovës, krahas problemeve në infrastrukturë rrugore, mungesës së transportit publik, komunikacionit të rënduar, ndërtimeve pa leje, po përballen edhe me ajrin e ndotur i cili është mbi nivelet e lejuara. Gjithë kjo ndotje që përmban në vete vulën e problemeve infrastrukturore e të tjera që përmendëm më lartë, si dhe problemi tjetër që po shqetëson banorët e kësaj komune dhe më gjerë, fabrikat e ndryshme prodhuese që gravitojnë në këtë zonë dhe vazhdojnë punën duke mos respektuar standardet ekologjike dhe në masë të madhe ndotin ajrin që thithin qytetarët e Kumanovës. Vlen të theksohet ndotësi më i madh që është fabrika “Ambalazha dhe Shamicevi”, të cilat vazhdojnë të punojnë me intensitet të lartë duke mos respektuar standardet e nevojshme ekologjike.

Hedhja e mbeturinave në f. Nikushtak dhe kjo është problematikë mjaft serioze ekologjike në komunën e Likovës.

Ambienti jetësor dhe natyra në komunën e Likovës sipas të dhënave nga inspektorati shtetëror në departamentin e ambientit jetësor në komunën e Likovës janë bërë disa investime kapitale nga viti 2016, përfundime dhe ndërtime të shtretërve të lumenjve në disa fshatra të komunës së Likovës.

Përfundimi i ndërtimit të fabrikës për rregullimin e transportit, reciklimin e mbeturinave komunale, përgatitjen e dokumentacioneve tenike për pastrimin e ujërave të zeza (kolektorëve), sipas mundësive dhe realizimin e tyre, pastrimi i të gjitha deponive të egra në nivel komunal dhe në ato vende ku ka mundësi të bëhet gjelbërimi i atyre lokacioneve - hapësirave, d.m.th. që në të ardhmen të shfrytëzohen si vende për pushim dhe rekreacion, pastrimi dhe rregullimi i rrugëve

dhe hapësirave publike me pllaka bekatoni në vendbanimet e komunës së Likovës, mbështetje financiare për klubin e gjuetarëve të komunës etj.

Në vazhdim do t'i paraqesim disa tabela për disa vepra penale për rajonin e Kumanovës që kanë ndodhur gjatë viteve 2015-2020, dhe disa investime që janë bërë për pastrimin e ambientit jetësor dhe natyrës në Komunen e Likovës.

Prerje të paligjshme të drunjve (të konfiskuara) 2015-2020

| | |
|--------------------------|-------------------------------|
| 2015- | 48,00 – m³ |
| 2016- | 53,00 – m³ |
| 2017- | 56,00 --m³ |
| 2018- | 48,00 -- m³ |
| 2019- | 36,00 -- m³ |
| 2020- | 31,00 -- m³ |
| GJITHSEJ NË TOTAL | 272,00 m³ |

Djegje dhe shkatërrim i pyjeve 2015-2020

| | |
|--------------------------|------------------------|
| 2015 --- | 561,50 hektarë |
| 2016--- | 71,50 hektarë |
| 2017--- | 518,40 hektarë |
| 2018 --- | 86,00 hektarë |
| 2019--- | 698,00 hektarë |
| 2020--- | 26,00 hektarë |
| GJITHSEJ NË TOTAL | 1961,40 hektarë |

Mbjellje vjetore e pyjeve në rajonin e Kumanovës dhe Likovës 2020-20201

| | |
|--------------|----------------------|
| 2020- | 40,00 hektarë |
|--------------|----------------------|

| | |
|-------------------|---------------|
| 2021- | 24,00 hektarë |
| Gjithsej në total | 64,00 hektarë |

Kapitulli IV

METODIKA E SQARIMIT DHE ZBULIMIT TË KRIMINALITETIT EKOLOGJIK

1. Metodatat më efikase në parandalimin e krimit ekologjik

Parandalimi i krimit ekologjik është shpallur me ligj si një nga parimet kryesore të mbrojtjes së mjedisit, i cili shtron kërkesat për mbrojtjen e mjedisit në një fazë të hershme të zhvillimit të çdo veprimtarie. Padyshim që në parandalimin e krimit ekologjik perfshihen shumë organe shtetërore, shumë persona fizik dhe juridik, qoftë ata të jenë vendas apo të huaj, të gjithë mbrojnë mjedisin, por pa dalur jashtë ligjit „Për mbrojtje të mjedisit“.

Mirëpo, vlen të theksohet se rolin kryesor në parandalimin e krimit ekologjik padyshim se e ka Ministria e Mjedisit, ajo ka për detyrë të përgatitë strategji dhe plane mjedisore, si dhe të vlerësojë dhe miratojë planet apo programet me pasoja negative të rëndësishme në mjedis.

Po ashtu kjo ministri ka rol të rëndësishëm në nxitjen dhe mbështetjen e veprimtarive që synojnë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, me ndihmën e instrumenteve dhe mjeteve të politikës së mbrojtjes së mjedisit, të cilat janë të parashikuara me ligj,

Si metoda më efikase në parandalimin e krimit ekologjik përmenden: Reduktimi i trafikut nëpërmjet nxitjes së çiklizmit apo ecjes në qytet, Zvogëlimi i ndotjes nga automjetet nëpërmjet zonave me akses të kufizuar, Vendosja e një industrie që respekton cilësinë e ajrit, Ndërtimi i rrugëve, Modifikimi i automjeteve të vjetra ndotëse, Zonat e gjelbërta, Ndarja e mbeturinave, Përdorimi i biçikletave si mjete udhëtimi, Furnizimi i transportit jondotës.

2. Veprimet krimnalistike me karakter parandalues ndaj kriminalitetit ekologjik

Veprime krimnalistike të karakterit preventiv kemi shumë në shkencën e krimnalistikës, ne do t'i përmendim disa prej tyre, dhe në mënyrë të shkurtë do japim sqarime lidhur me ta.

1. Verifikimi krimnalistik

Verifikimi krimnalistik është masë dhe veprim i përgjithshëm operativ - taktik, qëllimi i të cilit është të vërtetohet saktësia (bazueshmëria) e fakteve (indiceve, bazave të dyshimit), të mbledhura (të kuptuara), të cilat tregojnë për një vepër të caktuar penale, kryerësin e saj apo për rrethana tjera të rëndësishme për ndriçimin e veprës penale apo të veprimtarisë së caktuar kriminale. Indiciet apo të dhënat, bazueshmërinë e të cilave duhet vërtetuar me anë të verifikimit, hedhur apo plotësuar pjesërisht, mund të jenë të shkallës së ndryshme të probabilitetit, më pak ose më shumë reale dhe logjike, të marra apo të mbledhura nga burimet e ndryshme.

Të gjitha këto fakte duhet të verifikohen në mënyrë që në bazë të shënimeve dhe fakteve të vërtetuara saktë, të mund të vazhdohet puna në ndriçimin e veprës konkrete penale dhe në zbulimin e kryerësit të saj. Për këtë arsye verifikimet dhe analizat janë bazë e masave dhe veprimeve të shumta taktike - operative si të atyre të përgjithshme ashtu edhe të atyre hetuese siç janë: racia, prita, privimi nga liria, kontrolli etj. Mirëpo nevoja për këtë lloj të veprimit operativ – taktik lidhur me veprën konkrete penale, shumë herë dhe shumë shpesh ekziston edhe pas kallëzimit penal apo raportit, madje edhe në procedurën e filluar tashmë penale, sikurse edhe gjithnjë kur duhet të vërtetohet probabiliteti apo bazueshmëria e fakteve të kuptuara më vonë. Për këtë arsye verifikimi është një metodë permanente në punën e personave zyrtarë me ç'rast zbatimi i tij aplikohet që në fillim me rastin e identifikimit të indiceve të para (baza e dyshimit) për veprën penale apo kryerësin e saj.

1.2. Llojet e verifikimeve

Në esencë, në kuadër të kriminalistikës dallojmë llojet e verifikimeve si vijon:

1. personat e autorizuar zyrtarë verifikimin e kryejnë me:
 - a) iniciativë personale; dhe b) kërkesë të subjekteve tjera;
2. sipas objektit të verifikimit kanë të bëjnë me: a) personat; dhe b) objektet;
3. sipas mënyrës së kryerjes së verifikimit ai mund të jetë: a) i hapur (publik); b) konspirativ (i fshehtë)

Verifikimet të cilat i bënë personi i autorizuar zyrtar në bazë të iniciativës personale kanë të bëjnë me bazat e dyshimit, indicet apo njohuritë, te të cilat këta persona të autorizuar kanë ardhur gjatë angazhimit operativ, me perceptim të drejtpërdrejtë, duke ushtruar masa dhe veprime të caktuara operative - taktike, në bazë të informatës të cilën ua kanë dhënë qytetarët, organizatat punuese, gjegjësisht subjektet tjerat, apo në ndonjë mënyrë tjetër, pa marrë parasysh se a ka ekzistuar interesimi për informatë të tillë paraprakisht apo jo. Këto verifikime janë më të shumtat dhe ato paraqesin bazën e veprimtarisë së tërësishme të personave të autorizuar zyrtarë.

Verifikimi sipas kërkesës së agjencisë tjetër bëhet konform parimit të koordinimit të bashkëpunimit midis disa agjencive për zbatimin e ligjit. Kërkesën për verifikim mund ta drejtojnë edhe organet tjera shtetërore, si p.sh. organet e gjyqësisë, organet ushtarake, organet përfaqësuese të bashkësive shoqërore - politike etj. Shumë të shpeshta janë edhe verifikimet të cilat kryhen me kërkesën e prokurorit publik, në pajtim me dispozitat e LPP. Është e domosdoshme që të gjitha verifikimet, të cilat kërkohen nga organet tjera, të kryhen në kohën e duhur, në mënyrë të hollësishme dhe me ndërgjegje. Vetëm raporti i tillë në bashkëpunimin

ndërpersonal mund të sjellë rezultate të kënaqshme në pengimin dhe luftimin e kriminalitetit.

Verifikimet të cilat kanë të bëjnë me disa objekte, para së gjithash atyre, ndaj të cilave më së shpeshti kryhen vepra penale ose shfaqen dukuri socio-patologjike dhe si të tilla kanë rëndësinë e objektit kriminogjen. Objektet e tilla verifikohen më së shpeshti duke mbledhur informata.

Qëllimi i verifikimeve të tilla është ndërmarrja e aktiviteteve tjera operative me qëllim të kontrollit kriminalistik apo të zbulimit të veprës penale.

Sipas mënyrës së kryerjes, verifikimet mund të jenë konspirative (të fshehta) dhe publike apo të hapura. Se kur me rastin e verifikimit të të dhënave mblidhen informata e të ngjashme do të zbatohet njëra apo tjetra metodë, varet para që gjithash nga objekti i verifikimit p.sh. ndryshe do të bëhet verifikimi i lidhjeve kriminale të të dyshuarit apo verifikimi i të dhënave për ndonjë person i cili përgatitet për ta kryer veprën penale, gjë që duhet bërë verifikimi në mënyrë diskrete, me qëllim që të vendoset prita në vendin ku planifikohet vepra apo për shkaqe të ngjashme operative, dhe ndryshe p.sh. duhet të verifikohet se ku banon dëshmitari i drejtpërdrejtë i ngjarjes së caktuar kriminale, gjegjësisht se a e ka paguar personi i caktuar tatimin e caktuar në pasuri, me anë të shikimit të librave tatimorë. Mënyra konspirative e verifikimit kërkon një shkallë shumë më të lartë të kujdesit dhe shkathtësisë më të madhe, një taktikë më komplekse dhe një kohë më të gjatë për ta kryer atë si dhe një pasiguri më të madhe kur është fjala për rezultatin përfundimtar të verifikimit.

3. Mbledhja e informatave

Kur vështrohet roli dhe detyrat e personave të autorizuar zyrtarë në luftë kundër kriminalitetit është me rëndësi që në këtë aktivitet të ekzistojë dyshimi, gjegjësisht baza për dyshim se është kryer vepra penale.

Bazat e dyshimit ekzistojnë nëse personi i autorizuar zyrtar ka kuptuar se ekziston probabiliteti se është kryer veprë penale. Me këtë rast për ekzistimin e bazës së dyshimit është irelevante se personi i dyshimtë për kryerjen e veprës penale a është i njohur apo jo. Koncepti i tillë i bazës së dyshimit duhet dalluar nga dyshimi i bazuar si një shkallë më e lartë e dyshimit. Kjo do të thotë

se për ekzistimin e bazës së dyshimit mbi kryerjen e veprës penale kërkohet një shkallë më e ulët e probabilitetit sesa për ekzistimin e dyshimit të bazuar i cili është i nevojshëm për inicimin e procedurës penale. Me qëllim të kryerjes së suksesshme të detyrave në këtë drejtim, personave të autorizuar u është lënë mundësia që të kërkojnë informata dhe raporte të nevojshme nga qytetarët.

Mbledhja e informatave të nevojshme nga qytetarët është formë e aktivitetit operativ-taktik e personave të autorizuar zyrtar, të cilin aktivitet ata e ndërmarrin me vetëiniciativë në mënyrë metodike dhe sipas planit të përpiluar më parë. Kjo detyrë e personave të autorizuar zyrtarë para së gjithash nënkupton detyrën e kërkimit të personave të cilët mund të japin informata të nevojshme dhe relevante. Pra, fjala është për të ashtuquajturat burime personale të informatave dhe nëse informatat merren sipas formës së paraparë, atëherë mund të kenë edhe karakter prove.

4. Planifikimi dhe përgatitja e bisedës

Pjesa e fundit e përgatitjes së bisedës është krijimi i planit për bisedë, bazën e së cilës e përbëjnë nëntë pyetjet e arta kriminalistike dhe veprohet hap pas hapi, nga e njohura drejtë të panjohurës. Duhet të caktohet pikënisja e drejtë dhe ajo që dëshirohet të konstatohet dhe të dëshmohet me bisedë. Pra, të kihet edhe kujdes se masat dhe aktivitetet e parapara dhe renditja e tyre a janë të përshtatura për këtë.

Gjithmonë fillohet nga e pakontestueshmja d.m.th. nga faktet e vërtetuara, nga rrethi privat dhe shoqëror i respondentit, nga situata e tij jetësore dhe banesore, nga rrethi profesional etj. Pra, nga anamneza sociale e respondentit. Nëse kriminalistët nuk i përmbahen parimit të njohjes të së vërtetës hap pas hapi, atëherë mund të vije deri te kërcimet në kërkimin e fakteve dhe në të menduarit për to, gjë që sjell deri te lajthimi apo shmangia.

Zakonisht plani i bisedës duhet të përmbajë:

1. përshkrimin e rrethanave të cilat duhet të sqarohen gjatë bisedës dhe formimin e pyetjeve me atë qëllim si dhe eventualisht renditjen e pyetjeve për këtë qëllim. Biseda duhet të jetë e gjallë dhe e orientuar drejt procesit, prandaj edhe plani i bisedës në rrjedhë e sipër aty për aty ndryshohet dhe plotësohet. Planin nuk është anketë dhe biseda nuk shtërrohet në dhënien e përgjigjeve në anketë. Situata taktike e dikton tërë një varg të pyetjeve të paparashikuara në

procesin e bisedës, qoftë bisedën e tillë ta ketë hapur korresponduesi apo atë ta ketë imponuar respondentit.

2. të parashihet renditja e pyetjeve dhe intervalet kohore në të cilat duhet qasur qartësisht të rrethanave të ndryshme, pra në çfarë momenti dhe sipas cilës radhë do të shtrohet pyetja e caktuar.

3. parashikimi i bisedave me të ashtuquajturit elementet e jashtme siç është; dita dhe ora, ku do të pritët resopondenti deri te fillimi i marrjes në pyetje etj.

5. Legjitimimi

(Lat. legitimare - legjitimim) është masë dhe veprim operativ-taktik, të cilin e ndërmarrin personat e autorizuar zyrtarë dhe ka për qëllim përcaktimin e identitetit të ndonjë personi.

Legjitimimi bën pjesë në grupin e atyre aktiviteteve zyrtare që shumë shpesh ndërmerren dhe me anë të të cilave mund të arrihet deri te të dhënat operative shumë të çmueshme. Në situatat e ndërmarrjes së bllokadave, kërkimeve, racive etj. legjitimimi është aktivitetet i domosdoshëm.

Përcaktimi i identitetit të personit kryhet duke shikuar dokumentet personale, para së gjithash letërnjoftimin. Vetë përcaktimi i identitetit të personit përfshin të gjitha faktet dhe karakteristikat me të cilat personi i caktuar dallohet nga të tjerët. Dokumentet e identitetit shpesh ndryshojnë.

Dokumenti elementar është letërnjoftimi, por mund të shërbejë edhe pasaporta, patentat e shoferit, matrikulli (libreza e marinarit), apo libreza e lundrimit detar, indeksi, etj.

Për t' i hyrë legjitimitit të ndonjë personi duhet të ekzistojnë arsyet e vërteta zyrtare (interesi zyrtar). Kriminalistika parasheh rregulla të veçanta taktike për zbatimin e legjitimitit të personave. Kështu, ekzistojnë rregulla të posaçme për legjitimimin e personave të dyshimtë të paarmatosur apo personave të armatosur, për legjitimim në vend publik, për legjitimim brenda

lokaleve, në automjete (aeroplan, tren, anije, autobus). Personat e njohur duhet të legjitimohen vetëm drejtpërsëdrejti kur është e nevojshme të merren shënimet për paraqitjen e kallëzimit.

6. Përcaktimi i identitetit

Përcaktimi i identitetit është aktivitet operativ-taktik dhe teknik i cili ndërmerret gjithmonë kur paraqitet dyshimi në identitetin e personit të caktuar fizik. Identiteti përcaktohet me metodat e taktikës dhe teknikës së kriminalistikës. Vërtetimi i identitetit të personit të caktuar nuk mjafton të bëhet vetëm në bazë të disa karakteristikave, por ai është i padyshimtë dhe i sigurtë vetëm atëherë kur për personin e tillë vërtetohen të gjitha ato cilësi me të cilat personi fizik dallohet nga cilido person tjetër.

Këto veti apo cilësi mund të sistemohen në tri grupe themelore, siç janë:

- a. vetitë juridike (emri, mbiemri, emri i babës, emri i nënës, shtetësia, gjendja martesore, vendbanimi, vendqëndrimi, dhe ndryshimet gjatë jetës)
- b. vetitë faktike (dita, muaji dhe viti i lindjes, vendi i lindjes, kombësia, numri i amzës, i cili është i pandryshueshëm)
- c. vetitë fizike (vetitë trupore dhe gjinia, përshkrimi personal, shenjat e gishtërinjve)

Përcaktimi i identitetit të personit të caktuar është i domosdoshëm në rastet kur duhet të zbulohet kryerësi i panjohur ose kur ndaj disa personave (i dyshuari, dëshmitari i gjallë), duhet të kryhet masa dhe aktiviteti i caktuar operativ-taktik, prandaj për ndërmarrjen e tillë është e nevojshme që paraprakisht të bëhet kjo.

Përcaktimi i identitetit ndaj personit kryhet duke ndërmarrë gjithnjë për këtë masat e përmendura dhe vetëm atëherë kur ekziston interesi zyrtar. Të gjitha këto situata nuk është e mundur që të

parashikohen në fillim.

Mirëpo arsyet kriminalistike diktojnë që përcaktimi i identitetit të personave domosdo të bëhet në rastet si vijon:

- a. kur personi privohet nga liria;
- b. ndaj personit kundër cilit paraqitet kallëzimi penal;
- c. ndaj shtetasve të cilët policinë e jashtme i deportojnë;
- d. ndaj shtetasve të huaj të cilët kryejnë veprë penale ose nëse u është shqiptuar masa mbrojtëse e deportimit nga vendi, ose largimit nga territorit të shtetit
- e. ndaj personit i cili nuk jep shënime për identitetin e vet, ose për vete jep shënime të rrejshme;
- f. kur ekziston dyshimi se dokumenti personal është i falsifikuar;
- g. ndaj personit i cili për shkak të të metave psiko-fizike nuk është në gjendje që për vete të japë shënime, kurse nuk posedon as dokument personal dhe;
- h. identiteti domosdo përcaktohet edhe ndaj kufomës, identiteti i të cilës nuk është i njohur.

7. Kontrolli kriminalistik

Kontrolli kriminalistik është mbikëqyrje dhe depërtim sistematik i pareshtur në të ashtuquajturat mjedise kriminale, ose mjedise potenciale kriminale, ose individë të cilët tashmë janë të njohur si kriminelë apo kriminelë potencialë. Fjala është për sistemin e të gjitha masave dhe aktiviteteve operative-taktike, me anë të të cilave personat e autorizuar zyrtarë informohen për delikuentet dhe delikuencën, për fenomenet e rrezikshme shoqërore, pasojat dhe shkaktarët e atyre gjendjeve dhe dukurive, për faktorët dhe mjediset kriminogjene dhe viktimogjene etj., me fjalë të tjera kjo është formë e veprimtarisë së personit të autorizuar zyrtar e drejtuar ndaj kriminalitetit si dukuri masive.

Këto aktivitete i zhvillojnë të gjithë personat e autorizuar zyrtarë, varësisht nga shkalla e

profesionalizmit, mënyra dhe mjetet e zbatuara në kuadër të ndarjes aktuale të punës.

Gjatë kontrollit kriminalistik si formë e përcjelljes dhe studimit të kriminalitetit dhe të gjendjeve dhe dukurive të tjera të rrezikshme shoqërore, në territorin e caktuar policia lëviz në sferën e "zonës së errët". Në të para së gjithash bëjnë pjesë masat dhe aktivitetet operative të njohjes së informatave të ndryshme. Fjala është për indiciet e para orientuese-informative, të cilat jo rrallë janë shumë modeste. Bazë për ngritjen e kontrollit kriminalistik është ekzistimi i të ashtuquajturit dyshim i përgjithshëm, si masë mundësie. Dyshimi i përgjithshëm ka të bëjë me mjedisin e caktuar, vendin dhe personat në kuptimin që në atë rreth ose nga personat e caktuar do të mund të kryhej veprë penale.

7.1. Kontrolli i përgjithshëm (operativ) kriminalistik

Ky është sistem i masave dhe veprimeve operative-taktike, me të cilat personi i autorizuar zyrtar në mënyrë të planifikuar dhe mirë të menduar vjen deri te njohuria mbi aktivitetet kriminale, vatrat kriminale dhe mjediset kriminale, si dukuri të cilat ende nuk janë evidentuar dhe konkretizuar në formën e ngjarjeve të paraqitura kriminale. Ky kontroll është i drejtuar në ruajtjen, evitimin dhe zbulimin e aktivitetit kriminel, para së gjithash të kriminelëve profesionale. Ndërmerret në bazë të dyshimit të përgjithshëm apo vlerësimit se mund të ndodhë kryerja apo përgatitja, ose ekziston apo madje është kryer çfarëdo veprë penale.

7.2. Kontrolli kriminalistik i posaçëm kriminalistik speciai linear

Kjo është formë e lartë e kontrollit që mbështetet në vlerësimin analitik dhe zbaton metoda dhe mjetet të llojit të vet të kontrollit, prandaj edhe një aftësim të posaçëm profesional të policëve në raport me llojin e caktuar të aktivitetit kriminal, të gjendjeve të rrezikshme, të kategorive të personave dhe të vatrave kriminale.

Kjo shkallë e lartë e kontrollit kriminalistik zhvillohet në raport me kriminalitetin (në kuptimin

penalo-juridik të ngushtë sipas parimeve lineare të njërive të specializuara organizative, grupit punues apo individit. Fjala është për formën e specializuar të veprimtarisë kundër grupeve të caktuara dhe llojeve të caktuara të veprave penale. Në kuadër të kontrollit linear kriminalistik si formë e specializuar e aktivitetit realizohet një shkallë e lartë e përpunimit analitik, bëhen vlerësime mbi rrezikun e objekteve të caktuara, mjediseve, vatrave, etj, hartohet programi aksionar dhe plani operativ i kontrollit. Te ky lloj kontrolli përpunimi operativ-analitik nuk guxon të bëhet nga personat administrativë, por nga specialistët operativë me përvojë (grup më i vogël apo më i madh).

2.1. Roli i MPB-së dhe Policisë Pyjore në parandalimin e kriminalitetit ekologjik

Roli dhe aktivitetet e Ministrisë së Punëve të Brendshme në mbrojtjen e mjedisit burojnë nga detyrimi i tyre ligjor, e cila përcaktohet në disa ligje dhe akte nënligjore. Karakteristikat e veçanta të krimeve ekologjike kërkojnë njohuri dhe metoda të veçanta në zbulimin dhe sqarimin e tyre, kështu që përveç institucioneve të specializuara, është përfshirë edhe Ministria e Punëve të Brendshme, sepse me punë të përbashkëta vjen në shprehje shkallë më e madhe e profesionalizmit, ekspozitës, personelit dhe paisjeve teknike.

Roli i policisë në mbrojtjen e mjedisit varet nga rrethana specifike, por në parim policia mund të konsiderohet një faktor potencialisht i rëndësishëm në monitorimin e respektimit të rregulloreve mjedisore, sepse ka më shumë nëpunës policorë të autorizuar sesa inspektor të mjedisit në një zonë të caktuar.

Ministria e Punëve të Brendshme duhet të ketë një njohje më të mirë të vendit, d.m.th. evidencë për ndotësit më të mëdhenjë, më të zakonshëm dhe ndotësit potencial. Për zbulimin e saktë dhe të plotë të këtyre ndotësve, duhet të pëfshihen aktivitetet të caktuara siç janë monitorimi, kontrolli dhe mbikqyrja.

Specifikat e veprimit parandalues të policisë konsiston në: monitorimin, kontrollimin dhe mbikqyrjen e sektorëve kritikë të ndotjes së mjedisit dhe marrjen e informacioneve ekologjike nga sistemet kriminalistike dhe nga sistemet tjera informative. Në këtë kuptim, për të kontrolluar

ndotjen dhe ndotësit është e nevojshme të krijohet një hartë ekologjike, e cila përmban të dhëna për ndotësit ekzistues dhe ato të mundshëm, duke caktuar llojin e ndotjes.

Roli i Policisë Pyjore në luftimin e kriminalitetit ekologjik

Një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e ambientit dhe luftimin e kriminalitetit ekologjik e ka edhe Policia Pyjore e RMV-së. Në punën e saj Policia Pyjore e RMV-së vepron sipas Ligjit për pyje dhe Rregulloren për rregullat për kryerjen e punëve të policisë pyjore. Kjo polici është e përfshirë kryesisht në ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve të cilat zbatohen me qëllim që të sigurohet ekzistenca e pyjeve, ruajtja e gjendjes shëndetësore, dhe vitaliteti i pyjeve nga përvetësimi dhe shfrytëzimi i padrejtë, prerjet e padrejta, zjarret, sëmundjet e bimëve dhe dëmtuesit, kullotja e kafshëve, të ushqyerit me lëndë, mbledhja e padrejtë e prodhimeve tjera pyjore dhe dëmtimet tjera.

Pjesëtarët e Policisë pyjore janë të autorizuar të ndërmarrin veprime të ndryshme në funksion të mbrojtjes së pyjeve, dhe parandalimit të veprave penale dhe kundërvajtjeve siç janë:

- * dhënien e paralajmërimeve dhe urdhrave

- * të ruajnë pyllin

- * të intervenojnë

- *të pengojnë dhe të legjitimojnë dhe të vërtetojnë identitetin e personave ose arrestojnë personat që hasen në kryerjen e kundërvajtjeve ose veprave penale që kanë të bëjnë me pyjet, ose për të cilat ekziston dyshim themelor se kanë kryer vepra të tilla

- *të ndalojnë dhe të kryejnë kontrollin e të gjitha mjeteve me të cilat transportohen ose barten drunjtë dhe prodhimet tjera pyjore

* të kontrollojnë depot dhe hapësirat tjera ku ruhen ose përpunohen druri dhe produkte tjera të pyjeve dhe oborre ku shihet qartë se është depo në mënyrë të padrejtë

* të sigurojnë dhe të bëjnë këqyrjen e vendit të ngjarjes

* vënien e pritës

* vënien e bllokadave

* të mbledhin informata dhe kallëzime penale

* të ndjekin dhe të informojnë për gjendjen e pyjeve, në lidhje me prerjet e paligjshme dhe vjedhjet e pyjeve, zjarret e pyjeve, sëmundjet bimore, dëmtuesit pyjorë, si dhe fatkeqësitë tjera dhe t'i informojnë organet kompetente për përvetësimin e paligjshëm të pyjeve dhe tokës pyjore, ndërsa kundër shkelësve të ngritin procedurë para organit kompetent.

2.2. Veprimet kriminalistike me karakter represiv për zbulim të kriminalitetit ekologjik

Veprime kriminalistike të karakterit represiv kemi shumë në shkencën e kriminalistikeës, ne do t'i përmendim disa prej tyre, dhe në mënyrë të shkurtë do të japim sqarime lidhur me ta.

1. Veprimtaria kërkimore paraqet sistem të masave dhe aktiviteteve operative-taktike dhe teknike të cilat drejtpërsëdrejti i ndërmerret policia sipas urdhrimit të organit tjetër ose me vetëiniciativë dhe me qëllim të gjetjes së personit të caktuar si dhe objekteve të cilat janë ose mund të jenë të ndërlidhura me veprën penale, gjegjësisht, me qëllim të përcaktimit të plotë të identitetit të personave dhe kufomave, nëse nuk ka qenë e mundur të vërtetohen në mënyrë tjetër.

Veprimtaria kërkimore është vetëm një pjesë e përpunimit kriminalistik dhe si e tillë ajo ndërmerret post delictum me qëllim të:

✧ zbulimit të atyre kryerësve të veprave penale të cilët janë në arrati ose nuk iu dihet vendbanimi apo vendqëndrimi;

✧ përcaktimi i të gjitha karakteristikave relevante identifikuese të kryerësve të veprave penale;

- ✧ gjetja e personave të zhdukur nëse ekzistojnë bazat e dyshimit se deri te zhdukja e tyre ka ardhur si rezultat i veprave penale;
- ✧ gjetja e objekteve të cilat kanë lidhje me veprën penale, gjegjësisht mbledhja e informatave për to;
- ✧ Përcaktimi i identitetit të kufomave të paidentifikuara, nëse ekzistojnë bazat e dyshimit se deri te vdekja ka ardhur me anë të veprës penale.

2. Kërkimi i personave të zhdukur

Nga praktika e përditshme kriminalistike dihet se personat e të dy gjinive, të moshave dhe profesioneve të ndryshme, të konfesioneve dhe të kombësive të ndryshme, etj. zhduken çdo ditë, nganjëherë edhe në mënyrë misterioze. Publikun sidomos e shqetësojnë zhdukjet e fëmijëve. Problemi i zhdukjes së fëmijëve nuk është i ri, por kohët e fundit me shtimin e pedofilisë, për çdo ditë paraqiten ndryshime në skenat mediale, në perceptimin e publikut dhe në qëndrimet e bashkësive shoqërore lidhur me zhdukjen e fëmijëve.

Personat e moshës madhore në të shumtën e rasteve janë të punësuar, të martuar, kanë mënyrë të rregullt jetese, të adaptuar në rrethin në të cilin jetojnë, zhdukja e të cilëve zakonisht ka shkaqe të thella dhe arsyeja nga zhdukja e fëmijëve dhe rinjve. Pikërisht për zhdukjet e fëmijëve sidomos të moshës parashkollore shkaktojnë dyshime të posaçme të organeve të procedurës dhe në publik.

Fëmijët dhe të miturit, për shkak të papjekurisë psikike, kureshtjes, naivitetit dhe sugjestiveve lehtë bëhen viktimat të kryerësve të veprave të ndryshme penale.

Rastet më të reja të aferave të pedofilisë, të kidnapimit të fëmijëve me qëllim të marrjes së organeve të tyre për transplantim, për futjen në mall të bardhë, për pornografi fëmijësh (për kontakte fizike me persona të devijuar, për fotografime të fëmijëve), për eksperimente me organe të tyre, etj. flasin për nevojën serioze për qasje ndaj këtij problemi me të marrë të lajmit për zhdukjen e tyre, dhe për ndërmarrjen e masave urgjente dhe të veprimtarive kërkimore. Nga këto zhdukje, për policinë më të rëndat janë rastet e të ashtuquajturave zhdukje serike të personave. Në rastet e tilla policia është nën presionin e posaçëm të publikut sikurse në rastet kur paraqiten viktimizimet rituale të fëmijëve nga ana e sekteve të ndryshme të ndaluara apo format e ndryshme të shfrenimit mbi fëmijët dhe të miturit.

3.Arrestimi i policisë kriminalisteve

Gjatë procesit të rregullt të arsimimit të policisë me përmbajtjet mësimore për kërkimin policor, studentët duhet të përgatiten për punë dhe udhëheqje me aktivitetet e hulumtimit policor, varësisht nga niveli i tyre arsimor.

Me planin e zhvillimit të ushtrimeve (kriminalistika situacionale) duhet të arrihet që të qartësohet plotësisht ndërlidhja midis teorisë shkencore dhe praktikës së aplikueshme.

Me atë rast duhet kërkuar që studentët të aftësohen, sidomos për qëllimet kryesore të profesionit, si vijon:

(1) Që situatat policore t'i kuptojnë dhe t'i vlerësojnë drejt; ta zhvillojnë aftësinë për vendime alternative; të marrin vendime dhe t'i arsyetojnë ato, si dhe në rolet udhëheqëse të marrin pjesë

edhe detyra të tilla;

(2) T'i zbatojnë vendimet duke i angazhuar me atë rast forcat policore në mënyrë taktike dhe të drejtë dhe që në rolet udhëheqëse të marrin pjesë edhe në zbatimin e tyre;

(3) Që të mund ta kuptojnë dhe vlerësojnë rëndësinë dhe karakterin e ligjeve që kanë të bëjnë me policinë dhe me hulumtimet, të mbështetura në përvojat dhe parimet e formave të ndryshme të kërkimit policor;

(4) Që të disponojnë me njohuri themelore të teknikave policore të cilat do t'ua mundësojnë aplikimin e mjeteve të udhëheqjes dhe kryerjes së hulumtimit, në përputhje me rëndësinë e tyre dhe me parimet e shkencës së kriminalistikës, dhe

(5) Që vazhdimisht t'i analizojnë dhe zhvillojnë njohurinë e tyre taktike-teknike. Kurse në disa përmbajtje studimore, në drejtim të qëllimeve kryesore, mund të plotësohen qëllimet konkrete të studimeve, gjegjësisht qëllimet e mësimin.

4. Përgatitjet dhe plani i kërkimit (hulumtimit)

Me rastin e përgatitjes së masave të kërkimit duhet pasur parasysh se çfarë kategorie e personave kërkohen, lidhur me çfarë procedure dhe çfarë vëllimi i masës është i nevojshëm në kuptimin territorial.

Hollësia dhe vëllimi i përgatitje së planit të gjurmimit varet nga pesha dhe ndërlikueshmëria e rastit konkret, lidhur me të cilin organizohet kërkimi, nga koha e cila është në dispozicion, njerëzit dhe mjetet teknike të cilat duhet të shfrytëzohen. Në situatat e befasishme të cilat nuk lejojnë kurrfarë shtyrje, nganjëherë në fazat e para të kërkimit ndërmerren masat dhe aktivitetet që janë më të nevojshme.

Gjatë përgatitjes dhe planifikimit të masave të kërkimit duhet të shfrytëzohen të gjitha burimet e informatave në dispozicion. Të gjitha informatat dhe të dhënat në dispozicion duhet përpiluar në mënyrë të përpiktë, analizuar, dhe rregulluar. Sidomos duhet pasur kujdes për informimin e ndërsjelltë azhur, vertikal dhe horizontal. Kur është fjala për kërkimin e përmasave të mëdha në kuadër të përgatitjeve të planifikimit duhet të sigurohet edhe udhëheqja unike me aksionin, të përpunohen në mënyrë të saktë dhe të harmonizohen masat dhe aktivitetet operative të kërkimit, dhe nëse ekziston rreziku i shtyrjes sipas nevojës edhe masat anticipuese të argumentimit, duhet të përpunohen dhe saktësohen detyrat e disa grupeve operative dhe njërive tjera organizative. Me nënplanet gjegjëse duhet të përpunohet plani i aksionit të njërive speciale të policisë, atëherë kur përdorimi i tyre paraqitet si i domosdoshëm.

Në planin operativ të kërkimit sidomos duhet të parashikohen dhe të përpunohen masat dhe aktivitetet operative të cilat duhet të ndërmerren në kuadër të kërkimit të personit të zhdukur, rendi i ndërmarrjes së tyre, kush duhet t'i ndërmarrë, mjetet e ndryshme teknike, etj. Me këto masa dhe aktivitete në esencë bëjnë pjesë; kontrolli i hapësirave të hapura (terrenet), automjetet, lundrueset, legjitimimi i personave, bllokada, pusia, racia, vëzhgimi, angazhimi i të besuarve, publikimi i fotografive të personit të zhdukur në mjetet e informimit, pllakatet, mbledhja e informatave nga personat, shikimi i dokumentacionit dhe evidencave të ndryshme të personave juridik, shfrytëzimi i qenit zyrtar, helikopterit, poligrafi për testim, etj

5.Kontrollimi i terrenit

Mënyra e kontrollimit të hapësirave të hapura, që në gjuhën operative quhen "terrene", varet nga madhësia dhe konfiguracioni i tyre (topografia), kushtet për kalim, shikueshmëria dhe karakteristikat tjera.

Mënyra e kontrollimit varet edhe nga mjedisi urban ose fshatar. Rol të rëndësishëm luan edhe numri i policëve veprimtarë të përfshirë në kërkim, përgatitja e tyre, etj. Lidhur me këtë nuk ekziston ndonjë shabllon. Situata konkrete e dikton mënyrën e kërkimit.

Nganjëherë është e nevojshme të vendoset bllokadë, madje edhe bllokadë e thellë.

Me rastin e kontrollimit të terrenit nuk kërkohen vetëm personat e zhdukur dhe mbetjet e tyre, por edhe objektet dhe gjurmët që tregojnë prezencën dhe lëvizjen e tyre. Kur dyshohet në kidnapim, terrorizëm, krahas marrjes së pengjeve, etj. kontrolli kryhet me masa të kujdesit më të rreptë. Mënyra e kontrollimit të objekteve të pabanuara dhe të kulmeve të shtëpive kryhet në përputhje me rregullat taktike dhe me masat e posaçme të kujdesit, kur përdorimi i tyre është elementar.

6.Kontrollimi i lagjeve

Te kontrollimi i vendeve të banuara në kuadër të zbatimit të kërkimit zbatohen rregullat taktike të kombinuara të kërkimit të vendeve të hapura dhe të mbyllura me masat përkatëse të kujdesit të shtuar.

Kontrollimi i lokaleve të mbyllura dhe hapësirave kryhet në pajtim me dispozitat pozitive të KPP, dhe sipas planit të posaçëm. Ndërkaq, rrjedhën e jetës publike duhet penguar vetëm në atë masë sa është e domosdoshme për zbatimin e masës së kontrollit dhe gjithmonë duhet vlerësuar mirë se cilën masë dhe aktivitet taktik duhet ndërmarrë. Kërkimi dhe kontrollimi duhet të bëhet në tërë lagjen, ose në disa pjesë të saj (kuarte, mikrorajone, blloqet e shtëpive, etj).

Jo rrallë është e nevojshme të kryhet bllokada e furishme e territorit. Për zbatimin e kësaj forme të kërkimit pjesëtarët e policisë që marrin pjesë në të duhet ta njohin mirë teknikën e futjes në ndërtesa, t'i njohin lokalet e mbyllura, oborret dhe hapësirat e objektet tjera dhe të kenë kujdes për kurthet eventuale të qëllimshme dhe të paqëllimshme të cilat i presin, dhe për këtë t'i angazhojnë qenët.

Rekomandohet veprimi i dy grupeve hetimore: njëra e bën kontrollimin e drejtpërdrejtë, kurse tjetra vëzhgon dhe bën sigurimin. Ato grupe mund të veprojnë paralelisht dhe në mënyrë të kombinuar, sipas rrethanave konkrete dhe planet e veprimit paraprakisht të hartuara. Duhet evituar çdo stih dhe veprim të pakoordinuar. Do të kishim dashur të tërheqim vëmendjen që në rast të kërkimit të kriminelëve të rrezikshëm, të cilët janë përfshirë në zhdukjen e personit dhe janë në arrati, duhet pasur kujdes se ata gjithmonë janë në pozitë më të mirë dhe në raport me policinë, sepse i kanë strehimoret, kurse në mesin e tyre mund të gjenden edhe persona plotësisht të pafajshëm.

7. Mbledhja e informatave nga personat

Sipas natyrës së problemit çdo gjurmim për personin nënkupton mbledhje të informatave nga personat sipas rregullave të taktikës kriminalistike. Për cilët persona është fjala, është çështje vërtet e kushtëzuar nga rrethanat e rastit konkret. Por, zakonisht ata janë kushërinjtë, shokët dhe miqtë, kolegët, dëshmitarët e gjallë ose ata që kanë fjalë, mjekët, priftërinjtë, avokati, inkasanti, postieri, mjeshtrit e shtëpisë dhe personat tjerë që e kanë njohur të zhdukurin dhe mund të japin informatat e dobishme për të.

Mënyra e mbledhjes së informatave varet nga ajo se a është i zhdukuri fëmijë dhe i mitur, i moshuar, i popullarizuar, politikan, etj. Teknikat e mbledhjes së informatave konform taktikës kriminalistike duhet zbatuar në formë të ndonjë tipi të intervistimit, bisedës, apo bisedës informative (nëse është në pyetje i dyshuari potencial).

Duke shikuar njerëzit derisa flasin, kriminalistët mund të përfundojnë shumëçka. Për këtë arsye ata gjithmonë duhet t'i vështrojnë dhe përcjellin shenjat të cilat me trupin e tyre i japin bashkëbiseduesit në mënyrë të pavetëdijshme. Mirëpo, një numër shumë i vogël i shenjave mund të zbulojnë shumë. Me këtë rast duhet pasur parasysh se si flet trupi i bashkëbiseduesit, ashtu ekziston edhe të folurit e trupit të kriminalistit i cili e merr në pyetje.

Ai mund ta shfrytëzojë këtë lëvizje të trupit në mënyrë pozitive, p.sh. ta lirojë bashkëbiseduesin kur ai është nervoz dhe i pasigurtë ose madje i frikësuar me anë të qëndrimit të relaksuar dhe spontan të vetin. Midis bashkëbiseduesve nuk bën të ketë kurrfarë barrierash fizike. Kriminalisti që merr në pyetje gjithmonë duhet të ketë parasysh disa lëvizje dhe qëndrime të bashkëbiseduesit, midis kontrollit të tij, sado që ai të mundohet, sidomos gjatë shënimit të përmbajtjes së dëshmisë, pra ta ketë bashkëbiseduesin gjithmonë në këndin e shikimit.

Me rastin e bisedimit me personat, kriminalisti duhet t'i flasë fjali të qarta dhe të kuptueshme. Toni i ulët zgjon mosbesimin, toni i pandryshuar paralajmëron nënçmim, toni tepër i lartë dëshirën për dominim dhe dhunë, etj. Duhet folur ngadalë dhe qetë. Kriminalistët të cilët flasin shumë shpejt dhe paqartë, shkaktojnë mosbesim. Bashkëbiseduesin gjithmonë duhet shikuar në sy. Ata që gënjejnë në situatë të tillë i shmangen shikimit direkt dhe lëvizin në karrigë, kurse në

pyetje përgjigjen sikurse të kishin bllokadë mendore, janë nervozë dhe të brengosur e që manifestohet në mënyra të ndryshme, bëhen agresivë dhe marrin qëndrim protestuese.

8.Roli i moralit profesional policor

Procedura lidhur me zhdukjet kërkon standarde të larta punuese dhe profesionale për policët. Parimi themelor të cilit duhet t'i përmbahen është parimi i ligjshmërisë. E vërteta mund të konstatohet vetëm në bazë të mënyrave dhe metodave të pranuar sipas ligjit dhe moralisht të arsyeshme në pikëpamje taktike-teknike.

Morali bashkëkohor policor kërkon ndër të tjera që rezultati i punës t'i nënshtrohet analizës së rreptë dhe të hollësishme (kontrollit). Policia duhet të veprojë lege artis dhe të jetë efektive, kurse mjetet dhe metodat e zbatuara duhet të jenë të përshtatshme. Me këtë rast duhet të ruhen nga ndërhyrjet e pabaza në personalitetin e individëve dhe të drejtat e personave fizik dhe juridik.

Morali profesional i policëve nuk bazohet vetëm në rregullat dhe veprimet e shkruara. Ai duhet të jetë komponent i thurur në strukturën e masës dhe veprimit të caktuar dhe në procedurën në tërësi. Ai në plan të parë duhet ta ketë aftësinë profesionale, përgjegjësinë profesionale, objektivitetin dhe kritikën në punë si dhe një varg vetish tjera që luajnë rolin kyç në funksionimin e sistemit konkret preventiv-represiv të aktivitetit policor. Zbatimi i rregullit të moralit policor është i nevojshëm sidomos në situata të dyshimta për shkak të paqartësisë së dispozitave ligjore, me problemet e hapura të përdorimit të mjeteve të caktuara në procedurën e ndriçimit të fakteve, etj.

Domethënia e tij në punën e përditshme policore është shumë më e madhe sesa që i kushtohet kujdes atij.

E pamë se morali policor është sistem i formave etike, specifike për policinë si grup profesional, sipas të cilit me rastin e kryerjes së aktivitetit të tij profesional polici duhet ta posedojë. Ky moral

është ngushtë i lidhur me zakonet profesionale me policinë. Zakonet profesionale me policinë përcaktojnë mënyrat sipas të cilave aktivitetet policore zhvillohen me qëllim të kryerjes së rolit shoqëror të policisë në mënyrë sa më efektive. Kjo do të thotë se çdo punë policore duhet të kryhet profesionalisht dhe në kohën e duhur duke i ndërmarrë të gjitha ato masa të cilat në këtë profesion dhe në situatën konkrete konsiderohen të nevojshme për të qenë të kryera mirë. Elementet themelore të zakoneve profesionale në polici duhet ndërtuar në planet dhe programet mësimore gjatë shkollimit të policëve. Selektimi i drejtë dhe shkollimi i mirë i policëve është parakusht i rëndësishëm për kryerjen e suksesshme të punëve policore, për të cilat u fol. Specifikë e punës policore është dhe rreziku nga deformimet e mundshme profesionale, prandaj nga policia kërkohen standarde të larta pune.

9. Prita (pusia)

Pusia është veprim i organizuar kriminalistik taktik, gjegjësisht vëzhgim dhe mbikëqyrje e fshehtë e hapësirës dhe objektit me qëllim të zbulimit dhe arrestimit të kryerësit të veprës penale. Për suksesin e pritës është me rëndësi që kriminalistët t'i përmbahen parimit kriminalistik të shpejtësisë apo urgjencës, të befasisë dhe konspiracionit "fshehtësisë". Duke pas parasysh qëllimin dhe detyrën, pusia mund të ketë njëkohësisht karakter represiv dhe preventiv, ashtu që befasia dhe konspiracioni ta përbëjnë esencën e pusisë.

Konspiracioni është i rëndësishëm gjatë përgatitjes së pritës, kurse përbëhet para së gjithash nga vëzhgimi i fshehtë dhe vrojtimi i vendeve ku vendoset pusia, verifikimi i fshehtë i personave interesantë, dhe gjithsesi puna e fshehtë e çdo polici veç e veç. Me rastin e vendosjes së pritave dhe të qëndrimit në pritë, konspiracioni duhet të jetë në nivelin më të madh të mundshëm, sepse në të kundërtën pusia nuk do të jetë efikase.

Arrestimi i kryerësit të veprës penale duhet të jetë i shpejtë dhe i befasishtëm në mënyrë që ai të mos mund të ofrojë rezistencë, të ikë, dhe t'i hedhë apo asgjësojë objektet e veprës penale. Prita vendoset në vend të përshtatshëm, gjegjësisht në vendin ku pritët ardhja e personit të dyshuar, apo ardhja e personave të dyshuar, ose në afërsi të madhe të vendit, ku p.sh. bëhet stërshitja e drogës në rrugë. Këto mund të jenë vendet siç janë: parqet, shëtitoret, sheshet, trotualet e rrugëve, kafe baret, diskotekat, stacionet e autobusëve dhe hekurudhore, ose shtëpitë e kriminelëve të caktuar.

Me prita zbulohen dhe kapen personat që merren me vepra të ndryshme penale siç janë: tregtia me njerëz, falsifikimi i të hollave ose dokumenteve, prostitucioni ilegal, tregtia me armë, etj

10.Përcjellja

Përcjellja paraqet masën dhe aktivitetin operativ taktik që ka të bëjë me ndjekjen e fshehtë të personave të caktuar gjatë lëvizjes, si dhe me monitorimin diskret të atyre personave me qëllim të perceptimit dhe të regjistrimit të të gjitha rrethanave që janë të rëndësishme për ndriçimin e veprës konkrete penale.

Këtë aktivitet zakonisht e realizojnë personat e autorizuar zyrtarë, kurse më së shpeshti e kryejnë me qëllim të ndriçimit të veprave të rënda penale dhe të zbulimit të kryerësve të tyre si dhe të pjesëmarrësve në veprën e kryer, sidomos kur është fjala për kryerësit të cilët kanë vepruar në mënyrë të organizuar, të lidhur në grupe apo në organizata tjera kriminale.

Me përcjellje më së shpeshti realizohen qëllimet si vijon:

- 1.mbledhja e informatave themelore për personin i cili është objekt i këtij aktiviteti, e të cilat janë të dhënat për vendbanimin, vendqëndrimin, shprehitë jetësore, punësimin, sjelljen, për kontaktet profesionale dhe miqësore të tij, lidhjet kriminale, etj.
- 2.përcaktimi i identitetit për persona të dyshimtë pa legjitimim;
- 3.njohja e rrethit me të cilin jeton dhe vepron i dyshuari, duke perceptuar dhe identifikuar të gjithë personat tjerë të dyshimtë të cilët janë në lidhje me të dyshuarin, dhe zbulimi i karakterit të lidhjeve të tyre kriminale;
- 4.zbulimi i strehimoreve të fshehta të të dyshuarve në të cilat fshihen ata ose i shfrytëzojnë për fshehjen e objekteve të veprës penale, mjeteve të kryerjes, siç është arma, municioni, ose sendet tjera;
- 5.përcaktimi i përgatitjeve eventuale të të dyshuarit ose personave tjerë për kryerje të veprës së re penale;
- 6.identifikimi i personave të cilëve do t'u dorëzohet objekti i veprës penale si dhe të personave që janë fshehës potencialë, apo ndihmës pas kryerjes së veprës;
- 7.kapja e disa kryerësve me rastin e kryerjes së veprave penale "in flagranti delicto" që shpesh

është e mundur, sidomos te vjedhja e xhepave, kontrabanda, shpëlarja e parave, shantazhi, spiunazhi, detyrimi, etj;

5. Specifika të kriminalitetit ekologjik

Si specifika të rëndësishme dhe mjaft delikuate për zbardhjen e këtyre veprave penale ekologjike janë: Koha e kryerjes, Modus operandi e kriminelëve të kësaj forme të kriminalitetit, Mjetet që përdoren për kryerjen e këtyre krimeve, Disa veçori të kryerësve të kriminalitet ekologjik.

5.1 Koha e kryerjes

Në kohët e stinave vjeshtore dhe dimërore kemi të bëjmë me pretjen e pyjeve, shkatërrimin dhe djegien e pyjeve, koha e kryerjes së këtyre veprave penale ekologjike ka peshë të madhe në shkencën e kriminalistikës sidomos në kohën kur bëhet hetimi dhe zbulimi i veprave të lartpërmendura.

Dhe ndotja e ujit të pijshem ndodh më së shumti kur hiqen më shumë plehrat gjatë stinës së pranverës dhe në këto rrethana më së shumti ndotet uji për pije, ose hedhja e plehrave afër lumenjve apo burimeve ku rrjedh uji.

Peshkimi i paligjshëm më së shumti ndodh gjatë kohës verore, kur individet apo persona që merren me këtë veprimtari gjatë kësaj kohe bëjnë peshkimin dhe pse është e ndaluar kapja e peshqve në këtë kohë.

Gjuetia e paligjshme, koha kur është e lejuar është nga nëntori deri në muajin mars, por ka shumë gjuetarë, në kohën kur është e ndaluar ata kërkojnë leje për gjuatje, dhe kështu kryhen krime të këtilla.

5.1.2 Modus operandi e kriminelëve të kësaj forme të kriminalitetit

Modus operandi i kriminelëve të këtyre krimeve kryhet nga një kategori e caktuar personash që zakonisht merren me kriminalitetin ekologjik. P.sh.: Gjuetarë, peshkatarë, ujësjellës, ambientalistë etj.

Mënyra e kryerjeve të krimeve ekologjike është e ndryshme për secilën kategori të veprave penale, dhe asnjëherë nuk kryhet nga pakujdesia, por me veprime të plota.

5.2.1 Mjetet që përdoren për kryerjen e këtyre krimeve

Lidhur me mjetet për krimet dhe veprat penale ekologjike janë të panumërta. Disa vepra penale ekologjike kryhen me mjete të rëndomta dhe kryerësi e fsheh mjetin që ka kryer veprën penale. Si mjete për veprën penale të ndotjes së ambientit janë plehrat, kamionët, fabrikat për ndotjen e ajrit, veturat e vjedhura për prerjen dhe bartjen e drunjve, shkrepësas, dhe qibritet për djegien dhe shkatërrimin e pyllit, pushkët ujore, rrjetat e ndryshme për peshkimin e paligjshëm, pushkët dhe armët e ndryshme për gjuetinë e paligjshme etj.

5.2.2 Disa veçori të kryerësve të kriminalitet ekologjik

Veçuri e kësaj forme kriminale është se krimet kundër natyrës dhe ambientit jetësor shkaktojnë dëme të mëdha financiare dhe kanë pasoja të mëdha katastrofale.

Veçuri tjetër është se dhe statistikave kriminale, por dhe ato shtetërore në vendin tonë dhe në botë, numri i denoncimeve lidhur me krimet ekologjike është i ulët dhe i personave të gjykuar, dhe të ndjekur penalisht.

Kryerësit e krimeve ekologjike në shoqërinë bashkëkohore rëndomt nuk janë tipa asocialë ose nuk duken si të tillë.

Mendimi im kritik: konstatoj se brengosëm, dhe përgjegjshmëria, joefikasiteti i organeve të inspektionit, policisë, gjykatave, duhet angazhuar më së shumti në luftimin, pengimin dhe parandalimin e krimeve kundër ambientit jetësor dhe natyrës.

Veprat penale kundër natyres dhe mjedisit jetësor, si vepra penale që janë në rritje të vazhdueshme në vendet e Ballkanit, në krahasim me shtetet evropiane, të cilat këtë problematikë e kanë tejkaluar dhe numri i këtyre veprave penale është në ulje dhe është zvogëluar ndjeshëm në 10 vitet e fundit.

Në rajonin e Kumanovës këto vepra penale janë të theksuara, mirëpo siç ju paraqitëm më lart, numri i vogël i rasteve të paraqitura dhe personave të dënuar për kryerjen e këtyre veprave penale është problemi kryesor që ndihmon kryerësit që të vazhdojnë të dëmtojnë mjedisin dhe qytetarët, duke dëmtuar të mirat e përgjithshme, posaçërisht me uzurpimin e zonave të gjelbërta në qytetin e Kumanovës dhe rethinës, nga ndërtimet e ndryshme pa leje që janë ndërtuar në dhjetë vitet e fundit. Problem tjetër që paraqitet në këtë rajon është edhe infrastruktura e dobët dhe ngarkesa e madhe e komunikacionit, duke mos harruar edhe ndotësin më të madh të qytetit, fabrikën, qytetarët e Kumanovës krahas problemeve në infrastrukturë rrugore, mungesës së transportit publik, komunikacionit të rënduar, ndërtimeve pa leje, po përballen edhe me ajrin e ndotur, i cili është mbi nivelet e lejuara. Gjithë kjo ndotje që përmban në vete vulën e problemeve infrastrukturore e të tjera që përmendëm më lart, si dhe problemi tjetër që po shqetëson banorët e kësaj komune dhe më gjerë, fabrikat e ndryshme prodhuese që gravitojnë në këtë zonë dhe vazhdojnë punën duke mos respektuar standardet ekologjike dhe në masë të madhe ndotin ajrin që thithin qytetarët e Kumanovës. Vlen të theksohet ndotësi më i madh që është fabrika “Ambalazha dhe Shamicevi”, të cilat vazhdojnë të punojnë me intensitet të lartë duke mos respektuar standardet e nevojshme ekologjike. Hedhja e mbeturinave në f. Nikushtak është problematikë mjaft serioze ekologjike në komunën e Likovës.

Shpresoj që ky punim do të kontribuojë në njohjen e rrezikshmërisë së këtyre veprave penale për të gjithë personat që jetojnë në Republikën e Maqedonisë Veriut, si dhe të kontribuojë për gjetjen e masave më efikase për parandalimin e kësaj dukurie mjaft të dëmshme për shoqërinë.

Shpresoj që ky punim i imi të lexohet dhe nga ana e studenteve të Fakultetit juridik, profesorë, inspektorë dhe persona të fushës të së drejtës penale dhe sigurisë.

BIBLIOGRAFIA

I. Libra, monografi, punime kërkimore shkencore

- Kambovski, Vllado, E drejta penale, *pjesa e përgjithshme*, Shkup 2007
 - Kambovski Vlado & Zejneli Ismail, E drejta Penale, Shkup 2018
 - Zejneli, Ismail, E drejta penale, pjesa e posaçme *cikël leksionesh*, Tetovë 2007
 - Zejneli, Ismail, Legal aspect of environmental protection in Macedonia. In *Legal aspect of environmental protection in Macedonia*, pp. 14. SEEU REVIEV, No. 1, 2008
- Afrim Osmani, Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë (tekst integral i përpunuar në gjuhën shqipe), 2010
- Naseri Etem, Kriminalistika Ekologjike, Gostivar 2021
 - N. Koraliq Taktika Kriminalistike SARAJEVË / PRISHTINË 2007
 - Halili Ragip, Kriminologjia, Prishtinë 2016
 - Vesel Latifi, Kriminalistika, Prishtine 2014
- KRIMINALITETI EKOLOGJIK NË RAJONIN E POLLOGUT NË PERIUdhËN
2010-2015, ARSIM QAZIMI
- VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT JETËSOR ME THEKS TË VEÇANTË NË RAJONIN E TETOVËS
2009-2014, Driton ASANI

Burime Juridike

II. Kushtetuta, Kode, Ligje, Direktiva dhe Konventa

- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë Veriut
- Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë Veriut
- Ligji i procedurës penale i Republikës së Maqedonisë Veriut
- Ligji për mbrojtjen e natyrës i Republikës së Maqedonisë Veriut
- Ligji për mjedisin jetësor i Republikës së Maqedonisë Veriut
- Ligji për pyjet i Republikës së Maqedonisë Veriut
- Ligji për gjuetinë i Republikës së Maqedonisë Veriut